

## UDHËZUES

# “PËR MËNYRAT MË TË MIRA TË KOMUNIKIMIT, ADVOKIMIT, LOBIMIT DHE PJESËMARRJES PUBLIKE”

*Ky udhëzues është përgatitur nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) në kuadër të projektit “Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura”, si pjesë e Programit “Mbështetje për organizatat mjedisore të shoqërisë civile në Shqipëri SENIOR-II, i cili zbatohet nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC Shqipëri) dhe financohet nga Qeveria Suedeze.*

*Përmbajtja e udhëzuesit është përgjegjësi vetëm e Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Qeverisë Suedeze dhe/apo të REC Shqipëri.*

**Tiranë, Korrik 2018**



Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) është një organizatë jo qeveritare, e regjistruar si e tillë nga Gjykata e Tiranës në vitin 2004, me vendimin nr. 1087. INCA ka zyrën e saj në Tiranë, por vepron në të gjithë territorin e Shqipërisë.

INCA ka si qëllim kryesor të japë ndihmesën e saj në fushën e formimit profesional, nëpërmjet trajnimeve dhe procesit të pjesëmarrjes, në ruajtjen e mjedisit, në mbrojtjen e vlerave natyrore dhe zhvillimin rajonal, mbrojtjen e florës dhe të faunës, vlerësimin e diversitetit biologjik, menaxhimin e zonave të mbrojtura, rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe vendimmarrësve politik, dhe të ndërmarrë masa mbrojtëse kur është e mundur dhe e nevojshme për mbrojtjen e llojeve dhe habitateve të tyre kritike.

Gjithashtu të integrojë ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit me çështjet e tjera ose fusha të shkencës që kanë një ndikim në burimet natyrore. INCA është pjesë e procesit të përmirësimit të legjislacionit, të problematikave të lidhura me ngritjen e kapaciteteve të institucioneve mjedisore Shqiptare, si dhe integrimin Evropian.



Rrjeti Tematik në fushën e “*Mbrojtjes së Natyrës*”, përfaqësohet nga tetë OJF mjedisore:

<b>Organizata Drejtuese</b>	“Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri”, Tiranë.
<b>Organizata</b>	“Forumi Ndërkufitar i Liqenit të Shkodrës”, Shkodër.
<b>Organizata</b>	“ILIRIA”, Tiranë.
<b>Organizata</b>	“Miqësia”, Ulëz.
<b>Organizata</b>	“Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit”, Kukës.
<b>Organizata</b>	“Green and Clean”, Korçë.



*Organizata* “Mjedisore Çajupi”, Gjirokastër.

*Organizata* “Flag Pine”, Vlorë

### *Sfidat e RrMN në kuadër të Programit SENiOR-II*

#### ***Sfida 1: Ngritja e kapaciteteve të organizatave pjesëmarrëse për identifikimin e problematikave kryesore me të cilat përballen ZMM.***

...Zhvillimi i një sistemi për identifikimin e problematikave kryesore me të cilat përballen 16 zona të mbrojtura në 9 rajone pilote të përzgjedhur: Tiranë, Vlorë, Gjirokastër, Korçë, Mat, Kukës, Shkodër, Librazhd dhe Lushnjë.

#### ***Sfida 2: Identifikimin dhe vlerësimi i problematikave në ZMM e përzgjedhura.***

...Vlerësimi dhe evidentimi i përfshirjes së komunitetit dhe shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe vlerave natyrore respektive lokale në 9 rajone të Shqipërisë.

...Ngritja e kapaciteteve të organizatave të rrjetit mbi modelet e advokimit për një vendimmarrje dhe menaxhim sa më të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe burimeve natyrore respektive lokale.

...Hartimi i një metodologjie për mënyrat dhe modelet më të mira të advokimit dhe pjesëmarrjes publike.

#### ***Sfida 3: Evidentimi i përfshirjes së komunitetit dhe shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes dhe të menaxhimit të ZMM-ve dhe vlerave natyrore respektive.***

...Nxitja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe komunitetit lokal drejt një procesi bashkëpunimi dhe promovimi për menaxhimin e përbashkët të burimeve natyrore në 9 rajone të vendit.

...Nxitja e ngritjes së Forumeve Lokale Mjedisore (FoLM) me përfaqësues nga OJF-t lokale, ekspert lokal dhe operatorë lokal.

...Organizimi i një seminari rajonale (në Tiranë) mbi mënyrat e anagazhimit të shoqërisë civile në proceset advokuese me fokus problematikën në përdorimin e burimeve natyrore.

...Angazhimi dhe evidentimi i përfshirjes së komunitetit dhe shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe burimeve natyrore.

...Realizimi i disa sondazheve për vlerësimin e nivelit të pjesëmarrjes publike në takimet lokale vendimmarrëse për përdorimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore.



***Sfida 4: Nxitja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe komunitetit lokal drejt një procesi bashkëpunimi dhe promovimi për menaxhimin e përbashkët të ZMM.***

..Nxitja e angazhimit qytetar në mbrojtjen dhe promovimin e vlerave natyrore të ZMM.

...Ndërmarrja e disa iniciativave për prononcime në median e shkruar dhe atë vizive.

...Nxitja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe komunitetit lokal drejt një procesi bashkëpunimi për promovimin e përbashkët të ZMM.

...Krijimi i modeleve të reja për zhvillimin e aktiviteteve me bazë natyrën në bashkëpunim me administratat lokale, nëpërmjet vitalizimit të Qendrës së Vizitorëve në PK “Divjakë-Karavasta”, PK “Mali i Dajtit”, PK “Llogara”, etj..



**PËRMBAJTJA****Table of Contents**

PËRMBAJTJA.....	4
SHKURTESAT.....	7
PËRMBLEDHËSE .....	8
1. HYRJE .....	12
2. METODOLOGJIA .....	16
2.1. SYNIMET E UDHËZUESIT.....	17
2.2. UDHËZUESI SI MEKANIZËM PËR FORCIMIN E ROLIT ADVOKUES DHE REAGUES TË ORGANIZATAVE TË RrMN. ....	24
3. PËRGJITHËSIME MBI KOMUNIKIMIN DHE ADVOKIMIN.....	28
3.1. KUSH DUHET TË MARRË Pjesë? .....	29
3.2. KUR DUHET TË PËRFSHIHET Pjesëmarrja Publike? .....	29
3.3. Çfarë është komunikimi? .....	30
3.3.1 Qëllimet e komunikimit .....	30
3.3.2 Llojet e komunikimit.....	30
3.3.3 Format dhe elementët e një komunikimi efektiv .....	31
3.3.4 Cilët janë mjetet për informim dhe komunikim? .....	31
3.3.5 Karakteristikat e rëndësishme të komunikimit efektiv .....	32
3.3.6 Hapat e komunikimit të efektshëm/dobishëm.....	33
3.3.7 Mënyra e shkëmbimit të informacionit.....	33
3.3.8 Organizimi i takimeve dhe roli i ORrMN-ve.....	34
3.3.9 Çfarë duhet të merret parasysh kur planifikoni një takim? .....	34
3.3.10 Disa rregulla për një komunikim më efektiv .....	34
3.3.11 Këshilla për vendimmarrjen nga ORrMN.....	35
3.4. Çfarë duhet të kuptohet me advokim? .....	36
3.4.1 Përkufizime të tjera .....	36
3.5 FAKTORËT PËR ADVOKIM-LOBIM-REAGIM TË SUKSESSHËM .....	37
3.5.1 Cilat janë llojet e advokacisë?.....	37
3.5.2 Cilat mund të jenë përfitimet e procesit të advokimit? .....	38
3.5.2.Ç'farë sjellin ORrMN nga përdorimi i advokacisë? .....	39
3.5.3 Cikli i advokim-lobimit.....	39



4. ADRESIMI I PROBLEMATIKAVE NEGATIVE NË ZMM SHËNJESTËR TË KOMUNIKIM-ADVOKIMIT .....	46
4.1. Pjesëmarrja e ORrMN dhe qytetare për adresim .....	46
DHE VENDIMMARRJE.....	46
4.1.1 Ç'farë kuptojmë me pjesëmarrje të OMSHC-ve dhe publikut në adresim dhe vendimmarrje? .....	46
4.1.2 A mund të zëvendësojë pjesëmarrja qytetare përgjegjësitë kushtetuese/ligjore të institucioneve shtetërore?.....	47
4.1.3 A kanë detyrime ligjore dhe institucionale të organeve shtetërore që të përfshijnë publikun dhe OMSHC-t në punët e tyre? .....	47
4.1.4 Cilat janë nivelet kryesore të pjesëmarrjes së ORrMN, të grupeve të interesit dhe publikut?.....	47
4.1.4.i Çfarë është informimi? .....	48
4.1.4.ii Çfarë është konsultimi? .....	48
4.1.4.iii Çfarë është dialogu? .....	49
4.1.4.iv Çfarë është partneriteti? .....	49
4.1.4.v Çfarë është negociimi?.....	49
4.2. PËRSE ËSHTË E RËNDËSISHME Pjesëmarrja e ORrMN .....	50
DHE E KOMUNITETIT NË VENDIMMARRJET LOKALE, .....	50
KOMBËTARE DHE RAJONALE? .....	50
4.3. ROLI I ORGANEVE SHTETËRORE NË NXITJEN E .....	51
Pjesëmarrjes së ORrMN dhe komunitetit në.....	51
ADRESIMIN E PROBLEMATIKAVE NË VENDIMMARRJE .....	51
4.4. DREJTIMET KRYESORE PËR PËRFSHIRJEN E OMSHC-ve DHE .....	52
GRUPET E INTERESIT NË REAGIM DHE VENDIMMARRJE .....	52
4.4.1 Informimi është hapi i parë drejt reagimit dhe përfshirjes së tyre në .....	52
vendimmarrje. ....	52
4.4.2 Forma të ndryshme reagimi dhe përfshirjeje. ....	53
4.5. Ç'FARË DUHET TË BËHET NGA ANA E ORrMN-ve? .....	53
4.5.1 Identifikoni çështjen/et.....	53
4.5.2 Identifikoni detyrat dhe përgjegjësitë e organeve shtetërore. ....	54
4.5.3 Përcaktoni qëllimin dhe objektivat tuaja.....	54
4.5.4 Cila është një zgjidhje? .....	54
5. CILËT JANË GRUPET E INTERESIT QË DUHET TË NDIKONI? .....	57
5.1 GRUPET KRYESORE TË SYNUARA QË DUHET TËMARRIN .....	59



PJESË NË INFORMIM DHE REAGIM.....	59
5.2. ÇFARË MËNYRASH KOMUNIKIMI DHE ADVOKIMI DUHET.....	63
TË PËRDORNI PËR TË NDIKUAR MBI VENDIMMARRËSIT?.....	63
5.3 KUJT DUHET T’U DREJTOHET/ADRESOHET PROBLEMATIKAT.....	68
PËR ZMM DHE BURIMET NATYRORE?.....	68
5.4 EFEKTI MBI MËNYRAT E PËRDORURA PËR INFORMIM, .....	68
ADRESIM DHE REAGIM.....	68
6. PRAKTIKAT MË TË MIRA TË KOMUNIKIMIT, ADVOKIMIT, LOBIMIT DHE PJESËMARRJES PUBLIKE – NË SHQIPËRI.....	70
1. Përvoja përse duhet kryer identifikimi dhe vlerësimi i faktorëve kërcënues në ZMM. #Rasti ORrMN .....	70
2. Përse u synua krijimi i forumit lokal mjedisor? #Rasti ORrMN .....	74
2.1 Ç’farë arrihet me ngritjen e forumit lokal mjedisor? .....	75
2.2 Struktura dhe funksionimi i forumit lokal mjedisor.....	76
3. Ndërmarja e veprimeve konkrete dhe të rritjes së përgjegjësisë për mbrojtjen e natyrës dhe të peizazhit. #Rasti i HEC-ve .....	77
4. Ndërmarja e veprimeve konkrete për mbrojtjen e natyrës dhe të burimeve natyrore. #Rasti i PK “Divjakë-Karavasta” .....	88
BIBLIOGRAFIA .....	111



*SHKURTESAT*

ACHIEVE	Shoqëria Civile Shqiptare për një Mjedis Evropian
AdRZM	Administratë Rajonale e Zonave të Mbrojtura
AdZM	Administratë e Zonave të Mbrojtura
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
FoLM	Forum Lokal Mjedisor
INCA	Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri
IShMP	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve
IUCN	Bashkimi Ndërkombëtar i Ruajtjes së Natyrës
JICA	Japan International Cooperation Agency
KM	Këshilli i Ministrave
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
OMShC	Organizatë Mjedisore e Shoqërisë Civile
ORrMN	Organizatë e Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PIM	Plan Menaxhimi
REC-Shqipëri	Qendra Rajonale e Mjedisit – zyra Shqipëri
RrKZMM	Rrjeti Kombëtar i Zonave të Mbrojtura Mjedisore
RrMN	Rrjeti i Mbrojtjes së Natyrës
RrPZM	Rrjeti Përfaqësues i Zonave të Mbrojtura
SENiOR-II	Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZM	Zonë e Mbrojtur
ZMM	Zonë e Mbrojtur Mjedisore





## PËRMBLEDHËSE

Udhëzuesi **“PËR MËNYRAT MË TË MIRA TË KOMUNIKIMIT, ADVOKIMIT, LOBIMIT DHE PJESËMARRJES PUBLIKE”**, për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile (OMShC), është përpjekje e Institutit të Ruajtjes së Natyrës në Shqipëri (INCA) për përmirësimin e dukshmërisë dhe të efikasitetit në punën e saj dhe organizatave të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës {“Forumi Shqiptar i Liqenit të Shkodrës”; “ILIRIA”, Tiranë; “Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit”, Kukës; “Miqësia”, Ulëz; (ish Qendra Adrtiatik) “Flag Pine”, Vlorë; “Green and Clean”, Korçë dhe “Mjedisore Çajupi”, Gjirokastër}.

Në strategjinë e hartuar për Rrjetin e Mbrojtjes së Natyrës “Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura”, synohet një përfaqje strategjike në adresimin afatgjatë të problematikës dhe të nevojave të rrjetit si dhe ngritja dhe zhvillimi i një sistemi për identifikimin e problematikave kryesore me të cilat përballen Zonat e Mbrojtura Mjedisore (ZMM) të përzgjedhura në rajonet: Tiranë, Vlorë, Gjirokastër, Korçë, Mat, Durrës, Kukës, Shkodër, Elbasan dhe Fier.

Një aspekt i rëndësishëm në Strategjinë e RrMN është “Rritja e Kapaciteteve të OMShC-ve”, për një veprim më efektiv, duke u ofruar atyre njohuri të reja, metodologji e teknika bashkëkohore, si edhe mundësi për shkëmbime e njohuri praktike. Është e qartë se organizimi i dobët dhe pozicionimi jo i duhur i tyre, mungesa e kapaciteteve dhe e logjistikës në kontekstin lokal, mendohet të jenë disa prej faktorëve që kontribuojnë në mungesën e efikasitetit dhe të jetë gjatësisë së tyre.

Organizatat e Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës (ORrMN) jo vetëm përballen me një mjedis ndryshimesh të shpejta, por nga ana tjetër, janë të shtërnguara me mundësitë e tyre që t’iu përshtatur këtyre ndryshimeve për shkak të ngurtësisë, të projekteve të vogla dhe tepër të kufizuara etj. Pra u nevojitet mbështetje për një zhvillim afatgjatë të kapaciteteve zhvilluese, duhet të inkurajohen për përmirësimin e imazhit dhe të mësojnë të ndërtojnë kapacitetet e tyre për t’u bërë organizata të vetë qëndrueshme.

Udhëzuesi, nisi si një ide e Rrjetit të Mbrojtjes së Natyrës, i paraparë në strategjinë “Për promovimin dhe adresimin e një menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura”, për nevojën e forcimit të vetë dijeve dhe trajnimit të ORrMN-ve si dhe grupeve të interesit, në kuadër të bashkëveprimit, informimit, komunikimit, adresimit dhe rritjes së pjesëmarrjes në strukturat vendimmarrëse, në të gjitha proceset sociale dhe



problematikave mjedisore për ruajtjen e natyrës dhe përdorimin e qëndrueshme të burimeve natyrore.

Udhëzuesi synon realizimin e qëllimeve strategjike të RrMN dhe do të ndihmojnë në forcimin e kapaciteteve të organizatave përbërëse, duke garantuar një rol të qëndrueshëm dhe transparent në procesin komunikimit, advokimit pse jo dhe të lobim-reagimit, dhe një veprim më efektiv për tematikën e promovimit dhe të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore, duke vënë theksin tek mënjanimi i problemeve dhe të ndikimeve negative në fushën e ruajtjes së natyrës dhe veçanërisht tek zonat e mbrojtura mjedisore (ZMM).

RrMN, krahas vijimit të procesit të ngritjes së kapaciteteve të tyre, të promovimit të natyrës, të forcimit të rolit dhe të rritjes së bashkëveprimit konkret me komunitetet, synon të nxisë organizatat e RrMN dhe të shoqërisë civile në qarqet kryesore të vendit, të kontribuojnë në qeverisjen e mirë, në angazhimin sa më të gjerë qytetar, duke lehtësuar bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet autoriteteve dhe partnerëve vendore dhe rajonale dhe në përafrimin me sfidat e integritit në BE, nëpërmjet fuqizimit të OMSHC-ve.

ORrMN do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në misionin/detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit të mjedisit, me synim promovimin e qëndrueshmërisë natyrore dhe të biodiversitetit në ZMM.

Shqipëria ka ndërmarrë disa hapa për të përmirësuar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile, por nevojitet më shumë punë për të arritur pjesëmarrjen dhe konsultimin efektiv të publikut në procesin e vendimmarrjes, veçanërisht në nivel lokal.

Kësisoj, ORrMN janë struktura të rëndësishme për të ndërmjetësuar pjesëmarrjen e suksesshme të publikut në procesin e vendimmarrjes, duke siguruar që mendimet dhe pikëpamjet e tyre të merren në konsideratë.

Ky udhëzues orienton përmbledhtasi, organizatat e RrMN dhe ato të shoqërisë civile, në lidhje me përfaqësimin në vendimmarrje dhe t'i bëjë ato të aksesueshme lehtësisht nga publiku, grupet e interesit apo/dhe institucionet e interesuar publike e private.

Ky udhëzues këshillon dhe u vjen në ndihmë ORrMN-ve dhe ekspertëve të tyre, për të identifikuar pikat e dobëta dhe ato të forta, që të mund t'i përdorin për përmirësimin dhe të rritjes së efikasitetit të punës të tyre. Shërben për të shpjeguar se si duhet bërë identifikimi, analizimi, adresimi dhe parandalimi i ndikimeve negative në praktikë.

Më konkretisht, ky udhëzues paraqet kornizë për zbatim të planifikuar dhe efikas të qëllimeve të përcaktuara, krahas ngritjes së kapaciteteve, por edhe të



tërheqjes së vëmendjes të organizatës jofitimprurese (OJF-ve) të tjera në nivel lokal, për adresimin e këtyre problemeve edhe domosdoshmërisht marrjen pjesë në diskutimet, vendimmarrjet përkatëse, në komunikim dhe lobim në rastet e veprimeve të dëmshme nga organet përgjegjëse, qofshin këto edhe të nivelit qëndror.

Nëpërmjet projektit “Promovimi dhe adresimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura” (Faza I), u synua aplikimi i një procesi vlerësimi për grumbullimin e informacionit faktik dhe real mbi të gjitha aktivitetet me impakt negativ brenda territorit në zonat e mbrojtura të përzgjedhura, duke përdorur metodologjinë e pyetësorëve individual, takimet dhe bashkëbisedimet me komunitetin dhe palët e tjera të interesuara për përdorimin e burimeve natyrore dhe mirëmenaxhmin e ZMM si dhe mjaft dokumente, programe, raporte, plane menaxhimi, emisione e kronika në TV, radio etj, në lidhje me këtë fushë.

Njëherësh, ky udhëzues komunikimi e advokimi ofrohen një game veprimesh të shënjestruara specifike për përmirësimin e komunikimit të dyanshëm të organizatave brenda RrMN dhe me mbështetësit e tyre. Kësisoj, merr jetëzim të të gjitha resurseve komunikuese dhe shfrytëzim maksimal të kapaciteteve komunikuese, mundësohet përmirësimi, tejkalimi i mangësive dhe i dobësive të kyçetë komunikimit dhe veprimit të përbashkët të organizatave të RrMN dhe OJF-ve partnere me komunitetin, nëpërmjet një reagimi të frytshëm.

Në procesin e përfshirjes së ORrMN-ve dhe të publikut në vendimmarrje, sfidë e vazhdueshme mbetet motivimi i tyre për të qenë pjesë e proceseve në nivel lokal. Shumica e tyre nuk kanë informacion të mjaftueshëm dhe nuk janë të vetëdijshëm për këto. Komunikimi me publikun është një process afat gjatë, i cili përmban një sere aktivitetesh dhe elementesh, siç janë informacionet, mënyrat dhe kanalet specifike mbi të cilat janë mbartur informacionet, shkaqet dhe qëllimet, si dhe përcaktimi i grupimeve të synuar që do të jenë prekur me problemin apo dhe me zgjidhjet që kërkohet.

Grupet e synuar mund të përfshijnë individët, institucione shtetërore e private, forumet publike, komunitetin shkencor dhe arsimor, biznesin, median, palët e intersuara, fermerët etj., që janë përzgjedhur për t’iu marrë informacione apo që do të jenë pjesë e procesit të komunikimit-adresimit-lobimit-reagimit dhe pjesëmarrjes publike.

Udhëzuesi është një mundësi më shumë promovimi, komunikimi, informimi, adresimi dhe aktivizimi për të gjithë organizatat e RrMN, OJF-ve lokale, grupet e interesit, institucionet, etj, të cilët duan të japin kontributin e tyre individual apo/dhe të përbashkët, në arritjen e synimeve për ruajtjen e natyrës, biodiversitetit, peizazhit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.



Për më tepër udhëzuesi kontribuon dhe shërben si platformë komunikimi dhe lobimi për rritjen e transparencës, informimin e publikut në drejtim të adresimit të problematikave dhe të pjesëmarrjes së tyre në vendimmajat lokale dhe qendrore.

Ndërtimi i marrëdhënieve efektive midis organizatave të RrMN, publikut dhe palëve të interesuara dhe partneriteti me strukturat qeverisëse qendrore e lokale, duhet të konsiderohet si domosdoshmëri e zhvillimit dhe të përmirësimit të situatës. *Koncepti i dialogut me publikun*, duhet të promovohet si një ndër praktikatat më të mira në lidhje me marrëdhëniet, informimin dhe adresimit e problematikave nga publiku për ZMM dhe burimet natyrore.

Gjithashtu, ndërtimi i marrëdhënieve të mira me publikun do ndikonte drejtpërdrejt në përmirësimin e efektivitetit të punës së organizatave të RrMN për identifikim, adresim dhe advokim-lobim-reagim ndaj problemeve mjedisore, të ndikimeve negative në ZMM dhe rritjen e pjesëmarrjes në nivelin lokal në vendimmarrje, në seancat kuvendore, të vëzhgimit, në takime dhe dëgjimet publike, në të drejtën e informimit, ankimit, të peticionit etj.

Nëpërmjet këtij udhëzuesi synohet vendosja e sistemit të qëndrueshëm të komunikim-advokim-lobim-reagimit me të gjitha palët e përfshira gjatë përçimit të mesazheve të INCA-s apo dhe të oraganizatave të RrMN në paraqitjen e drejtpërdrejt të anëtarëve dhe ekspertëve të tyre.



## 1. HYRJE

Në vitin 2013, me mbështetje të REC, në kuadër të programit SENiOR-A (Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri), financuar nga Qeveria Suedeze, Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) dhe shoqatat: Forumi i Liqenit të Shkodrës, Mbrojtja e Mjedisit-Kukës, Miqësia-Ulëz, PSEDA-ILIRIA-Tiranë, Qendra Adriatiku-Vlorë, Zagoria-Gjirokastër dhe Green&Clean-Korçë, krijuan Rrjetin për Mbrojtjen e Natyrës (RrMN).

Qëllimi i kryesor i këtij grupimi ishte:

- Forcimi i rolit të organizatave mjedisore të shoqërisë civile për ruajtjen e natyrës dhe rritjen e kontributit lokal në ruajtjen e zonave të mbrojtura dhe ekosistemeve të ujërave të ëmbla e habitateve detare”;
- Forcimi i bashkëpunimit midis organizatave të rrjetit; dhe
- Zhvillimi i iniciativave të qëndrueshme dhe mënyrave të reja për promovimin e vlerave lokale të zonave të mbrojtura dhe habitateve ujore.

Arritjet e këtij grupimi janë të shumëta dhe të suksesshme në nivel lokal dhe kombëtar. Tashmë ky grupim ka bërë historinë e vet lidhur me: -Rritjen e ndërgjegjësimit të komuniteteve lokale në çështjet e biodiversitetit; - Shkëmbimin e eksperiencave dhe ngritjen e kapaciteteve midis partnerëve; - Forcimin e rolit dhe pranisë së shoqatave në nivel lokal; -Krijimin, promovimin dhe zhvillimin shumëfunksional të Parqeve Natyrore Rajonale; - Përmirësimin e komunikimit dhe vizibilitetit në nivel kombëtar (website); - Përmirësimin e informacionit mbi vlerat natyrore dhe mundësitë e shijimit të tyre në Shqipëri; -Krijimin i database për rrjetin e zonave të mbrojtura në Shqipëri dhe të parqeve kombëtare në veçanti; -Organizimin dhe festimin e ditëve mjedisore dhe ato lokale shpirtërore; -Krijimin e Fotogalerive e të videove; -Publikime të ndryshme, duke filluar me “Ditari Natyrës”, postera, broshura, fletëpalosje, etj; -Pjesëmarrja në Panairët Kombëtare si i Trashëgimisë dhe Artizanatit apo ArgjiroFest\_ON, në Gjirokastër, etj.

Krijimi i këtij rrjetëzimi, prej 8 organizatash mjedisore, ishte një eksperiencë e vlefshme dhe e çmuar, jo vetëm për anëtarët e rrjetit, por edhe për INCA-n, e cila është organizata lider. Përvoja shumë dimensionale cilësohet në rritjen e kapaciteteve brenda stafit të INCA, shkëmbimin e eksperiencave midis partnerëve, por mbi të gjitha veprimi, drejtimi i një rrjeti në nivel lokal dhe kombëtar, krijimi i produkteve dhe gjurmëve të vlefshme ishin eksperiencë më rëndësishme. Jo vetëm për INCA-n, por edhe për organizatat partnere të rrjetit, mundësia e veprimit në rrjet ishte një eksperiencë shumë e vlefshme, për të



forcuar veprimin në nivel lokal, shkëmbimin e eksperiencave dhe veprimin njëkohësisht në nivel kombëtar nëpërmjet grupimit në rrjet.

E veçantë e këtij grupimi ka qënë mënyra e komunikimit dhe e marrëdhënieve të ndërsjellta për realizimin e programit të përgjithshëm, bazuar edhe në përvojën e bashkëpunimeve gjatë viteve të mëparëshme, duke krijuar lidhje me organizata të tjera lokale në vend dhe në kufitare me Shqipërinë. Nëpërmjet tyre janë duke krijuar bashkëpunime të reja dhe njëkohësisht është forcuar veprimin në nivel lokal.

RrMN është një aktor i rëndësishëm i shoqërisë civile në nivel kombëtar, bazuar në vlerat dhe intereset e përfaqësimit dhe ndikimit të tyre në shoqëri. Toleranca, solidariteti, shprehja e lire e ideve dhe mendimeve janë pjesë e vlerave të vendosura dhe cultures së punës së organizatave të RrMN.

INCA dhe ORrMN kanë tashmë një përvojë të mirë dhe bashkëpunim me komunitetet lokale dhe institucionet qendrore, vendore dhe rajonale. Shumica e projekteve të zbatuara nga ORrMN kanë kërkuar bashkëpunimin me organet vendore, por edhe me strukturat e institucioneve mjedisore në qarqe.

Edhe në të ardhmen puna do të vazhdojë të përqendrohet për të forcuar dhe siguruar vazhdimësinë e këtij bashkëpunimi, megjithëse jemi të ndërgjegjshëm për vështirësitë që hasen, sidomos kur zëri ynë nuk përputhet me mendimet e tyre.

Në kuadër të SENiOR-II, koncepti i organizimit në rrjet vazhdon të ngelet një mundësi shumë e mirë, për të vijuar përvojën e vlefshme dhe frytdhënëse të veprimit në nivel kombëtar dhe lokal, por që kërkon një mentalitet krejt ndryshe nga SENiOR-A. Tashmë, krahas forcimit më tej të kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (pjesëtare të rrjetit), kërkohet që ato të jenë të afta të luajnë rolin e katalizatorit, për të garantuar pjesëmarrjen sa më të gjerë proaktive të komuniteteve lokale si në vendimmarrje ashtu dhe në ndarjen e përfitimeve që vijnë nga menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, duke kontribuar njëherazi në ruajtjen dhe promovimin e vlerave të larta të biodiversitetit që karakterizojnë natyrën shqiptare.

Në fazën e parë të SENiOR-II procesi u vijua me ngritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të ORrMN, të Administratave të ZM dhe të OJF-ve lokale të pranishme në zonat e mbrojtura të përzgjedhura dhe pjesëmarrëse në lidhje me njohjen dhe interpretimin e dispozitave e të akteve nënligjore në fuqi, për ruajtjen e natyrës, kryerjen e procesit të vlerësimit të aktiviteve me impakt negativ, brenda territorit në zonat e mbrojtura mjedisore si dhe për njohjen, plotësimin dhe interpretimin e të dhënave të grumbulluara nga pyetësi individual, bazuar në metodikën përkatëse.



Kësisoj sfida në fushën e mbrojtjes së natyrës u fokusuar në krijimin e një ekspertize të mirë për të përmbushur qëllimin kryesor dhe objektivat specifike të projektit. Nëpërmjet bashkëbisedimeve me palët e interesuara dhe me zbatimin e një metodologjie (pyetësor/individual) efektive ku u identifikuan dhe u trajtuan, në përgjithësi dhe veçanti, mangësitë kryesore, vlerësimi i tyre në lidhje me njohjen e problematikave aktuale që shqetësojnë dhe shoqërojnë ruajtjen, administrimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura mjedisore dhe të burimeve të tyre natyrore.

Të dhënat e siguruara u/dhe do të përdoren me synimin për të ndikuar mbi vendimmarrësit, organizatat e ndryshme dhe publikun e gjerë që t'i kushtojnë më shumë vëmendje Rrjetit Kombëtar të Zonave të Mbrojtura Mjedisore (RrKZMM) dhe arritjeve të kriterëve të BE-së në këtë fushë, të cilat janë dhe objekt i fazës së dytë të SENiOR-II, të shprehura edhe nëpërmjet këtij udhëzuesi.

Me këtë vlerësim, më pas dhe analizimin e problemeve të shkaktuara, krahas adresimit u synua që të arrihej qëllimi për tërheqjen e vëmendjes publike drejt problematikave kryesore me të cilat përballen sot zonat e mbrojtura mjedisore, rritjen e reagimit ndaj tyre si dhe caktimin e rekomandimeve përkatëse për minimizimin e ndikimeve negative.

Hartografimi i presioneve dhe kërcënimeve ndaj zonave të mbrojtura ekzistuese dhe ekosistemeve të pambrojtura, njëherazi shërben edhe për të identifikuar/përcaktuar veprimet emergjente që duhen marrë për kërcënimet ndaj sistemit të zonave të mbrojtura të vendit.

Përvoja e këtyre viteve për organizatat e RrMN kërkon një angazhim më të madh për adresimin e problematikave dhe të reagimit ndaj tyre. ORrMN, krahas vijimit të procesit të ngritjes së kapaciteteve të tyre, të promovimit të natyrës, të forcimit të rolit dhe të rritjes së bashkëveprimit konkret me komunitetet, palët e tjera të interesuar, duhet të ndërmarrin iniciativa dhe të përfshihen më mirë në advokim-lobim-reagim për ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit në nivel lokal dhe qëndror, duke rritur presionin dhe pjesëmarrjen e tyre në qeverisjen e qëndrueshme të burimeve natyrore, nëpërmjet pjesëmarrjes, sensibilizimit dhe informimit e anëtarëve të këshillave bashkiake si dhe në komisionet përkatëse lokale, rajonale dhe të Kuvendit të Shqipërisë.

E parë në kuadër të analizave dhe synimeve strategjike që kërkohen nga organizatat e RrMN, rezulton se ka ende shumë punë për të bërë, në drejtim të forcimit të kapaciteteve, të rritjes së pavarësisë, të ngritjes së rolit të tyre për adresimin e problemeve dhe të ndikimeve negative në strukturat lokale e qëndrore, sipas përkatësisë, për përmirësimin e situatës, të gjëndjes mjedisore



e të jetesës së banorëve, duke promovuar dhe zhvilluar veprimtari që sjellin një ndikim pozitiv në komunitet.

Gjatë fazës së parë të zbatimit të projektit ORrMN ka përcaktuar dhe pikat e forta dhe të dobëta, të cilat morrën parasysh gjatë zbatimit të fazës së dytë të programit SENiOR-II.

### CILAT JANË PIKAT E FORTA DHE TË DOBËTA TË RRJETIT?

#### A. Pika të forta për RrMN

- Njohje e mirë e terrenit dhe shërbime efektive.
- Aftësia e përshtatjes dhe rinovimit.
- Kuptimi i mirë i metodologjive dhe instrumenteve të pjesëmarrjes.
- Përkushtimi afatgjatë.
- Aftësi në organizimin e veprimtarive promovuese me komunitetin.
- Efektiviteti në kosto.

#### B. Pika të dobëta për RrMN

- Kapacitet i jo duhur institucional, administrativ dhe financiar.
- Qëndrueshmëri jo solide.
- Mungesa e ulët në komunikim me organizata të tjera.
- Ndërhyrjet në shkallë të vogël.
- Pjesëmarrje e kufizuar në komitetet vendimmarrëse, panele qytetarësh, dhe për mobilizimin e komuniteteve, etj.
- Vështirësi në përçimin e mesazheve, të konsultimeve dhe advokimit me politikëbërësit, qeveritarët, median dhe komunitetet.





## 2. METODOLOGJIA

Ky udhëzues u vjen në ndihmë organizatave RrMN dhe gjithë grupeve të interesuara të komuniteteve e aktorëve të tjerë, të cilët kërkojnë të bëhen pjesë e përpjekjeve për të rigjallëruar dhe forcuar më tej rolin dhe ndikimin e tyre përfushën e ruajtjes së natyrës.

Kjo nismë përpiqet të nxisë aksionin dhe përfshirjen e komuniteteve, duke synuar vendosjen e një praktike të suksesshme, qëdo të shërbejë si platform bazë përshtrirjen e saj të më tejshme në zona të tjera të vendit dhe më gjerë.

Metodologjia përfshin konceptet, rastet dhe praktikatat më të mira për advokim-lobim-reagim, dhe metoda të tjera të pjesëmarrjes apo zbatimit të presionit publik në procesin e vendimmarjes, në menaxhimin e ZMM, në hartimin dhe zbatimin e strategjive, politikave, programeve apo/dhe të planeve të përgjithshme vendore, duke pasur në fokus ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe peizazhit natyror.

Nëpërmjet këtij udhëzuesi arrihet një përfaqje strategjike e angazhimit të organizatave RrMN dhe të OJF-ve partnere në adresimin afatgjatë të problematikës dhe promovimit të vlerave kryesore në Zona të Mbrojtura Mjedisore.

ORrMN, krahas vijimit të procesit të ngritjes së kapaciteteve të tyre, të promovimit të natyrës, të forcimit të rolit dhe të rritjes së bashkëveprimit konkret me komunitetet, palët e tjera të interesuara, po ndërmarrin iniciativa duke u përfshirë më mirë në proceset e advokim-lobim-reagimit ndaj problematikave të ruajtjes së natyrës dhe të biodiversitetit, në nivel lokal dhe qëndror, duke rritur presionin dhe pjesëmarrjen e tyre në qeverisjen e qëndrueshme të burimeve natyrore, nëpërmjet pjesëmarrjes, sensibilizimit dhe informimit e medias, anëtarëve të këshillave bashkiake, të komisioneve përkatëse lokale, rajonale dhe të Kuvendit të Shqipërisë.

Përbën një udhëzues specifik i ndërthurur mes instrumentave të komunikimit, advokim, lobimit, adresimit, reagimit dhe trajnimit, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme ndërgjegjësuese-edukuese, për një pjesëmarrje më të gjerë dhe aktive të përfaqësuesve të komuniteteve lokale në forumet e ndryshme vendimmarrëse apo/dhe konsultative, për të minimizuar problematikën dhe për të nxitur promovimin dhe menaxhimin e përbashkët të burimeve natyrore.

Metodologjia do të shpërndahej tek ORrMN dhe tek OJF-të e tjera, dhe në versionin elektronik do të vihet në dispozicion në faqen zyrtare të INCA-s.



## 2.1. SYNIMET E UDHËZUESIT

### Qëllimet e përgjithshme

1. Përmirësimi i transparencës së punës të organizatës së INCA-s dhe të ORrMN.
2. Përmirësimi i komunikimit të INCA-s dhe të ORrMN.
3. Përmirësimi i imazhit të organizatës së INCA-s dhe të ORrMN.
4. Realizimi i interesave dhe qëllimeve strategjike të ORrMN, për ruajtjen dhe promovimin e një menxhimi të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në Shqipëri.
5. Përmirësimi i metodologjisë së komunikimit dhe informimit të publikut të gjerë, por edhe të grupeve të interesuara mbi procesin e politikëbërjes, në funksion të mbështetjes së ruajtjes të natyrës.

### Qëllimet specifike

1. Informim i përmirësuar i publikut dhe i palëve të interesuara për ruajtjen dhe promovimin e vlerave dhe të burimeve natyrore.
2. Pjesëmarrje më të gjerë të përfaqësuesve të komuniteteve lokale, lidhur me advokim-lobim dhe reagimin për minimizimin e problematikave dhe menaxhimin e burimeve natyrore.
3. Të nxisë debat të gjerë dhe të fokusuar lidhur me transparencën dhe ngritjen e vetëdijes qytetare, për t'u bërë pjesë aktive e vendimmarrjeve.
4. Promovim të konceptit për ORrMN e OJF mjedisore partnere mbi domosdoshmërinë e pjesëmarrjes në adresim-lobim të problematikave negative të menaxhimit dhe të përdorimit të burimeve natyrore.
5. Nxitjen e të menduarit kreativ për mënyra të reja të zgjidhjes së sfidave të vjetra dhe pranimit të sfidave të reja, në kuadër të adresimit dhe lobimit për problematikën dhe impaktet negative në menaxhimin e zonave të mbrojtura mjedisore, biodiversitetit dhe peizazhit natyror.
6. Integrimin e marrëdhënieve, të informimit, pjesëmarrjes dhe adresimit ndërmjet ORrMN me publikun, grupet e ineteresit, median dhe marrëdhëniet ndërkufitare për bashkëveprim në fushën e ruajtjes së natyrës.
7. Rritja e aftësisë së nevojshme për vetë ndërgjegjësim dhe mobilizimin e komunitetit, të palëve të interesuara dhe përdoruesve të burimeve natyrore.
8. Zhvillim të qëndrueshëm të komuniteteve dhe burimeve të tyre natyrore, për mirëqënie sociale, ekonomike, ekoturistike dhe mjedisore.
9. Numër në rritje i prononcimeve dhe vëmendjes mediatike drejt çështjeve të nxehta në fushën e ruajtjes së natyrës.
10. Tërheqja e vëmendjes dhe më pas realizimi i veprimeve konkrete nga politikëbërësit, strukturat përgjegjëse qeveritare dhe lokale, të agjencive monitoruese dhe ligjzbatuese për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe peizazhit natyror.



Udhëzuesi ndihmon dhe këshillon në përmirësimin e paraqitjes së shoqërisë civile, dukshmërisë dhe njohjes së saj nga ana e qytetarëve. Funkzioni kryesor i udhëzuesit është të specifikojë mënyrat, mjetet dhe format e përpunimit të informacionit, të cilat ORrMN dhe OJF-t partnere dëshirojnë t'i ndajë me grupet e synuara.

Vetë udhëzuesi do të veprojë në përmirësimin e kapaciteteve të brendshme të INCA-s, për vendosjen e marrëdhënie të qëndrueshme me organizatat e RrMN si dhe me OJF-t mjedisore, komunitetet vendore, organet shtetërore e studimore, komunitetin e biznesit, mediat dhe politikanët.

Udhëzuesi është në mbështetje të strategjisë së RrMN, në përputhje me vizionin, misionin, qëllimet dhe vlerat e INCA-s dhe ORrMN, të përfaqjes strategjike të angazhimit të tyre në adresimin afatgjatë të problematikës dhe promovimit të vlerave kryesore në Zona të Mbrojtura Mjedisore.

Këshillat e këtij udhëzuesi konsistojnë:

- Krijimin e modeleve të adresimit dhe advokim-lobimit për një vendimmarrje dhe menaxhim sa më të qëndrueshëm të ZMM dhe burimeve natyrore lokale, duke përfshirë konceptet, rastet dhe praktikatat më të mira për advokim-lobim-reagim dhe metoda të tjera të zbatimit të presionit publik në procesin e vendimarrjes.

- Nxitjen e ngritjes së FoLM (Forumeve Lokale Mjedisore) me përfaqësues nga OJF-t lokale, ekspert dhe operatorë lokal, të cilët do të shërbejnë si strukturë profesionale e gatshme për të marrë pjesë në proceset advokuese dhe këshilluese, pranë strukturave vendore përgjegjëse për menaxhimin e burimeve natyrore.

- Angazhimi dhe evidencimi i përfshirjes së komunitetit dhe shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes së menaxhimit të zonave të mbrojtura, të vlerave dhe të ruajtjes së natyrës në përgjithësi.

Për finalizimin e udhëzuesit INCA është mbështetur gjërësisht dhe ka marrë në considerate analizat dhe konkluzionet e nxjerra gjatë projekteve të realizuar me REC-Shqipëri, në lidhje me ruajtjen dhe promovimin e natyrës shqiptare, kryesisht në programet **ACHIEVE** dhe **SENIOR-II**, në **Ligjin për të drejtën e informimit** dhe tek **Konventa AARHUSIT**, të cilat përbëjnë një interes të veçantë të OMSHC-vetë fushës së ruajtjes të natyrës në Shqipëri.

### **Programi ACHIEVE.**

Në kuadër të zbatimit të projektit “Fuqizimi i OMSHC-ve shqiptare për promovimin dhe ruajtjen e natyrës në Shqipëri”, me financim nga Bashkimi Evropian (Delegacioni në Shqipëri), si aktiviteti kryesor i projektit ishte përgatitja dhe shpërndarja e një platforme investigimi dhe zbatimi në praktikë të legjislacionit për ruajtjen e natyrës në Shqipëri.



Platforma e investigimit dhe e monitorimit përgatitur nga INCA dhe e përdorur nga ana e ORrMN, konsiston në njohjen me procedurën e hartimit dhe të zbatimit të llojeve të akteve administrativ në veprimtarinë ekzekutive, që përdoren për përmbushjen e funksioneve të tyre. Në platformën e investigimit u përfshinë elementë të përgjithshëm të grupit të dokumenteve administrative si strategjitë, planet e veprimit, planet e programet e punës, programe të bashkëpunimit me vendet e ndryshme dhe çdo dokument tjetër, i cili kërkon angazhim të burimeve njerëzore apo financiare.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë kontrolluese apo dhe verifikuese anëtarët e ORrMN dhe të OJF-ve mjedisore lokale janë njohur mirë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në lidhje me fushën e ruajtjes së natyrës, në bazë të trajnimeve të organizuara dhe të realizuara nga INCA. Një veprim i tillë është i domosdoshëm pasi në këtë mënyrë bëhet më i lehtë verifikimi dhe kontrolli i zbatimit të dispozitave ligjore në terren nga ana e punonjësve dhe rojeve mjedisore (rangersat) të ZMM.

Rekomandimet e kësaj platforme, të cilat janë një ndihmesë për adresimin dhe advokim-lobimin e problematikave në ZMM, për diskutimet, informimin dhe përfshirjen e komuniteteve e të palëve të interesuara në vendimmarrje, konsistojnë:

- Në fushën e mjedisit, lidhet direkt me arritjen e standardeve mjedisore dhe detyrën jetësore për të luftuar degradimin e mjedisit me qëllim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore dhe të përafrimit të direktivave përkatëse të zogjëve dhe habitatit;
- në njohjen dhe zbatimin e “Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit”, Konventave, dispozitat ligjore vendase në fuqi për ruajtjen e natyrës;
- njohjen e legjislacionit për Ruajtjen e Natyrës, nga ORrMN dhe punonjësit e institucioneve përgjegjëse shtetërore, është shumë e pakët;
- institucionet, punonjësit e tyre apo veçanërisht institucionet ligjzbatuese në nivel vendor, por në disa raste edhe qëndror, përfshirë ORrMN dhe OJF-të mjedisore, nuk e dispozojnë këtë legjislacion, e për rrjedhojë nuk e njohin;
- institucionet përgjegjëse nuk kanë një plan konkret për botimin, shpërndarjen dhe programe trajnimi për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit për fushën e ruajtjes së natyrës dhe të investigimit të zbatimit të tij në terren;
- mosnjohjen e përgjegjësive, kompetencave dhe të rolit të tyre për zbatimin e legjislacionit të fushës së ruajtjes së natyrës;
- funksionimin me hope të këtyre strukturave që ka sjellë mos zbatim të plotë dhe shkelje të dispozitave ligjore.



**Programi SENiOR-II.**

Objektivi përgjithshëm i projektit “Promovimi dhe adresimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura” është të kontribuojë në menaxhimin e qëndrueshëm, nëpërmjet forcimit të rolit aktiv dhe pjesëmarrës të OMSHC-ve. Nëpërmjet këtij projekti synohet fuqizimi i rolit dhe i kapaciteteve teknike të anëtarëve të ORrMN për identifikimin dhe reagimin ndaj problematikave në ZMM si dhe përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse për menaxhimin e tyre.

Projekti do të mundësojë vlerësimin e nevojave dhe nxitjen e një bashkëpunimi sa më efektiv mes shoqërisë civile dhe strukturave ligjzbatues të fushës së natyrës, në nivel qendror si Ministria e Turizimit dhe Mjedisit (MTM) dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), dhe në nivel lokal Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdRZM) dhe pushteti vendor, si dhe partneritetin mes tyre në iniciativa të përbashkëta dhe aktivitete që kanë për qëllim adresimin dhe minimizimin e problemeve negative.

Në fazën e parë, të zbatimit të projektit, sfida në fushën e mbrojtjes së natyrës u fokusua në krijimin e një ekspertize të mirë për të përmbushur qëllimin kryesor dhe objektivat specifike të projektit. Ky projekt identifikoi dhe trajtoi, mangësitë kryesore të zonave të mbrojtura mjedisore të marra në studim. Kryerja e vlerësimit u realizua duke ndërmarrë një numër të gjerë takimesh konsultative, për grumbullimin, vlerësimin dhe analizimin e materialeve të ndryshme, në lidhje me ndikimeve negative në ZMM e përzjedhura. U punua për ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi për identifikimin e problematikave kryesore me të cilat përballen ZMM.

Në këtë drejtim INCA hartojë dhe më pas zbatojë një metodologji për “Identifikimi i problematikave kryesore të administrimit të zonave të mbrojtura, perceptimi i rolit të organizatave të RrMN e të OJF-ve partnere dhe diskutimi në publik”, e cila merrte në konsideratë procesin e grumbullimit dhe analizimit të fakteve të mblledhura si dhe tërheqjen e vëmendjes publike drejt problematikave kryesore me të cilat përballen sot këto zona pilote.

Vlerësimi i situatës ishte rezultat i takimeve dhe i investigimeve në terren të organizuara me përfaqësues komuniteteve, kryepleqtë, administratorët e njësive administrative, të bizneseve, shkollat, OJF-ve mjedisore, administratat vendore dhe të AdRZM, etj. Nëpërmjet këtyre takimeve u siguroi një pamje e përgjithshme e problemeve ekzistuese dhe potenciale në zonën e mbrojtur, të cilat kanë ndikim në biodiversitet, ekosisteme, peizazhe, burimet natyrore dhe në zhvillimin vendor social-ekonomik.



Procesi i identifikimit dhe analizimit të problemeve kryesore dhe të ndikimeve negative në menaxhimin e zonave të mbrojtura u këshillua edhe me planet e menaxhimit për zonat e mbrojtura të marra në studim.

Të dhënat që u grumbulluan, për vlerësimin e mangësive, u fokusuan mbi një grup elementesh të biodiversitetit, por dhe të objektivave për matjen e suksesit të ruajtjes dhe menaxhimit të ZMM. Instrumenti kryesor i metodologjisë ishte anketimi me anë të pyetësorëve dhe hartëzimi i ndikimeve negative, sipas ZMM të përzgjedhura.

Vlerësimi parashtroj një model zhvillimi afatgjatë për ZMM, duke paraqitur rastet pozitive të menaxhimit, efektet pozitive të reformave gjatë këtyre viteve, rekomandimet profesionale, të paanshme, të ekuilibruara, gjithëpërfshirëse, mbi mundësitë e përdorimit të qëndrueshëm dhe rikuperimit të burimeve dhe zbatimit të parimeve të menaxhimit të mjedisit natyror, bazuar në menaxhimin e integruar dhe të qëndrueshëm dhe një plan veprimi lidhur me arritjen e targeteve të planifikuara.

Veprimtaria e pakontrolluar njerëzore, për vite rradhazi, ka shkaktuar një stres të fuqishëm në ZMM, i cili ka patur një ndikim të shoqëruar me dëme të mëdha me natyrë të theksuar demografike dhe ekologjike. Intensiteti i këtyre ndikimeve përcaktohet ndjeshëm nga faktorë social-ekonomike të tillë si rritja e popullsisë apo shpopullimit të zonave rurale, bujqësia, blegtoria dhe praktikatat jo të mira të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave.

Në analizën dhe vlerësimin e shqetësimeve iu dha rëndësi dhe marrjes parasysh të disa efekteve antropogjene.

Rekomandimet që janë paraqitur përbëhet nga një listë e detajuar në lidhje me impaktet negative dhe mënjanimin e problematikave në procesin e administrimit dhe të menaxhimit të rrjetit kombëtar të ZMM. Ndërhyrjet e rekomanduara janë identifikuar duke marrë parasysh aktivitetet që janë planifikuar në kuadër të projektit “Promovimi dhe adresimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore të ZMM”, në zbatim të Programit SENIOR-II, të zbatuar nga REC Shqipëri dhe financuar nga qeveria Suedeze.

### **Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.**

Rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga organet publike. Rregullat e parashikuara kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. Ligji ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së organeve publike.



**Sipas ligjit:**

1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.
2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.
3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.
4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit.

Ndër të tjera ligji përcakton: ...Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuesit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuar në këtë ligj. Kërkesa për informim duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe mbiemrin e kërkuesit;
- b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
- c) përshkrimin e informacionit që kërkohet;
- ç) formatin në të cilin preferohet informacioni;
- d) çdo të dhënë që kërkuesi gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

Si rregull...Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve, kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.

Disa ndryshime ligjore dhe nënligjore po sjellin pozivitet në procesin e informimit dhe të vendimmarrjes. P.sh. miratimi i ligjit nr.12/2015, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, u bë e mundur që aplikimet për vlerësimin e ndikimit në mjedis të mos kryhen më pranë QKL-së (sot QKB - Qendra Kombëtare e Biznesit), por direkt pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe për rrjedhojë ka ndikuar në përmirësimin e procesit të informimit dhe konsultimeve të publikut, si dhe ka eliminuar konceptin “*miratim në heshtje*” për procesin e VNM-së.

**Konventa e AARHUSIT.**

“Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit” ka si objektiv të kontribuojë në mbrojtjen e të drejtës së çdo individi të brezave të sotëm e të ardhshëm, për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin



dhe mirëqënien e tij, çdo palë do të garantojë të drejtën e publikut, për të pasur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t'iu drejtuar gjykatës, në lidhje me çështje të mjedisit në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente.

Sipas Konventës, çdo Palë do të marrë masat e nevojshme legislative, rregullatore dhe masa të tjera, duke përfshirë masat për të arritur një përputhje midis klauzolave që zbatojnë kushtet e të drejtës së informimit, pjesëmarrjes dhe të drejtës për t'ju drejtuar gjykatës në këtë Konventë, si dhe masat e duhura të zbatimit rigoroz për të krijuar dhe ruajtur një kuadër të qartë, transparent dhe të qëndrueshëm për zbatimin e klauzolave të kësaj Konvente; të përpiqet të sigurojë që zyrtarët dhe organet shtetërore të ndihmojnë dhe udhëheqin publikun, kur kërkojnë të informohen për mjedisin, kur kërkojnë lehtësimin e pjesëmarrjes në marrjen e vendimeve mjedisore dhe kur kërkojnë t'i drejtohen gjykatës për çështjet e mjedisit; të promovojë edukimin mjedisor dhe rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor të publikut, veçanërisht për mënyrën e marrjes së informacionit për mjedisin, të marrjes pjesë në vendimmarrjen dhe të ushtrimit të së drejtës për t'ju drejtuar gjykatës; të parashikojë masa për njohjen e duhur dhe mbështetjen e grupimeve, organizatave, komuniteteve që promovojnë mbrojtjen e natyrës dhe do të sigurojë që sistemi i vet ligjor kombëtar, të jetë në përputhje me këtë detyrim.

Konventa nuk do të kërkojë pakësimin/dobësimin e të drejtave ekzistuese të publikut për të pasur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'ju drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit; të promovojë zbatimin e parimeve të kësaj Konvente në proceset ndërkombëtare të vendimmarrjes për mjedisin dhe brenda kuadrit të organizatave ndërkombëtare në çështjet që lidhen me mjedisin; të sigurojë që personat, të cilët ushtrojnë të drejtat e tyre në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente nuk do të gjykojnë, persekutohen, ose ngacmohen në çfarë do mënyre për përfshirjen e tyre.

Kjo klauzolë nuk do të ndikojë autoritetin e gjykatave kombëtare në dhënien e kostove të arsyeshme gjatë procedurave gjyqësore, dhe sipas kësaj Konvente, publiku do të ketë të drejtën për të pasur informacion, do të ketë mundësinë për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe do të ketë të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, pa u diskriminuar, për sa i përket nënshtetësisë, kombësisë, vendbanimit dhe në rastin e një personi juridik, pa u diskriminuar për shkak të vendit të tij të regjistrimit ose të qendrës efektive të veprimtarive të tij.





## ***2.2. UDHËZUESI SI MEKANIZËM PËR FORCIMIN E ROLIT ADVOKUES DHE REAGUES TË ORGANIZATAVE TË RrMN.***

Udhëzuesi shërben si mekanizëm për forcimin e rolit të organizatave të RrMN, por edhe të OJF të tjera në nivel lokal e kombëtar, për promovimin dhe advokimin e një menaxhimi të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në Shqipëri. Gjithashtu, këshillon për ndërmarrjen e iniciativave për investigimin dhe monitorimin e zbatimit të legjislacimit mjedisor në nivel vendor e qendror, në nxitjen dhe marrjen e nismave për përmirësimin e strategjive, politikave dhe të programeve në lidhje fushën e ruajtjes së natyrës si dhe rritjen e vigjilencës për aktet dhe krimet ndaj natyrës e biodiversitetit.

Njëkohësisht, OMSHC-ve të rrjetëzuara u këshillon dhe u inkurajon dialogun për qeverisjen dhe zhvillim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, përmes pjesëmarrjes dhe partneritetit. Shoqëria civile është vlerësuar si platformë e veprimit vullnetar kolektiv për interesa, qëllime dhe vlera të përbashkëta në shoqëri. Për këtë arsye, fuqizimi i rolit të shoqërisë civile është objektiv i rëndësishëm i agjencive dhe organizmave ndërkombëtarë që operojnë në Shqipëri, si në rastet e programeve ACHIEVE dhe SENiOR-II, të zbatuar nga REC-Shqipëri, nëpërmejt aktiviteteve të INCA-s dhe ORrMN-s.

Të gjitha impaktet e identifikuara janë shqetësime të banorëve dhe të përdoruesve të burimeve natyrore, të administratave përkatëse, të cilët kanë marrë pjesë aktive në hartimin dhe miratimin e listës së ndikimeve negative. Për mënjanimin e këtyre dukurive është e domosdoshme pjesëmarrja dhe fuqizimi i rolit të komunitetit apo dhe i grupeve të interesit, në proceset vendimmarrëse, me qëllim të krijimit ose përmirësimit të politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit të mirëqenies së qytetarëve, të promovojnë përgjegjësinë, rrisin besimin dhe të forcojnë përkushtimin drejtë përmirësimit të qeverisjes dhe të kufizojnë praktikatat korruptive.

Pjesëmarrja qytetare ka synim bashkërendimin dhe koordinimin e veprimeve në mes institucioneve, shoqërisë civile, sektorit privat dhe publikut në përgjithësi. Niveli i pjesëmarrjes së publikut në qeverinë lokale shpesh përdoret si indikator për të vlerësuar nivelin e demokracisë dhe respektimit të ligjit në institucionet e shtetit. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve kërkon, informacione, aftësi, mjete financiare dhe kohë.

Praktika e deritashme ka dëshmuar se qytetarët janë më shumë të interesuar për pjesëmarrje në vendimmarrje lokale, në rastet kur vendimi prek drejtpërdrejt interesat e ngushta të tyre.

Drejtimet kryesore të udhëzuesit janë varësisht nga rëndësia e problematikave të shtruar në bashkëbisedimet e hapura me grupet e interesit për të finalizuar



dhe hartëzuar listën e faktorëve të degradimit dhe të ndikimeve negative në territoret e ZMM si më poshtë:

- Të gjitha veprimet që shkaktojnë dëmtime, degradim, fargmentim, varfërim dhe copëtim të habitateve, ekositemit dhe peizazhit, në një masë të konsiderueshme duke humbur edhe lloje të veçanta e të rëndësishme të florës dhe faunës.
- Rënia e numrit të llojeve, të endemizmeve apo të vlerave të larta, me interes për komunitetin evropian si dhe kërcënimit të statusit mbrojtës, erozion gjenetik apo dhe introduktim të llojeve të huaja.
- Mbi shfrytëzimi dhe përdorimi i mekanizmave jo ligjor në zonat me burime të pasura natyrore ka sjellë zhdukjen e disa llojeve të bimëve, shpendëve, të peshkut apo dhe të habitateve, llojeve të rralla e të kërcënuara.
- Zvogëllimi, dëmtimi apo tjetërsimi i sipërfaqes pyjore, prerjet abuzive dhe mbikullotje e pakontrolluar dhe rreziku i përhapjes së zjarreve. Dëmtimi i pyjeve ka sjellë shkatërrime në shoqërimet bimore, rrezikimin e zhdukjes së llojeve bimore e shtazore, etj. Ky shfrytëzim ka ndodhur për qëllime tregtimi e abuzimin, për të siguruar lëndë për ngrohje, prodhime të ndryshme etj. Shpesh shkalla e shfrytëzimit ka qënë në nivele tepër të larta, duke sjellë degradimin e sipërfaqeve të tëra, humbjen e katit të ulët të bimësisë pyjore, të kullotave dhe bimëve mjekësore dhe erozion të tokave, të cilat shoqërohen me kosto ekonomike dhe sociale.
- Përndjekja e shpendëve dhe të kafshëve të egra, gjuetia, mbipeshkimi, peshkimi ilegal dhe përdorimi i mjeteve të ndaluara.
- Përmbytjet dhe erozioni i tokave bujqësore, bregdetare, i brigjeve të lumenjëve, kodrinor dhe malor ka rrezikuar jo vetëm humbje të sipërfaqeve të tokës dhe pyjeve, por edhe humbje të trashëgimisë kulturore.
- Lumenjtë, përrenjtë dhe brigjet janë tej shfrytëzuar për marrje inertesh, ndërtime gjithfarëllojshme, duke shkaktuar denatyrim të shtretërve.
- Ndryshimet e rregjimit ujqor, ndërtimet e HEC, devijimi i rrjedhjeve natyrore të ujërave nëpërmjet tubacioneve, kanaleve, pritave, etj. HEC-ve shkaktojnë pasoja, ndoshta të pakthyeshme për biodiversitetin, habitatet dhe peizazhin natyrore. Gjithashtu devijimi i rrjedhjeve natyrore të ujërave nëpërmjet tubacioneve, paksojnë sasinë e ujërave, shkaktojnë tharjen e trupave ujore dhe çënojnë nevojat e popullsisë për ujë dhe ujë.
- Guroret, minierat dhe gërmimet janë tej të dëmshme për ZMM e peizazhin, duke shkaktuar denatyrim të tyre.
- Mungesa e parandalimit të veprimtarive të paligjshme; aktivitete të shfrenuara njerëzore dhe tej popullim të zonave natyrore kanë çënuar



shumë territore dhe lloje të marra në mbrojtje nga legjislacioni kombëtar dhe konventat ndërkombëtare.

- Urbanizimi, ndërtimi i infrastrukturës, ndërtimet pa leje, qendrat turistike, fshatrat, i fermave, plantacioneve, etj., të kësaj natyre që bëhen mbi peizazhet dhe zonat me vlera natyrore si dhe mbi botën e tyre të gjallë, nuk përfshijnë thjesht reduktimin e sipërfaqeve të disa formave të vegjetacionit dhe zgjerimin e disa të tjerave, por edhe fragmentizimin e vegjetacionit, për rrjedhojë përkeqësimin e cilësisë së ujërave dhe peizazheve.
- Ndryshimet dhe modifikimet në përdorimin e tokës apo shfrytëzimi i nëntokës.
- Mbetjet e ngurta, hedhja e inerteve, shtimi i ndotjes nga mbetjet urbane e rurale, duke shkatërruar ndotje të ekosistemeve tokësore dhe ujore. Mbetjet e ngurta të ndërtimeve vlerësohen ndotje kritike, duke krijuar vatra informale depozitimesh që kërkojnë investime të mëdha për heqjen dhe transportimin e tyre.
- Përdorimi dhe mostrajtimi i materialeve si kanaçe alumini, ambalazhe plastike, qelq, hekur, vajra lubrifikantë, pjesë elektronike, mungesa e landfillleve, etj.
- Shkarkimet e pa trajtuara kanë sjellë edhe rritjen e shkallës së eutrofikimit të ujërave. Tashmë, ndotjet e përqëndruara të ujërave të zeza janë faktor kërcënues dhe problem mjedisor shumë i mprehtë. Shkaku kryesor i eutrofikimit (kryesisht në liqene dhe laguna), ndotjes së ujërave mbetet derdhja e ujërave të zeza të patrajtuara dhe mungesa e ndërtimit të impianteve të përpunimit.
- Lëndët ndotëse janë faktorë me ndikim të madh në cilësinë e jetës biologjike dhe shëndetit të njeriut. Ndotjet më të mëdha vijnë dhe nga minierat, guroret, mbetjet urbane e rurale, pesticidet dhe përdorimi i plehrave nga bujqësia, nga derdhja e mbeturinave të peshkimit pas përpunimit, nga derdhjet e hidrokarbureve apo dhe shkarkimet e anijeve.
- Menaxhimi joefektiv i aktiviteteve rekreative, mosmenaxhimi i vizitorëve dhe i mbeturinave të ngurta që ata prodhojnë. Turizmi i paorganizuar, zhvillimi i veprimtarive të mëdha sportive, argëtuese, çlodhëse, garat motorike të rrellit, etj.
- Zhvillimi i aktiviteteve të paligjshme kanë cënuar shumë territore e lloje të marra në mbrojtje nga legjislacioni kombëtar dhe konventat. Praktikrat e gabuara në mjaft raste kanë sjellë pasoja shpesh të pakthyeshme, pasi zinxhiri i jetës biologjike është i lidhur me sigurimin e cilësisë së jetës biologjike të ekosistemeve.
- Mos respektimi si dhe sa duhet i ligjit dhe problemet e pronësisë dhe të kthimit e kompesimit të pronave.



- Ndryshimet klimatike, rreziqet natyrore, ortekët, përmytjet, rrëshitjet, tërmetet, janë faktor kërcënues në nivel global, por dhe në nivel lokal për larminë biologjike. Në këtë kontekst, organet qendrore dhe vendore luajnë rol shumë të rëndësishëm në parandalimin e kërcënimeve që vijnë nga ndryshimet klimatike, të cilat ende nuk kanë vëmendjen e duhur për t'iu paraprirë.



### 3. PËRGJITHËSIME MBI KOMUNIKIMIN DHE ADVOKIMIN

Marrëdhëniet me publikun janë përpjekje të planifikuara për të vendosur, ruajtur mirëkuptimin dhe vullnetin e mirë midis institucionit dhe publikut. Marrëdhëniet me publikun përfshin në vetvete një gamë të gjerë rolesh dhe funksionesh, gjithashtu, e ndihmon publikun në rritjen e besueshmërisë dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre.

Publiku përfshihet më shumë në këtë proces, kur çështja lidhet direkt me ta. Njëherazi, pjesëmarrja e qytetarëve ndodh kur të gjithë pjesëmarrësit bashkëpunojnë për të realizuar ndryshimet. Drejtimet e pjesëmarrjes së publikut në qeverisje janë:

- i) *Pjesëmarrja pasive*, që kufizohet në informimin e thjeshtë të komunitetit;
- ii) *Pjesëmarrja aktive*, që nënkupton përfshirjen e tyre në vendimmarrje dhe në procesin e zbatimit.

Komuniteti duhet të jetë i përfshirë sa më gjerë në procesin qeverisës. Pjesëmarrja publike rrit transparencën në procesin e vendimmarrjes. Edhe individët duhet të përfshihen në procesin e vendimmarrjes, kontributi i tyre mund të ndihmojë në gjetjen e zgjidhjeve të volitshme të problemeve.

Aftësitë e nevojshme për mobilizimin e komunitetit nuk janë veçanërisht të vështira për t'u përvetësuar. Meqenëse grupi i shënjestruar është komuniteti shumica e aftësive që nevojiten bazohen në aftësitë komunikuese.

Përfaqësuesit e organizatës së RrMN dhe të tjerë të shoqërisë civile duhet të mësojnë të bëhen folës të mirë në publik; udhëheqës të efektshëm dhe të kenë veti të mira të lehtësimit të diskutimeve.

Aftësia për të marrë informacione, vendime nga një grup, çka kërkon kuptim të mirë të synimeve/objektivave dhe vetë besim e qetësi në marrëdhëniet me njerëzit, është shumë e rëndësishme. Po ashtu, vetitë personale si ndershmëria, entuziazmi, mirësia, durimi dhe motivimi janë tipare të domosdoshme.

ORrMN dhe OJF-të më të vogla dhe/ose me bazë komunitare e kanë më të vështirë të përçojnë mesazhet e tyre, të bashkërendimit të veprimtarive me OJF të tjera, të konsultimeve dhe advokim-lobimit me politikë bërësit nëpërmjet shtypit të shkruar dhe atij elektronik. Kur prezantohet një mesazh, rëndësi ka që të jetë mjaft i qartë, të bazohet në një strategji që përcaktohet nga audienca që synon të arrijë, mënyrën më efektive për t'a bërë të kapshëm dhe interesant edhe për komunitetin.



Disa nga aftësitë e nevojshme për përcjellje të informacionit është edhe advokim-lobimi, që nënkupton ushtrimin e presionit për miratimin dhe promovimin e politikave.

### **3.1. KUSH DUHET TË MARRË PJESË?**

Individët dhe grupet që janë të përfshirë në proces ose që influencojnë në procesin e vendimmarrjes. Këta janë persona apo grupe interesi të cilët kanë vëmendje e kujdes të veçantë për politikën e zhvillimit dhe që duan të shprehin opinionin e tyre. Çdo qytetar duhet të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal.

Pjesëmarrja është një marrëdhënie e dyanshme, gjatë së cilës qytetarët marrin pjesë aktive në formulimin, hartimin dhe zbatimin e politikave apo dhe të rasteve që nuk janë në përputhje me interes, kur ka pasoja të rënda për jetesën e tyre dhe të përdorimit jo të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Të tilla veprimtari mund të përfshijnë propozime specifike apo alternativa të zgjidhjes nga vetë qytetarët, apo ORrMN që bashkëpunojnë ngushtë me organe shtetërore a pushtetin vendor. Metoda të tjera janë edhe referendumi, pjesëmarrja në komitete vendimmarrëse, panele qytetarësh, etj.

### **3.2. KUR DUHET TË PËRFSHIHET PJESËMARRJA PUBLIKE?**

Informimi është një marrëdhënie e një anshme në të cilën u shpërndahen informacione qytetarëve, si për shëmbull, për të bërë të njohur një politikë të re apo ndryshime në procedurat ekzistuese, për të vënë në duke dhe ndikuar në programet jo mire përgatitura dhe që çenojnë rëndë burimet natyrore, duke bërë njoftime në media, shpërndarë broshura, etj.

Pjesëmarrja aktive nënkupton një veprim individual ose në grup, me qëllim të identifikimit dhe adresimit të çështjeve me vëmendje publike. Pjesëmarrja është proces ku qytetarët organizohen vetë për qëllimet e tyre në nivelin praktik si dhe punojnë bashkërisht, qoftë në rrafshin individual ose përmes ORrMN-ve dhe OJF-ve partnere, për të ndikuar në proceset vendimmarrëse.

Në shumicën e rasteve qytetarët vetë organizohen si rrjedhojë e dukurive të ndryshme shoqërore, siç është ndotja e mjedisit, shkatërrim të pronave publike a dëmtimi i natyrës, ose reagimet e ndryshme përmes tribunave, të cilët në shumicën e rasteve organizohen me mbështetje të ORrMN-ve.

Pjesëmarrja në procese vendimmarrëse do të thotë mundësi për qytetarët, për ORrMN-të dhe palët tjera të interesuara që të ndikojnë në zhvillimin e politikave, ligjeve, zhvillimeve social-ekonomike etj, të cilat i prekin ata.

Pjesëmarrja e qytetarëve nuk duhet kërkuar në situata të veçanta, por duhet të jetë pjesë e jetës së përditëshme të tyre. Është e drejta dhe detyra e çdo kujt të



marrë pjesë në proceset e informimit, komunikimit, adresimit dhe të vendimmarrjes.

Ende shikohen vështirësi të mëdha për sigurimin e pjesëmarrjes dhe të jolehtësive në komunikim, kjo edhe për arsye të mos kuptimit të komunikimit, nevojës për informim dhe pjesëmarrjeje në vendimmarrje.

### 3.3. ÇFARË ËSHTË KOMUNIKIMI?

Fjala “komunikim” vjen nga latinishtja CUMUNIRE (CUM=me dhe MUNIRE=lidh, ndërtoj). Komunikim do të thotë hyj në lidhje me tjetrin, shkëmbim i dyanshëm i mendimeve dhe i informacionit midis dy ose më shumë individëve apo/dhe subjekteve, për të gjetur një gjuhë/marrëdhënie të përbashkët.

Komunikim është procesi i përcjelljes të mesazheve, të të kuptuarit dhe i ndarjes së mendimeve, për të ndikuar qëndrimet dhe sjelljet në një publik të gjërë. Pra, me komunikim duhet të kuptojmë tërësinë e informacionit, mesazheve, sinjaleve të çdo natyre që përcjell një individë, subjekt, grup interesi, shoqëria civile, politikanët etj., dhe të vesh në dispozicion të të tjerëve një informacion, një ide ose marrëdhënie njerëzore, ku të gjithë palët duhet të gejnë një gjuhë të përbashkët. Por duhet të kuptojmë se komunikimi është i shumëllojshëm, ka gjuhë të ndryshme dhe shpeshherë mund të bëhet objekt edhe i keqkuptimeve mes njerëzve.

#### 3.3.1 Qëllimet e komunikimit

Komunikimi është procesi i gjenerimit, transmetimit apo i dërgimit dhe marrjes së mesazheve dhe zhvillohet të paktën midis dy subjekteve, kur të paktën njëri prej tyre dëshiron të komunikojë.

Qëllimi konsiston:

...Për të dhënë dhe për të marrë një informacion;...Për të bërë bashkëbisedim;...Për të caktuar se kush dhe përse ka gabuar;...Për të zgjidhur një problem;...Për shkëmbim të përvojave dhe praktikave më të mira.

#### 3.3.2 Llojet e komunikimit

*Komunikim verbal*, ku përcjellja e mesazheve bëhet me fjalë në formë gojore dhe me shkrim. Komunikimi gojor realizohet nëpërmjet të folurit dhe të dëgjuarit, përfaqeson formën më të rëndësishme, pasi kushdo bën prezantimin dhe vlerësimin e punës, etj.

*Komunikimi jo verbal*, edhe ky realizohet nëpërmjet të folurit dhe të shkruarit, por shpesh është i formës spontane. E veçanta e këtij komunikimi është se nëpërmjet tij përcillen mesazhe që nuk mund të dërgohen nëpërmjet komunikimit verbal.



*Konsultimi* është një marrëdhënie e dyanshme që përfshin shkëmbimin e opinioneve dhe reagimeve mes qeverisë dhe qytetarëve, ORrMN-ve e OJF-ve partnere për politika publike të propozuara. Gjatë konsultimeve qëndrimi dhe pikëpamjet e qytetarëve kërkohen dhe merren në konsideratë seriozisht gjatë hartimit të programeve apo politikave publike; për shëmbull me anë të takimeve publike, botimit të kërkesave për konsultim, etj.

### 3.3.3 Format dhe elementët e një komunikimi efektiv

Aftësia për të shprehur një qëndrim, mendim, të jepni ose të merrni një porosi të gjitha këto arrihen përmes komunikimit efektiv.

Komunikimi efektiv është element i rëndësishëm i kulturës së komunikimit mes OMSHC-ve dhe individëve apo dhe grupeve të interesit, duke përfshirë tri elemente kryesore:

- Kanale, mjete, metoda dhe stile efektive.
- Gatishmëria për të dëgjuar, pyetur, provuar dhe për të arritur tek të kuptuarit e një situatë.
- Dëgjimi aktiv i komunikuesit, në këtë rast dëgjimi aktiv nga prezantuesi i ORrMN tek pjesëmarrësit, e po ashtu edhe dëgjimi aktiv nga pjesëmarrësit tek prezantuesi apo/dhe stafi i ORrMN-s.

Një komunikim efektiv duhet të jetë:

- Transparent dhe në kohë (sapo merret një vendim apo mësohen fakte të reja, mesazhet duhen komunikuar tek punonjësit para publikut të jashtëm);
- i qartë;
- i saktë;
- informues;
- i pavarur.

### 3.3.4 Cilët janë mjetet për informim dhe komunikim?

Fazat e komunikimit dhe zgjedhja e mjeteve të duhura duhet të bëhet rast pas rasti me grupet e interesit, duke përdorur kanalet si më poshtë:

- Mjetet elektronike dhe rrjetet sociale (faqja e internetit, facebook, portale, YouTube, email, adresat zyrtare, etj.).
- Mediat lokale dhe kombëtare.
- Emisione në radio dhe televizive.
- Konferenca dhe videokonferenca.
- Gazeta/njoftime për shtyp.
- Materiale të ndryshme të shtypura, raporte, materialet dhe aktivitete të ndryshme promovuese.
- Broshurat, doracakët.





- Komunikime personale, takime informuese, mbledhje të hapura, takime të organizuara të drejtpërdrejta, debatet publike.
- Qendër informimi, kënde njoftimesh/kioska apo linjë telefonik falas.
- Edukimi civil, trajnimet dhe seminare.
- Ngjarjet publike, ditët mjedisore, panaire, etj.

### 3.3.5 Karakteristikat e rëndësishme të komunikimit efektiv

Komunikimi efektiv nuk është vetëm mundësi, por nevojë e mirëfilltë për krijimin dhe zhvillimin e grupeve të interesit, të organizatave të RrMN dhe të OJF-ve me bazë komunitare.

Me anë të komunikimit arrihet të shprehet: **vetë dija, dëshira, nevoja, interesat**, përcjellja e mesazheve, etj. Por duhet bërë kujdes që një komunikimi jo efektiv mund të krijojë: **konflikte, mosmarrëveshje, debate të panevojshme, thashetheme, lëndime, etj.**

Të komunikosh në mënyrë efektive është një nga problemet më të vështira, me të cilin një individ apo grup interesi përballet gjatë jetës së tij. Komunikimi kërkon që të kuptojmë njëri-tjetrin dhe nuk ka të bëjë me atë se kush ka të drejtë apo kush e ka gabim. Komunikimi nuk është një garë se kush po flet më shumë dhe i pari.

Komunikimi konsiderohet si aktivitet i advokacisë nëse grupet e synuara e përdorin për të ushtruar presion gjatë procesit të politikëbërjes. Nëse shihet nga një këndvështrim i caktuar mund të konsiderohet një strategji specifike e advokacisë.

Në komunikim herë pas here përmendet bisedimi me njëri-tjetrin apo me grupet e interesit, me të cilin bashkëpunon, ke nevojë për marrje dhe zgjidhje të problemeve, pra duhet të krijojmë marrëdhënie bashkëveprimi, që do të thotë marr dhe jap, është një dialog. Pra, të hysh në marrëdhënie bashkëpunimi do të thotë: **të dish t'a pranosh, të dish t'a dëgjosh, të dish t'a shikosh, të dish t'i kushtosh kohë tjetrit apo grupit.**

Gjatë procesit të konsultim/dëgjimit është i rëndësishëm të dëgjosh se çfarë thotë për situatat e ndryshme apo problemin që e shqetëson, duke e marrë gjithë informacion e duhur. Komunikimi kërkonë të kuptojmë njëri-tjetrin, sepse:

- Jep informacion praktikë;
- krijon përshtypje specifike të qartë, bindës dhe të saktë;
- qartëson dhe përqëndron informacionin, duke theksuar atë më të rëndësishmin;
- identifikon qartë përgjegjësitë nëpërmjet mesazheve drejtuar audiencës;
- bind të tjerët dhe jep rekomandime, duke iu shpejguar dëgjuesve sëçfarë përfitimesh do të kenë;



- zgjidh problemet, ku secilit grup interesi kërkohet që ti adresojë.

### 3.3.6 Hapat e komunikimit të efektshëm/dobishëm

#### ➤ **Qartësia**

*Jini të qartë me mesazhin tuaj, mbajeni të thjeshtë.*

#### ➤ **Konciz**

*Më pak fjalë të mundshme, kursen kohë për marrësit dhe pjesëmarrësit.*

#### ➤ **Korrekt**

*Fakte dhe shifra të sakta, përdorimin e gramatikës dhe drejtshkrimin e gjuhës.*

#### ➤ **Komplet**

*Duhet të përcjellësh të gjitha faktet e kërkuara nga pjesëmarrësit.*

#### ➤ **Shqyrtimi/Vëmendje**

*Konsideroni auditorin dhe kërkesat e tyre.*

#### ➤ **Konkret**

*Jini të përcaktuar dhe specifike, jo i paqartë.*

#### ➤ **Mirësjellje**

*Mendoni për pjesëmarrësit, pikëpamjet e tyre dhe jini të respektueshëm.*

### 3.3.7 Mënyra e shkëmbimit të informacionit

Shkëmbimi i informacionit me individët Brenda organizatave të RrMN, me organizatat dhe të ideve me të tjerët përkufizohet si komunikim i jashtëm.

Format kryesore të komunikimit të organizatave të RrMN janë: Brenda vetes së secilës organizatë të Rrjetit; Midis organizatave të Rrjetit dhe me Organizatatat e tjera partnere; Me palët e interesuara dhe organeve shtetërore në nivel qendror dhe lokal.

Komunikimi është procesi që lejon të shkëmbejmë informacione nëpërmjet disa mënyrave dhe niveleve. Komunikimi kërkon që individët apo të gjitha palët të kuptojnë një gjuhë të përbashkët që mund të shkëmbehet. Komunikimi paraqet procesin e kalimit të informatave nga burimi përmes rrugëve të mesme deri te pranuesi, si dhe kalimin e reagimit të pranuesit përmes rrugëve të mesme deri te burimi. Pra komunikimi në procesin e vet përfshin dy ose më shumë persona.

Me komunikim nënkuptohet çdo shkëmbim ose bartje informacioni ndërmjet numrave të caktuar të palëve me anë të mjeteve të shërbimeve publike elektronike në dispozicion. Kjo nuk përfshin ndonjë informatë të mbartur si pjesë e një shërbimi transmetues për publikun, nëpërmjet rrjetit të komunikimit elektronik, përveç nëse informacioni ka të bëjë me palën, si klient, abonent, regjistruar të identifikueshëm ose përdoruesin që merr informacionin. Në ditët e sotme fjala “komunikim” shpesh përdoret edhe si sinonin i termit “lajmërim”.



### 3.3.8 Organizimi i takimeve dhe roli i ORrMN-ve

Takimet janë pjesë e jetës së përditshme, pjesë e procesit të komunikimeve ku nivelet e ndryshme të OJF-ve diskutojnë llojet e veçanta të situatave dhe komunikojnë me njëri-tjetrin. Takimet përdoren për të angazhuar pjesëmarrësit, për të mbledhur dhe shpërndarë informatat, mendimet dhe për të kontribuar në procesin adresimit, lobimit dhe të vendimmarrjes.

Takimet janë komponent i rëndësishëm në funksionimin efektiv të OJF-ve për problemet që i shqetësojnë dhe që kërkojnë t'i adresojnë. Të gjitha takimet organizohen me qëllim të shqyrtimit të asaj që duhet të arrihet, të tërhiqet vëmendja e opinionit publik, medias, politikavëve dhe qeveritarëve.

Të tilla takime janë organizuar nga INCA në kuadër të projekteve, por edhe nga ORrMN në nivel lokal me OJF-t partnere me grupet e interesit, administratat e ZMM dhe median. Bazuar në përvojën tonë duhet të bëni kujdes që takimet duhet të jenë të kufizuara në kohë, që pjesëmarrësit të jenë të angazhuar, të mos u krijojmë shqetësime dhe mërzitje, të jetë takim interaktive dhe jo njeri fletë dhe tjetëri dëgjon.

### 3.3.9 Çfarë duhet të merret parasysh kur planifikonin një takim?

- Pse është i nevojshëm takimi?
- Çfarë shpresojmë të arrijmë?
- Cilat janë qëllimet e takimit?
- Çfarë përgatitje duhet të bëhen për takimin dhe si duhet të bëhet?
- Kush duhet të ftohet në takim dhe si duhet të njoftohen?
- Sa kohë më parë duhet të njoftohet takimi?
- Kush duhet t'a kryesojë takimi dhe si?
- Sa kohë planifikohet për diskutim dhe shkëmbim të mendimeve?
- Çfarë duhet të ndodhë pas takimit?

### 3.3.10 Disa rregulla për një komunikim më efektiv

Për një komunikim sa më të efektiv, kërkohet jo vetëm të dihen disa rregulla në komunikim, por gjithashtu të praktikohen ato vazhdimisht qoftë me individë apo dhe me grupe interesi, si më poshtë:

- Të respektohet folësi.
- Të mbahet radha në komunikim.
- Të mos ndërpritet tjetri derisa flet.
- Të flitet për veten në vetën e parë.
- Të mos fyhet, lëndohet apo provokohet tjetri.
- Të dëgjohet tjetri dhe të lejohet të përfundojë mendimin.
- Të flitet ngadalë.
- Të dimë të dëgjojmë dhe të kuptojmë tjetrin.



- Të eliminojmë agresivitetin dhe inatin.
- Të jemi të qartë me vetveten.
- Të mësojmë të themi jo (dhe të na thonë jo).
- Kur komunikojmë kërkohet të jemi vetvetja, të zgjedhim fjalët apo shprehjet, të tregohemi të matur, sepse nga mënyra se si komunikojmë paraqet personalitetin tonë.

Ndërkohë gjatë bashkëbisedimeve drejtuesit apo institucioni duhet të bëjë kujdes dhe të ketë parasysh që:

- A jam në gjendje t'a dëgjoj tjetrin derisa flet? Nëse po, si e arrij këtë, nëse jo, çfarë më pengon?
- Çfarë më duhet të ndryshoj në komunikim me të tjerët?
- A ndryshon diçka brenda meje derisa unë flas me të tjerët?
- Po të mos ishin këta, çfarë njohjeje dhe zgjidhje do të kisha për problemet që diskutohen?

### 3.3.11 Këshilla për vendimmarrjen nga ORrMN

1. Mos merrni vendime që nuk u takojnë juve t'i merrni.
2. Analizoni nëse vendimi që duhet të merret duhet vetëm nga ju si ORrMN pas një konsultimi me një grup të kolegëve apo i palëve të interesit apo të delegohet tek të tjerë.
3. Kur e merrni një vendim, ju thjeshtë zgjidhni njërin nga alternativat e mundshme. Ju nuk duhet të zgjidhni mes asaj që është e drejtë apo gabim.
4. Shmangni vendimet e shpejta. Lëvizni shpejt kur është fjala për vendime që mund të kthehen dhe lëvizni ngadalë kur është fjala për ato që s'mund të kthehen.
5. Merrni vendimet në letër. Mbani shënime dhe idetë tuaja kur duhen që të shqyrtoni të gjitha informatat që dispononi në marrjen e vendimit.
6. Sigurohuni të zgjidhni, duke u bazuar në atë se çka është e drejtë, e jo kush ka të drejtë.
7. Shkruani aspektet për dhe kundër, sa i përket një linje të veprimit. E qartësoni mendimin tuaj dhe mundësoni vendim më të mirë.
8. Merrni parasysh ata që ndikohen nga vendimi. Kudo që është i mundshme, duke përfirë edhe ata, për të rritur përkushtimin e tyre.
9. Pranoni se nuk mund t'a dini me 100% siguri se vendimi juaj është i saktë, pasi veprimet për t'a zbatuar atë do të ndodhin në të ardhmen. Kështu që merreni vendimin dhe mos u brengosni për të.
10. Keni besim tek vetjapër të marr vendimin dhe që pastaj të jeni në gjendje të adresoni pasojat në mënyrë të duhur.
11. Mos e humbni kohën tuaj duke marrë vendime që nuk duhet të merren.



12. Pasi t'a merrni një vendim, mos shikoni prapa. Jeni të vetëdijshëm se si është duke ndikuar aktualisht dhe përqendrohuni në vendimin e ardhshëm.
13. Kurrë mos u pendoni për një vendim, sepse ka qenë gjëja e duhur për t'a bërë në atë kohë. Tani fokusohuni në atë që është e duhur në këtë kohë.
14. Duke paraqitur ide për zgjidhje alternative me stafin tuaj apo të tjerët mund të fitoni ide të reja dhe përkushtim.
15. Ndërpreni mendimet e stërzgjatura lidhur me vendimin tuaj. Merreni vendimin dhe zbatojeni.
16. Pasi t'a keni marrë vendimin dhe të keni filluar të bëni atë që duhet t'a bëni, lëreni “**çfarë, nëse**” anash dhe bëjeni punën me përkushtim.
17. Duke u bazuar në atë që e dini tani, si do të ndryshoni praktikat tuaja të vendimmarrjes?

### 3.4. ÇFARË DUHET TË KUPTOHET ME ADVOKIM?

- *Advokimi*, është veprimi i cili ka si synim ndryshimin e politikave, qëndrimeve ose programeve të çdo lloj institucioni.
- *Advokimi*, është kërkesë për të mbrojtur dhe/ose për të rekomanduar një ide.
- *Advokimi*, është ngritje zëri, reagim, tërheqje e vëmendjes së komunitetit për një ose disa çështje të rëndësishme dhe drejtimi i vendimmarrësve drejt një zgjidhje.
- *Advocacy* (Advokim), është përpjekja për të ndikuar njerëzit, politikën, strukturën, dhe sistemet në mënyrë që të mundësohet ndryshimi për të tjetërsuar mënyrën se si krijohen, konsumohen dhe shpërndahen pushteti, burimet dhe idetë në mënyrë që njerëzit dhe organizatat e tyre të kenë mundësi më realiste për të kontrolluar zhvillimin e tyre.

#### 3.4.1 Përkufizime të tjera

- *Advokimi*, është përpjekja e një grupi qytetarësh apo organizatash të shoqërisë civile me synim ndryshimin e një politike.
- *Advokimi*, është vendosja e një problemi në rendin e ditës, duke siguruar një zgjidhje për atë problem dhe mbështetje për ndërmarrjen e veprimit në të dy aspektet: si ndaj problemit ashtu dhe ndaj zgjidhjes. Advokimi mund të ketë si qëllim ndryshimin e një organizate në brendësi ose ndryshimin e një sisteminë tërësi.
- *Advokimi*, mund të përfshijë shumë veprimtarispecifike afatshkurtra për të arritur një vizion afatgjatë të ndryshimit.
- *Advokimi*, përbëhet nga strategji të ndryshme që kanë për qëllim për të ndikuar te politikëbërësit, të ndikojnë në vendimmarrjen në nivel organizativ, vendor, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar; për të bërë një



ndryshim publik, hartuar e miratuar ligje, strategji, programe apo plane veprimi; shpërndarje burimesh, apo ndryshime institucionale, etj. Pra advokacia është një strategji për të ndikuar në ndryshimin e politikave dhe veprimeve, i drejtohet një audience parësore vendimmarrësish, kërkon një proces komunikimi bindës, i cili mundëson krijimin e mbështetjes për politikatat e propozuara, dhe realizohet nga grupe të organizuara qytetarësh.

- Në strategjitë për advokim mund të përfshihen lobimi, informimi, edukimi dhe komunikimi, organizimi i komunitetit, apo taktika të tjera. Advokimi është procesi në të cilin njerëzit marrin pjesë në vendimmarrje në mënyrë që të përmirësojnë jetën e tyre.

### **3.5 FAKTORËT PËR ADVOKIM-LOBIM-REAGIM TË SUKSESSHËM**

Advokimi dhe lobimi ato janë dy koncepte të ngjashme, por instrumente të ndryshme. Advokimi është një instrument ndryshimi dhe ndikimi në qëndrime dhe mentalitete, përveç se në programe dhe politika, audienca e së cilës është publiku ose segmente të veçantë të tij. Ndërsa audienca e aktiviteteve lobuese janë politikanët dhe administratorët publike. Kështu, advokimi dhe lobimi janë dy aktivitete që mund të kombinohen dhe organizohen në vazhdim të njëra-tjetrës.

Advokimi shpesh dhe ngatërrohet, si psh. fushatat për informacion, edukim dhe komunikim; lobimi, marrëdhëniet publike, mobilizimi i komunitetit dhe të tjera. Është e rëndësishme për t'u theksuar se asnjë nga këto qasje nuk mund të thuhet se është më shumë apo më pak e vlefshme apo e mirë.

Njëherazi, e rëndësishme është edhe se cila do të arrijë më mirë ndryshimin e pritur. Vetëm me anë të advokimit mund të arrihen ndryshimet e politikave, programeve dhe/ose rishpërndarja e burimeve për përmirësimin e jetës së komunitetit.

#### **3.5.1 Cilat janë llojet e advokacisë?**

Është mirë që organizatat e RrMN dhe OJF-t lokale partnere të njohin llojet e ndryshme të advokacisë, në mënyrë që të jenë në gjendje për t'u përqendruar në drejtimin e duhur.

#### **Advokacia direkte dhe indirekte.**

Dallimi midis advokacisë direkte dhe indirekte bazohet në synimin e përpjekjes për advokaci. Advokaci direkte do të thotë që individët ose/dhe organizatat përpiqen të ndikojnë te vendimmarrësit, politikë bërësit e politikanët për të ndryshuar politikatat publike. Ndërkohë që nga ana tjetër, advokaci indirekte dotë thotë që individët ose organizatat përpiqen të ndikojnë edhe mendimin e publikut të gjerë, të gazetarëve dhe medias, të cilët do të ndikojnë te vendimmarrësit.



### Advokacia qytetare dhe individuale.

Dallimi kryesor është agjenti i përpjekjes për advokaci. Në rastin e advokacisë qytetare, mbrohet një çështje në emër të një grupi njerëzish. Në rastin e advokacisë individuale, një individ e mbron vetë kauzën e tij.

### Advokacia e bazuar tek të drejtat dhe evidencat.

Në rastin e advokacisë së bazuar tek të drejtat, qëllimi është që politikë bërësit të ndikohen nëpërmjet arsytimit, duke marrë parasysh të drejtat e njeriut, të cilat janë pasqyruar në deklarata dhe forma të ndryshme të legjislacionit.

Advokacia e bazuar tek evidencat sjell argumentin, duke marrë parasysh prova dhe të dhëna kërkimesh. Nëse situata lejon përdorimin e argumentave mbështetës dhe nëse kemi të dhëna të sakta, mund t'i paraqesim dhe t'i interpretojmë, për të mbështetur rastin e RrMN për listën e impakteteve negative në ZMM, atëherë është e drejtë të përdoret advokacia e bazuar te evidencat dhe në hartëzimin e këtyre impakteve.

### 3.5.2 Cilat mund të jenë përfitimet e procesit të advokimit?

**Objektivat e avokim-lobim-reagimit**, duhet të jenë realistë, të arritshëm dhe të matshëm. Ky është një nga faktorët e parë që duhet të kenë parasysh drejtuesit dhe stafi i ORrMN, OJF-t dhe palët e interesuara. Nuk është realiste të përpiqemi të zgjidhim një problem të madh, kur kemi në dispozicion shumë pak kohë dhe/apo burime. Ndaj objektivi i çdo fushate **avokim-lobim-reagim** duhet të jetë i përshtatur me kuadrin kohor të planifikuar dhe mjetet e burimet që janë në dispozicion.

**Informacioni i saktë**, është një tjetër faktor rëndësishëm. ORrMN-t dhe OJF-t partnere duhet të kenë informacion të përshtatshëm dhe të dhëna të plota mbi çfarë është bërë, çfarë mbetet për t'u bërë, çfarë kanë ndërmend të bëjnë të tjerët, sa problematike shfaqet gjendja, si edhe prova dhe fakte që vërtetojnë këto probleme. Këto të dhëna dhe informacione kanë rëndësi për të bërë për vete dhe për të bindur aktorët e interesit.

**Veprimtaria e advokim-lobim-reagimit** duhet t'i drejtohet një tërësie dëgjuesësh/pranishëm specifike. Në rast se qëllimi është të ndikohet në sjellje, veprimet duhet t'i drejtohen pikërisht grupit që duhet të ndryshojë. Në rast se drejtohet për ndryshim politikash, duhet t'i drejtohet politikë bërësve si dhe të gjithë atyre njerëzve apo grupeve që mund të kenë ndikim mbi këto politika. Në rast se qëllimi synon ndryshime ligjore, ai duhet t'iu drejtohet njerëzve që janë pjesë të procesit ligjvënës. Adresimi i një tërësie dëgjues është pa përshtatshme sigurisht që nuk mund të sjellë rezultatet e dëshiruara.



**Mesazhi**, duhet të jetë i qartë për audiencën. Tërësia e dëgjuesëve duhet të kuptojnë mesazhin në mënyrë që të veprojnë. Mesazhi duhet të jetë i qartë, i saktë, informues dhe korrekt. Po ashtu, ai duhet të hartohet me një gjuhë interesante, bindëse dhe të përshtatur pikërisht për atë grup të cilit i drejtohet.

### 3.5.2. Ç'farë sjellin ORrMN nga përdorimi i advokacisë?

- Ndryshime në fusha të ndryshme (të drejtat e njeriut, të drejtat civile, barazia gjinore, arsimi, mbrojtja e mjedisit, të biodiversitetit, peizazhit dhe burimeve natyrore, zhvillimin e territorit dhe shumë të tjera);
- i bazojnë përpjekjet e tyre te vlerat demokratike dhe mobilizimin qytetar, në organizata të tjera ose tek publiku;
- punojnë në mënyrë aktive për të arritur ndryshimin e ligjeve dhe rregulloreve, politikave publike, vendimmarrjen dhe rishpërndarjen e burimeve;
- nxisin pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe fuqizimin e komuniteteve;
- bëjnë fushata, negociojnë, llobojnë, ndërgjegjësojnë.

### 3.5.3 Cikli i advokim-lobimit

#### Identifikimi i problemit

Për ata që merren me advokim-lobim, me mbrojtjen e çështjeve apo interesave të caktuara, problemi ka të bëjë me një situatë të caktuar negative, e cila ndikon për keq tek një grup njerëzish. Problemet që vijnë si rezultat i politikave qeveritare apo i praktikave sociale zakonisht kanë rrënjë të thella dhe nuk mund të zgjidhen nga një njeri i vetëm. Komunitetet apo grupet e prekura zakonisht kanë nevojë për organizatat që të advokojnë në emër të tyre dhe të kërkojnë zgjidhje.

Kur flasim për advokaci, pyetja më e shpeshtë nga OJF-të është përgatitja dhe zbatimi i suksesshëm i procesit apo planit të veprimeve të advokacisë. Është gjë e mirë të dimë se cilat hapa do ndërmerren dhe çfarë duhet bërë për të arritur një ndryshim.

Hapi i parë në përgatitjen e një fushate advokim-lobimi është identifikimi i këtyre problemeve, shkaqeve dhe pasojave të tyre. Çdo problem mbart në vetvete një sërë çështjesh e qëndrimesh. Një metodë është të analizohen shkaqet, pasojat dhe zgjidhjet e mundshme. Analizimi i pasojave mundëson të evidentohet se si ndikon problemi në jetën e njerëzve. Kjo të çon edhe në identifikimin e grupeve të prekura dhe palëve të tjera të interesuara, të cilave do të duhet t'u drejtohem për mbështetje dhe/ose për veprime të përbashkëta.

Duhet kuptuar që advokacia zakonisht është një proces afatgjatë që ka logjikën e vet, përbëhet nga elemente kyçe dhe ndjek disa hapa, që ndryshojnë në





varësi të kohës dhe fushës së veprimit, por duhen patur parasysh se me cilët elementet duhet punuar, kur doni të bëni një ndryshim.

Në kuadër të funksionimit dhe të synimeve që ka RrMN, fushata e advokim-lobimit ka bazë të shëndosh për tu mbështetur tek puna dhe arritjet në zbatim të projektit, të vlerësimit dhe analizës së kryer për impaktet negative në ZMM si dhe tek analiza e grupeve pjesëmarrëse të interesit, të cilët preken dhe që kërkojnë ndryshime për mënjanimin e këtyre impakteve.

Pra, në këtë kontekst stafi i ORrMN duhet të përcaktojë synimet e tij në lidhje me:

- Cila është çështja të cilën doni të ndryshoni? Ndryshim është afatgjatë apo afat shkurtër?
  - Ku kërkohet ndryshimi në:
    - ✓ Legjislacion
    - ✓ Politika
    - ✓ Strategji
    - ✓ Rregullore
    - ✓ Programe
    - ✓ Menaxhim
    - ✓ Përdorim të qëndrueshëm
    - ✓ Edukim, ndërgjegjësim
    - ✓ Financim
- Çfarë doni të arrini? Cili është qëllimi dhe objektivat tuaja të advokacisë të cilat do të kontribuojnë në arritjen e qëllimit kryesor?
- Cilët janë personat e synuar (politikë bërësit, vendimmarrësit, etj.) të cilëve duhet t'iu drejtoheni për ta arritur qëllimin?
- Cila është qasja që keni zgjedhur (p.sh. direkte ose indirekte)?
- Cilat janë aktivitetet specifike që do të kryeni? Si do të organizohet koha dhe cila do të jetë fusha e veprimit?
- Cili është mesazhi që doni të përcillni te grupi i synuar?

Gjithashtu e rëndësishme është që Ju të njihni edhe shtresat e audiences së cilës u drejtoheni. Grupet e interesit janë persona të cilët ndikojnë te problemi dhe zgjidhja ose janë të ndikuar nga problemi. Pra, janë personat që preken nga problemi.

Në fillim të punës suaj është e rëndësishme të hartëzoni dhe analizoni grupet e interesit dhe të vëreni se çfarë iu intereson njerëzve dhe sa kundërshtarë apo mbështetës keni. Analizimi i grupeve të interesit, interesave të tyre, dhe njohja e mënyrave për t'i nxitur, ju jep mundësinë për të përgatitur hapat specifike veprimeve. Nëse nuk i identifikoni grupet e interesit me kujdes, ju nuk do të arrini të përfitoni nga i gjithë potenciali njerëzor që keni në dispozicion.



Këto analiza janë bërë të plota dhe tashmë ORrMN e kanë të qartë dhe të listuar se cilët janë aktorët apo grupet kryesore të interesit (pro dhe kundër) në lidhje me promovimin, reagimin dhe adresimin e një menaxhimi të qëndrueshëm të ZMM dhe të burimeve e peizazhit natyror. Për rrjedhojë, mbështetur në procesin e identifikimit dhe analizimit të këtyre grupimeve, u krijuan edhe FoLM, në të gjitha ZMM e marra në studim.

**Lobimi**, është një strategji specifike e advokacisë për mbrojtjen e interesit publik apo privat, nëpërmjet ndryshimeve në legjislacion apo në fusha të tjera. Përvoja e ORrMN ka qënë e përshtatshme, pasi jemi në gjendje dhe kemi krijuar marrëdhënie të qëndrueshme midis organizatave të RrMN, duke ndikuar në njohjen dhe zbatimin e standarteve dhe të legjislacionit për ruajtjen e natyrës dhe të përdorimit të baraz peshuar të burimeve dhe vlerave natyrore.

**Negociatat dhe dialogu**, është konsideruar i nevojshme, i rëndësishëm për zbatimin e strategjisë dhe realizimin e objektivave të caktuara për secilën ORrMN. Në këtë drejtim vazhdimisht janë organizuar takime të përbashkëta me strukturat shtetërore qendrore e lokale përgjegjëse për ruajtjen e natyrës, për mirë menaxhimin e ZMM dhe të burimeve natyrore, me komunitetin dhe palët e tjera të interesuara.

Rezultatet e dëshiruara varen nga mbështetja e qytetarëve dhe komunitete vetë shprehur nga numri i personave që kanë marrë pjesë në takime, negociata, dialog apo/dhe kanë firmosur, sipas rastit, peticione a kanë marrë pjesë në një reagim masiv (demonstratë) duke shprehur haptazi mendimin e tyre.

**Krijimi i rrjetit të bashkëpunimit**, është një strategji e përdorur nga INCA për të njohur njerëz të rinj, organizata ose ekspertë dhe për të krijuar marrëdhënie me ta, duke u bazuar në shkëmbimin e informacionit dhe interesat e përbashkëta, si në rastin e krijimit të RrMN. Veprimtaria e këtij rrjeti bashkëpunimi kavlera të përbashkëta, por edhe përfitime nga ky bashkëpunim.

**Krijimi i koalicioneve**, është procesi i vazhdueshëm i menaxhimit të marrëdhënieve me persona dhe organizata të ndryshme që kanë parime dhe vlera të përbashkëta. Koalicionet shpeshherë punojnë drejt një qëllimi të përbashkët ose kryerjes së një fushate të caktuar. Bashkëpunimi i bazuar te vlerat dhe qëllimet e përbashkëta është baza e një pune më efikase dhe më e qëndrueshme. Rezultate pozitive janë arritur në rastet e krijimit dhe funksionimit të koalicioneve si: “Të mbrojmë lumenjtë”, “Të mbrojmë Zemrën Blu të Evropës”, “Mos Ma PrekValbonën”, “Të shpëtojmë Arrinjtë Shqiptar”, “Stop Urbanizimit të PK “Divjakë-Karavasta”, etj.



Në rastin e organizatave të RrMN dhe të OJF-ve partnere ka disa praktika të mira në lidhje me promovimin dhe mirëqeverisjen e zonave të mbrojtura, biodiversitetin, peizazhin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

**E para**, krijimi i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës, i përbërë nga 8 organizata jo qeveritare. Rezultatet e këtij rrjeti janë të dukshme dhe të prekshme si gjatë zbatimit të programit SENiOR-A dhe SENiOR-II;

**E dyta**, lidhet me investigimin e zbatueshmërisë në praktikë të legjislacionit bazë të fushës së ruajtjes të natyrës, dhe

**E treta**, me identifikimin dhe ngritjen e një sistemi për adresimin e problematikave kryesore dhe të ndikimeve negative në zonat e mbrojtura mjedisore.

Strategjia dhe udhëzimet e hartuar nga INCA janë mbështetje e mirë për organizatat e RrMN, por edhe për OJF-t mjedisore lokale apo/dhe administratat përkatëse të ZMM dhe të stafit të bashkive, për të planifikuar, adresuar dhe reaguar ndaj këtyre dukurive të dëmshme dhe tjetërsuese për jetesën e komuniteteve.

#### Studimi

Studimi dhe kërkimi janë një hap i rëndësishëm që ndihmojnë për përgatitjen e fushatës së advokim-lobimit. Shpeshherë bëhet gabimi i nisjes së veprimtarive të advokim-lobimit pa u informuar mirë mbi problemin. Avokuesit duhet të jenë mirë informuar nëse presin që të bindin njerëz apo institucione që të ndryshojnë qëndrimet/politikat e tyre. Informacioni ka pushtet dhe mënyra e vetme për t'a marrë atë është nëpërmjet studimit.

Gjatë studimit të çështjes duhet përdorur një larmi burimesh për t'u njohur me qëndrime të ndryshme. Megjithatë, asnjëherë nuk duhet lënë mënjane biseda me përfaqësues të grupeve të prekura, nëpërmjet pyetësorëve, sondazheve apo fokus-grupeve. Madje edhe vrojtimi i grupeve të prekura dhe i jetës së tyre të përditshme ndihmon në thellimin e informacionit dhe në identifikimin e zgjidhjeve të ndryshme.

Informacioni që mblidhet gjatë studimit duhet të integrohet në veprimtaritë e fushatës së advokim-lobimit. Vëmendja e medias, nëpërmjet konferencave dhe njoftimeve për shtyp, mund të ndihmojë në përhapjen e informacionit dhe përcjelljen e tij tek një tërësi dëgjuesësh e më gjerë.

Udhëzuesi i investigimit (i hartuar nga INCA) ndihmon për adresim dhe lobim të problematikave në lidhje me ZMM dhe burimet natyrore. Pasi janë evidentuar një sërë çështjesh, që përfaqësojnë si mundësi dhe kërcënime për ZMM, duke filluar nga ndryshimet klimatike, llojet e huaja, fragmentimi i



peizazheve natyrore, rritja e urbanizimit dhe shtimi i nevojës për burime natyrore.

Listimi dhe hartëzimi i impakteve negative në menaxhimin e ZMM dhe përdorimin e burimeve natyrore, të kryer nga INCA dhe ORrMN, janë dokumente shumë të rëndësishëm, domethënës dhe rezultativë, që mund të përdoren me efikasitet jo vetëm nga OMSHC-të e tjera, por edhe nga organet shtetërore përgjegjëse, në nivel lokal dhe qendror.

Këto për faktin se shumica e burimeve natyrore, në Shqipëri, janë nën kërcënimin e presioneve të vazhdueshme si prerjet e paligjshme, gjuetia, mbi peshkimi, turizmi i pakontrolluar dhe aktivitetet rekreative jo mirë të menaxhuara, erozioni dhe degradimi i tokës, zjarret, keqmenaxhimi i ujërave dhe ndërtimi i hidrocentraleve (HEC), ndotja e mjedisit, ndotjen e saj nga përdorimi pa kriter i plehrave kimike dhe pesticideve, mostrajtimi i ujërave të zeza dhe të përdorura, menaxhimi i pa kontrolluar i territorit, ndërtimet kaotike dhe infrastruktura, vëmendja e pakët ndaj peizazhit dhe menaxhimit të integruar dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore si dhe mungesa e alternativave për zëvendësimin e tyre, etj.

Bazuar në studimet dhe investigimet e kryera nga ORrMN rezultojnë se rruga e ndjekur për shfrytëzimin e pasurive natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit ka qënë shumë shkatruese, me gjurmë tepër mbreslënëse, në shumë raste të pakthyeshme, me shumë kosto dhe pasoja të rënda në ekonominë e vendit, por dhe në vetë shëndetin e njeriut.

Aktivitetet e sipërpërmendura mund të jenë të paligjshme, ashtu sikurse mund të jenë edhe të ligjshme. Përgjithësisht për aktivitetet e paligjshme raportohet vullneti për t'i kontrolluar, duke prezantuar masat konkrete dhe statistikat krahasuese të vlerësimit të intensitetit të fenomenit nga viti në vit.

Ndërsa aktivitetet e ligjruara nga shteti (në mospërputhje me direktivat përkatëse të BE-së) janë teorikisht dhe praktikisht të pajustificueshme dhe faktorë të drejtpërdrejt që çënojnë procesin e integritetit.

Jo në pak raste janë prezantuar plane të papërshtatshme zhvillimi apo investimi në këto zona që janë edhe pjesë e rrjetit kombëtar të zonave të mbrojtura mjedisore. Këto plane konsistojnë në tjetërsimin e sipërfaqeve të mëdha natyrore, brenda këtyre zonave, për ndërtimin e resorteve të turizmit masiv e të tjera në të disa prej zonave më të mira, simbol të natyrës shqiptare.

Në Shqipëri, projektet e urbanizimit, infrastrukturor apo/dhe turistike janë e po ndërtohen pa mbikëqyrjen e duhur, kanë dëmtuar biodiversitetin dhe kanë nevojë urgjente për marrjen e masave të monitorimit dhe restaurimit. Specialistët dhe banorët shprehen se dëmtimet në mjedis janë të shumta dhe vijnë kryesisht si rrjedhojë e mungesës profesionale gjatë ndërtimit.



Ekziston një mungesë pothuajse e plotë e monitorimit dhe zbatimit nga ana e institucioneve përkatëse. Ky shkatërrim mjedisor ka sjellë edhe efekte sociale, si në rastet e HEC-ve, duke qenë se lumenjtë dhe përrenjtë përdoren edhe për ujtje.

Në shumicën e rasteve janë të dukshme shkeljet flagrante të ligjeve kombëtare dhe standardeve të institucioneve financiare ndërkombëtare. Disa nga këto shkelje kanë shkaktuar dëmtime të rënda në florën e faunën e zonave, konflikte të komunitetit me të drejtat mbi ujin, të cilat janë pasojë e mungesës së ujit.

Strukturat qendrore dhe lokale, që merren me ruajtjen dhe përdorimin e burimeve natyrore dhe elementëve të biodiversitetit, menaxherët dhe administratat e zonave të mbrojtura, strukturat ende të dobëta në bashkitë dhe aktorët e tjerë lokal, shpesh nuk kanë njohuritë, aftësitë dhe infrastrukturën e nevojshme për të arritur një menaxhim efektiv të zonave të mbrojtura dhe të burimeve natyrore.

#### Veprimi

Pas përgatitjes së fushatës së advokim-lobim-reagim dhe krijimit të forumeve qytetare mjedisore, është koha përveprim, për t'ia çuar mesazhin tërësisë së dëgjuesve. Në këtë pikë është e rëndësishme të përcaktohen mirë përparësitë dhe të gjitha veprimtaritë të kenë rezultatet dhe treguesit përkatës.

#### Identifikoni metodat e veprimit.

- Avokimi është ndërtimi i marrëdhënieve.
- Taktikat ndryshojnë nga audiencia e synuar.
- Taktika për të arritur publikun e gjerë, si:
  - ✓ Reklama.
  - ✓ Bisedime në media.
  - ✓ Editoriale.
  - ✓ Fushata ndërgjegjësimi.
  - ✓ Ngjarjet lokale.
- Taktika për të arritur mediat, si:
  - ✓ Zgjidhni mjetin e duhur të komunikimit.
  - ✓ Njoftime për shtyp, konferenca për shtyp, letra.
  - ✓ Përdorni gjuhë pozitive.
  - ✓ Sigurohuni që burimet të jenë të besueshme.
  - ✓ Sigurohuni që informacioni të jetë në kohë.
  - ✓ Lokalizoni çështjen.
  - ✓ Theksoni pjesën e interesit njerëzor.
  - ✓ Tregoni mbështetje.
- Taktika për të arritur nivelin politik të qeverisë:



- ✓ Takime me zyrtarët e zgjedhur (qëndror e lokal).
- ✓ Fushatat me shkrim që pastaj pasojnë me takime direkte.
- ✓ Shpërndani dokumentacionin e rastit që vërteton rastin tuaj.
- ✓ Peticione.
- ✓ Prezantime me grupet.
- ✓ Prezantim para një Komisioni Parlamentar apo Bashkiak.
- Taktika për të arritur bashkëbisedimin me stafet e sketorëve të qeverisjes:
  - ✓ Njihuni me punonjësit e sektorëve përgjegjëse për çështjen.
  - ✓ Takohuni me punonjës të tjerë të qeverisjes që mund të kenë interes në këtë çështje.
  - ✓ Jeni të përgatitur me informacionin e diskutimit dhe informacionin e çështjes me të cilin mund të përdoret brenda qeverisë.

#### *Monitorimi dhe vlerësimi*

Monitorimi përfshin mbledhjen e informacionit për të matur efektin e fushatës së advokim-lobimit. Gjatë monitorimi analizohen njerëzit, materialet dhe burimet e disponueshme si dhe veprimtaritë, produktet me rezultatet që synohen të arrihen. Monitorimi duhet të shoqërojë të gjitha fazat e veprimtarive. Programi i monitorimit është i nevojshëm për të siguruar ndjenjën e përgjegjësisë dhe kërkesës së llogarisë, për të parë nëse ka pasur efekt një fushatë mediatike, duke monitoruar mbulimin veprimtarive nga shtypi dhe media.

#### **Vlerësoni efektivitetin**

- ❖ Rishikoni rregullisht secilin nga hapat për t'u siguruar që strategjia është efektive.
- ❖ Tërhiquni në kohë nga taktikat që nuk funksionojnë dhe ndërtoni një të suksesshme.
- ❖ Rivendoseni si mundësi dhe sfida të reja.
- ❖ Komunikoni ndryshimet brenda vendit.

#### **Bëni kujdes që:**

- ❖ Komunikimet të jenë çelësi i suksesit.
- ❖ Ndërtoni një marrëdhënie me shumë zëra.
- ❖ Planifikimi është vendimtar.
- ❖ Mesazhet pozitive janë të rëndësishme.
- ❖ Avokimi ka të bëjë me ndërtimin e mirëmarrëdhënieve të ndërsjellta, bazuar në interesa.



## 4. ADRESIMI I PROBLEMATIKAVE NEGATIVE NË ZMM SHËNJESTËR TË KOMUNIKIM-ADVOKIMIT

### 4.1. PJESËMARRJA E ORRrMN DHE QYTETARE PËR ADRESIM DHE VENDIMMARRJE

Korniza politike e Shqipërisë duhet t'i konsiderojë organizatat e shoqërisë civile si partner të dobishëm, për të garantuar efikasitetin e politikave. Ato mund të konsultohen mbi praktikat më të mira dhe mund të bëhen partner në ofrimin e shërbimeve. Kjo është shumë e rëndësishme përse i përket politikës në vend.

OMShC nuk janë mjaftueshëm të impenjuara në këtë kontekst. Shpesh herë bashkëveprojnë me organet kompetente ligjbërëse, por në praktikë politika aktuale drejtohet nga disa ide specifike dhe OMSHC-të e kanë të vështirë të arrijnë në një konsensus.

Veprimtaritë e OMSHC-ve në Shqipëri kanë disa vështirësi, si një demokraci e limituar pjesëmarrëse. Ideja e shoqërisë civile është një përbërës kryesor në pjesëmarrjen e proceseve vendimmarrëse. OMSHC-të kërkojnë një pjesëmarrje më të madhe në temat delikate si masat që duhen marrë kundër degradimit njerëzor të natyrës dhe biodiversitetit.

Forcimi i shoqërisë civile, sidomos në fushën e ruajtjes dhe promovimit të vlerave dhe burimeve natyrore, kërkon një investim afatgjatë, jo vetëm në mbështetjen me fonde për nisma dhe aktivitete të ndryshme, por edhe në rritjen e kapaciteteve të tyre si psh. në aktivitete advokuese, lobuese dhe reaguese.

#### 4.1.1 Ç'farë kuptojmë me pjesëmarrje të OMSHC-ve dhe publikut në adresim dhe vendimmarrje?

Pjesëmarrja e OMSHC-ve dhe e publikut duhet nënkuptuar si një veprim individual dhe/ose të përbashkët, me qëllim identifikimin dhe adresimin e problematikave dhe ndikimet negative që shoqërojnë ZMM, përdorimin e burimeve natyrore dhe të peizazhit.

Pjesëmarrja është një proces ku OMSHC-të dhe grupet e interesit organizohen dhe punojnë së bashku, qoftë në nivel individual ose përmes organizatave të shoqërisë civile, për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes.

Pjesëmarrja në procese vendimmarrëse do të thotë mundësi për OMSHC-të, qytetarët dhe palët e tjera të interesuara për të ndikuar në zhvillimin e politikave, ligjeve dhe përmirësimin e menaxhimit, të cilat i prekin ata, ZMM dhe burimet natyrore.



#### 4.1.2 A mund të zëvendësojë pjesëmarrja qytetare përgjegjësitë kushtetuese/ligjore të institucioneve shtetërore?

Pjesëmarrja e OMSHC-ve dhe e grupeve të interesit nuk i cënon kompetencat kushtetuese dhe ligjore të përfaqësuesve të organeve shtetërore në nivel qendror dhe lokal, në procedurën e miratimit dhe zbatimit të ligjeve, të identifikimit të ndikimeve negative në ZMM, në përdorimin e burimeve natyrore dhe të peizazhit si dhe të instrumenteve të politikave publike, por për më tepër ua mundëson këtyre organeve t'i zbatojnë procedurat dhe kompetenca në mënyrë më efektive.

#### 4.1.3 A kanë detyrime ligjore dhe institucionale të organeve shtetërore që të përfshijnë publikun dhe OMSHC-t në punët e tyre?

Të gjitha organet shtetërore, qendrore dhe lokale, e kanë detyrim ligjor që të përfshijnë qytetarët në punën e tyre, qoftë në hartim apo zbatim të politikave dhe programeve të tyre. Detyrimet më të mëdha i ka niveli vendor, ku secila bashki duhet t'i njoftojë qytetarët, grupet e interesit dhe OJF-t mbi planet ose programet e rëndësishme për kur ato kanë ndikim të drejtpërdrejt apo/dhe tërthorazi në menaxhimin e rrjetit të ZNM dhe të burimeve natyrore.

Këto grupe kanë të drejtë për të marrë pjesë në aktivitetet përkatëse të bashkisë, të drejtën e peticionit, të iniciativës qytetare, referendumit lokal, të reagimit, etj, ndërsa bashkitë detyrohen që të themelojnë grupe/forume konsultative, sipas sektorëve, në të cilat duhet të ftohen edhe përfaqësues të ORrMN.

Në nivelin kombëtar, të gjitha aktet qeveritare/lokale duhet të konsultohen paraprakisht me publikun dhe jo vetëm këto, por edhe projektet e mëdha (të ashtuquajtura strategjike), ndërsa qeveria detyrohet që të ofrojë informata të mjaftueshme rreth dokumentit që konsultohet, kohë të mjaftueshme për kontribut, si dhe të raportojë për rezultatet e konsultimit. Për të gjitha mund dhe duhet të organizohen dëgjesa publike, ndërsa ORrMN mund të marrin pjesë edhe në takimet e komisioneve bashkiake apo/dhe parlamentare.

#### 4.1.4 Cilat janë nivelet kryesore të pjesëmarrjes së ORrMN, të grupeve të interesit dhe publikut?

Ekzistojnë pesë nivele të pjesëmarrjes, në lidhje me të identifikimin e ndikimeve negative në ZMM, të përdorimit të burimeve dhe të peizazhit natyror:

- i. Informimi;**
- ii. konsultimi;**
- iii. bashkëbisedimi/dialogu;**
- iv. bashkëpunimi/partneriteti;**
- v. negociimi.**





#### 4.1.4.i Çfarë është informimi?

Qasja në informata është baza e të gjithë hapave pasues në përfshirjen e organizatave të RrMN në procesin e adresimit dhe vendimmarrjes. Ky është një nivel relativisht i ulët i pjesëmarrjes, i cili zakonisht konsiston në ofrimin e informacionit nga organet shtetërore qendrore dhe lokale, duke mos kërkuar dhe duke mos pritur ndërveprim ose përfshirje të OJF-ve.

Informimi është relevant për të gjithë hapat e procesit të vendimmarrjes për identifikimin dhe mënjanimin e ndikimeve negative në ZMM dhe në përdorimin e burimeve natyrore e të peizazhit. Pa qenë të informuar paraprakisht për planet dhe punën e institucioneve shtetërore ORrMN, qytetarët dhe grupet e interesit nuk mund të marrin pjesë në asnjë fazë të mëvonshme të punës së institucioneve përkatëse. Ajo që duhet të theksohet është se në të gjitha rastet, informacioni i dhënë duhet të lidhet me çështjen, të jetë i hollësishëm, në kohë, objektiv, i besueshëm dhe lehtësisht i kuptueshëm. Aksesit aktiv në informacion shërben si kusht paraprak për ndjekjen e niveleve të pjesëmarrjes së qytetarëve.

#### 4.1.4.ii Çfarë është konsultimi?

Konsultimi është një formë e pjesëmarrjes, ku ORrMN u kërkojnë grupeve të interesit, qytetarëve dhe/apo organeve shtetërore mendimin e tyre rreth një çështje të caktuar të problematikave të zhvillimit, planifikimit dhe të eliminimit të ndikimeve negative në ZMM si dhe në përdorimin e burimeve dhe të peizazhit natyrore të ZMM. Ndërkohë konsultimi zakonisht nënkupton edhe informimin e qytetarëve, grupeve të interesit dhe të ORrMN nga organet shtetërore për zhvillimet e ndryshme dhe kërkesën për komente, qëndrime dhe reagime.

Mendimet e qytetarëve dhe të palëve të interesit mund të kërkohen ose jo nga qeveria. Qytetarët dhe ORrMN mund/duhet të japin mendimet e tyre edhe nëpërmjet kanaleve zyrtare gjatë periudhës së njoftimit dhe komenteve.

Procedurat për konsultimet me publikun bazohen kryesisht te rregullat joformale, të cilat ndonjëherë janë ekuivalente me rregulloret e brendshme dhe me mbështetje të ligjit “Të Drejtës për Informim”, “Të mbrojtjes së Mjedisit”, “Të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor”, etj.

Procesi efikas i konsultimit kërkon informimin paraprak të grupeve të interesit dhe qytetarëve nga ana e qeverisë. Shëmbuj të metodave të konsultimit (si në raste pozitive dhe negative) përfshijnë komente mbi projektligjet, anketime mbi opinionin publik, fokus grupe, dëgjesa publike, disa forume me pjesëmarrje tripalëshe, organe këshilluese, komisione, këshilla etj.



#### 4.1.4.iii Çfarë është dialogu?

Dialogu është një proces i vazhdueshëm i konsultimit në mes të organeve shtetërore dhe ORrMN, i cili ndodh në të gjitha fazat e bërjes dhe zbatimit të politikave zhvillimore deri te vlerësimi dhe riformulimi i tyre.

Dialogu mund të jetë i gjerë apo specifik. Dialogu i gjerë nuk është i lidhur me ndonjë proces specifik të zhvillimit të politikave, por mbetet i përgjithshëm. Dialogu specifik ndërtohet në interesa të përbashkëta për zhvillim të një politike të caktuar, ndërsa rezulton me rekomandime dhe veprime konkrete, në rastin tonë për mirë qeverisjen e rrjetit të ZMM dhe të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Dialogu kërkon kontribut domethënës të qytetarëve në vendimmarrje dhe politikëbërje, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive, e cila mbështetet te partneriteti midis organeve qeveritare, ORrMN, palëve të interesit dhe komunitetit.

#### 4.1.4.iv Çfarë është partneriteti?

Partneriteti nënkupton përgjegjësi të përbashkëta në secilin hap të procesit të adresimit apo vendimmarrjes në mes të organeve shtetërore, në nivel qendror e lokal dhe ORrMN. Kjo është edhe forma më e lartë e pjesëmarrjes. Në këtë nivel ORrMN dhe organet shtetërore nisin një bashkëpunim të ngushtë, por duke u siguruar që në të njëjtën kohë OShC-të të vazhdojnë të mbesin të pavarura dhe të kenë të drejtën e fushatave dhe veprimeve pavarësisht nga situata e partneritetit.

Rastet e metodave për partneritet dhe pjesëmarrje aktive janë të ngjashme me konsultimet, por ndryshimi qëndron te autoriteti i caktuar për vendimmarrjen si p.sh komisioni këshillues, forumet qytetare të diskutimit, grupet e punës, paneli dhe procesi i dialogut, etj. Por që palët e ineteresit dhe qytetarët për të mbështetur dhe të pranojnë vendimet me ndikim të drejtpërdrejt ndaj tyre duhet të: (i) **informohen** mjaftueshëm për të gjithë procesin vendimmarrës; (ii) **dëgjoen** para se autoritetet publike të marrin vendimin; (iii) kenë **ndikim** në vendim; dhe (iv) jenë të gatshëm të **mbështesin ose pranojnë vendimin**.

#### 4.1.4.v Çfarë është negociimi?

Me negociim duhet të nënkuptohet veprimi/ndërhyrjae një apo disa organizatave për të lehtësuar a këshilluar individët apo dhe grupet e ineteresit, në rastet e konflikteve apo të rënies në ujdi për një apo disa probleme që kanë ndërmjet tyre dhe zgjidhjet e mundshme.

Në rastet e negociimit roli i ORrMN duhet të drejtohet si më poshtë:

- Marrin pjesë në një punë, në një bashkëbisedë a në diçka tjetër që edhe mund të lidhet me organizatën, por kryesisht i takon komunitetit apo dhe grupeve të interesit, duke kryer rolin e negociimit/lehtësimit me



strukturat shtetërore (në nivel qendror e lokal), me subjektet e ndryshme ekonomike, infrastrukturës, turizmit, etj të kësaj natyre.

- Marrin pjesë dhe kryen negocim për të ndërprerë vazhdimin e mëtejshëm ose për t'i dhënë drejtim tjetër problematikave që shqetëson komunitetin, OJF dhe grupet e interesit, në lidhje me ruajtjen e natyrës dhe të përdorimit të burimeve natyrore.
- Marrin pjesë, duke shërbyer për të lehtësuar zhvillimin e diçkaje a për të bërë diçka, për të lehtësuar, që sjellë dobi dhe që ndihmon zhvillimin (rritjen) e kërkesave të komunitetit dhe grupeve të interesit.
- Për të shqyrtuar a sqaruar një çështje, t'i jap rrugë zhvillimit a përfundimit të diçkaje, duke hequr ose duke kapërcyer pengesat; të kryej a përfundoj konfliktet, etj.
- Të ndërhyjnë pranë dikujt apo grupit për të arritur një marrëveshje a për të zgjidhur diçka në dobi të tjetrit.
- Të zgjidhi një çështje/problematikë të rëndësishme ngatërresash, nëpërmjet dhënies së ndihmës, duke lehtësuar zhvillimin e procesit, mundin a vështirësitë, duke i këshilluar, mësuar se si duhet të sillen, si të veprojnë ose çfarë duhet të bëjnë; si të gjejnë një gjuhë të përbashkët mirëkuptimi; t'u sugjeroj zgjidhjen më të mundshmen që përkrah dhe mbështet palët konfliktuese.

#### ***4.2. PËRSE ËSHTË E RËNDËSISHME PJESËMARRJA E ORrMN DHE E KOMUNITETIT NË VENDIMMARRJET LOKALE, KOMBËTARE DHE RAJONALE?***

1. Pjesëmarrja rrit efikasitetin e mirëqeverisjes së rrjetit të ZMM dhe të përdorimit të burimeve natyrore nga ana e organeve shtetërore dhe subjekteve të licensuar, pasi:

- Mundëson një proces të vazhdueshëm komunikimi të OrRMN dhe komuniteteve me vendimmarrësit;
- u jep mundësi vendimmarrësve që të jenë koherent (të lidhur ngushtë) dhe të njohin nevojat dhe prioritetet e ORrMN dhe komuniteteve lokale;
- nevojat dhe prioritetet vendimmarrësit duhet t'i mbajnë në konsideratë në planifikimin dhe zhvillim të projekteve, pra duke orientuar përdorimin e burimeve sipas nevojave reale të komunitetit.

2. Pjesëmarrja si mjet për të reaguar ndaj dukurive të dëmshme dhe për të luftuar korrupsionin, në lidhje me menaxhimin e ZMM, të burimeve dhe peizazhin natyror:

- Pjesëmarrja zhvillohet përmes rrugëve që nxisin komunikimin mes ORrMN, komunitetit dhe organeve shtetërore.



- Element i rëndësishëm i pjesëmarrjes është komunikimi dhe informimi i ndërsjelltë mes ORrMN e komunitetit për nevojat dhe pritshmëritë e tyre me organet shtetërore.
- Pjesëmarrja dhe informimi i vazhdueshëm ul ndjeshëm dukuritë negative dhe shanset për korrupsion dhe ndihmon përdorimin e qëndrueshëm dhe të plotë të burimeve natyrore, duke sjell njëherazi edhe rritjen e efektivitetit në mirëqeverisje dhe menaxhim të ZMM.

3. Pjesëmarrja **gjeneron ide të reja** për zhvillim, administrim, menaxhim dhe përfitim nga ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i ZMM dhe i burimeve natyrore:

- Komunikimi mes ORrMN e komunitetit me vendimmarrësit apo organeve shtetërore krijon mundësinë edhe të gjenerimit të ideve të reja, të cilat duhen zbatuar për përmirësimin e cilësinë së jetës të komunitetit, të qëndrueshmërisë së përdorimit të burimeve natyrore dhe të objektivave të menaxhimit të ZMM.

4. Pjesëmarrja rrit mbështetjen për të **gjetur rrugëzgjdhje të reja** në përputhje me interesit e zhvillimit të komunitetit:

- Komuniteti edukohet dhe fillon të mendojë në mënyrë reaguese-kritike dhe krijuese në përpjekjen për të gjetur rrugëzgjdhje të reja të problemeve që i shqetësojnë të gjithë.

#### ***4.3. ROLI I ORGANEVE SHTETËRORE NË NXITJEN E PJESËMARRJES SË ORrMN DHE KOMUNITETIT NË ADRESIMIN E PROBLEMATIKAVE NË VENDIMMARRJE***

**Njësitë e Qeverisjes Vendore** në Shqipëri janë: Bashkia, Qarku, nëndarjet administrative, bazuar në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit Nr.8653, datë 31.7.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

***Bashkia:*** Njësi administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh kryesisht në zona urbane dhe në raste të veçanta përfshin dhe zonat rurale. Nëndarjet e Bashkisë: lagje me mbi 15 mijë banorë, fshati mbi 2000 banorë.

***Qarku:*** Njësi administrativo-territorial, i cili përbëhet nga Bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkëta. Nëndarjet e qarkut: rrethi.

**Njësitë e Qeverisjes Vendore:** përbëhen nga organet përfaqësuese dhe organet ekzekutive.

- ***Organet përfaqësuese:*** Këshilli Bashkiak dhe Këshilli i Qarkut.



- **Organet ekzekutive** (që organizon drejtpërdrejt vënien në jetë të ligjeve, të vendimeve e të urdhëresave në fushat e administratës shtetërore): Kryetari i Bashkisë; Kryetari dhe Kryesia e Këshillit të Qarkut.

Njësitë e Qeverisjes Vendore kryejnë funksione **të veta, të përbashkëta dhe të deleguara (të detyrueshme dhe jo të detyrueshme).**

1. Në **funksionet e veta** përfshihen:

- Infrastruktura dhe shërbimet publike.
- Shërbimet me karakter social, kulturor dhe sportiv.
- Zhvillimi ekonomik vendor.
- Rendi dhe mbrojtja civile.

2. Në **funksione të përbashkëta** me pushtetin qendror, përfshihen:

- Arsimin parashkollor dhe parauniversitar.
- Sistemin e shërbimit parësor shëndetësor dhe mbrojtjen e shëndetit publik.
- Kujdesin social, zbutjen e varfërisë dhe garantimin e funksionimit të institucioneve përkatëse.
- Rendin publik dhe mbrojtjen civile.
- Mbrojtjen e mjedisit.
- Funksione të tjera të përbashkëta.

3. Në **funksione të deleguara**, përfshihen:

Funksionet dhe kompetencat e deleguara janë të detyrueshme ose jo të detyrueshme.

a. *Funksione të detyrueshme*, janë ato të përcaktuara me ligj. Institucionet qendrore në këtë rast përcaktojnë edhe procedurat e zbatimit si dhe të kontrollit mbi zbatimin tyre.

b. *Funksionet jo të detyrueshme*, delegohen mbi bazën e një marrëveshjeje midis njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe institucionit qendror përgjegjës me ligj përkëtë funksion ose kompetencë.

Institucionet qendrore u garantojnë njësisë të qeverisjes vendore mbështetjen e nevojshme për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

#### **4.4. DREJTIMET KRYESORE PËR PËRFSHIRJEN E OMSHC-ve DHE GRUPET E INTERESIT NË REAGIM DHE VENDIMARRJE**

4.4.1 Informimi është hapi i parë drejt reagimit dhe përfshirjes së tyre në vendimarrje.

E drejta e publikut për t'u informuar nga organet vendore nuk është thjesht një detyrim ligjor, por edhe domosdoshmëri për të rritur efektivitetin e qeverisjes.



Kjo për arsye se:

- OMSHC-të dhe komuniteti i informuar ndërtojnë pritshmëri realiste ndaj punës së organeve shtetërore.
- OMSHC-të dhe komunitetit i jepet një informacion objektiv që i ndihmon të kuptojnë problemet, alternativat, mundësitë dhe zgjidhjet.
- OMSHC-të dhe komuniteti i informuar nxitet të ndërveprojë mes strukturën shtetërore dhe të sugjerojë ide e veprime për ndryshime dhe/ose përmirësime që mund të ndikojnë mbi gjithë palët e interesuara.
- Informimi rrit transparencën e aktivitetit të strukturave shtetërore, duke krijuar kushte të rëndësishme për të luftuar korrupsionin.

#### 4.4.2 Forma të ndryshme reagimi dhe përfshirjeje.

- **Konsultimi**, në procesin e reagimit dhe të marrjes së vendimeve që ndikojnë drejtpërdrejt mbi komunitetin.
- **Bashkëpunimi**, duke qenë partner me komunitetin në çdo aspekt të regimit dhe vendimmarrjes, përfshirë zhvillimine alternativave dhe identifikimin e zgjidhjeve të preferuara.
- **Përfshirje**, është shumë më e gjerë se dy format e lart përmendura dhe nënkupton angazhimin e OMSHC-ve dhe të komunitetit në të gjitha hallkat e reagimit dhe të marrjes së vendimeve nga organet shtetërore, duke identifikuar nevojat, për caktimin e prioriteteve, formulimin, zbatimin dhe monitorimin e vendimit.
- **Anëtarësimi**, është një tjetër formë e pjesëmarrjes dhe përfshirjes aktive në organizata jo qeveritare. OJF-të përfaqësojnë larmi interesash dhe përfshirja në to është një mundësi e mirë për të ndërmarrë iniciativa të mire organizuara dhe për të rritur ndikimi dhe presionin mbi vendimmarrësit dhe organet shtetërore.

Është e qartë që për të garantuar pjesëmarrjen e OJF-ve dhe të komunitetit në reagim dhe vendimmarrje nuk mjafton vetëm angazhimi i organeve shtetërore, por edhe i vetë OJF-ve, i komunitetit apo i grupeve të interesit, që kërkojnë ruajtjen dhe përdorimin e balancuar të burimeve natyrore apo përmirësimine jetës së tyre.

### 4.5. Ç'FARË DUHET TË BËHET NGA ANA E ORrMN-ve?

#### 4.5.1 Identifikoni çështjen/et

Për të cilat ju synoni të ndikoni mbi vendimmarrësit, duke marrë në konsideratë: Kudo të fokusoheni? Cila është çështja/et që lidhen me tërësinë e problematikave që shqetësojnë komunitetin në nivelin lokal, që lidhen me përmirësimin e menaxhimit, ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm? Pasi të keni përcaktuar se tek cilët prej grupeve përbërëse të komunitetit do të



fokusoheni, çdo njëri pjestar i grupit të OJF duhet të përfshihet në procesin e reagimit ndaj çështjes/ve që shqetësojnë komunitetin.

Për t'i identifikuar çështjet, që janë me interes për komunitetin, pjestarët e grupit të OJF-ve duhet të:

- Zhvillojnë biseda informale me individë që i përkasin grupit/eve të shënjestruara.
- Përdorin burime, mjete teknike dhe profesionale të ndryshme që kanë ndikim të drejtpërdrejt mbi individët dhe komunitetin në tërësi.

#### 4.5.2 Identifikoni detyrat dhe përgjegjësitë e organeve shtetërore.

Në përputhje me grupin e shënjestruar dhe çështjet e identifikuar duhet të fokusoheni tek problematikat e promovimit dhe adresimit të një menaxhimi të qëndrueshëm të vlerave dhe burimeve natyrore në ZMM, të lidhura me organet përgjegjëse shtetërore, por edhe me organet e pushtetit vendor, që kanë detyrime për të përmbushur të gjitha nevojat apo pritshmëritë e komunitetit për burime natyrore.

Prandaj është e domosdoshme që të identifikoni se **“kush” është përgjegjës dhe për “çfarë”** në nivelin lokal, në lidhje me politikat, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e burimeve natyrore brenda ZMM.

#### 4.5.3 Përcaktoni qëllimin dhe objektivat tuaja.

- “Çfarë duam të arrijmë”?
- “Çfarë duam të këkojmë nga organet përgjegjëse shtetërore”?
- “Çfarë duam të ndryshojmë dhe nga cili/ët e presim këtë ndryshim”?
- “Çfarë duam të ndryshojmë në sjelljen dhe vetëpërgjegjëshmërinë e komunitetit dhe të palëve të tjera të interesit”?

#### 4.5.4 Cila është një zgjidhje?

Një zgjidhje është një aspekt specifik i punës së organizatave të RrMN ose një proces pune që është ndërmarrë për të zgjidhur një çështje, problem apo sfidë të veçantë. Kur dokumentoni zgjidhjen përpunoni të jeni specifikë për të siguruar të tjerët për të kuptuar dhe njohur punën tuaj.

Zgjidhjet i përgjigjen sfidave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe mirëqenies njerëzore dhe kontribuojnë në ruajtjen e ZMM, përmirësimin e shëndetit të biodiversitetit dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore e peizazhit.

Zgjidhjet janë efektive kur zbatimi i tyre tregon një ndikim pozitiv të demonstruar tek njerëzit, komuniteti apo grupet e interesit.



Elementet të zgjidhjes kanë potencial për përshtatje, përsëritje ose ngritje në kontekste të tjera lokale, kombëtare, rajonale, sociale dhe sektoriale.

Një proces konsultimi, me pjesëmarrjen e banorëve, përdoruesve të ndryshëm të burimeve, OJF-të mjedisore, biznesin, autoritetet lokale, duhet të ndërtoj një vizion dhe zgjidhje të përbashkët për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Platforma e dialogut duhet të krijojë modelin e qeverisjes dhe zbatimin e rregullave të menaxhimit të ZMM apo/dhe të mirëpërdorimit të burimeve dhe të peizazhit natyror.

Është vënë re se ka mungesë të angazhimit të palëve të interesuara, përdorim të paqëndrueshëm të burimeve natyrore; për analizat e nevojshme për të identifikuar impaktet dhe boshllëqet në qasjet ekzistuese të ruajtjes së natyrës dhe të përbërësve të saj biologjik dhe ekologjik si dhe ZMM me rëndësi ruajtjeje, etj.

Këto mangësi duhet të ndihmojnë ORrMN dhe OJF-t partnere për të kuptuar dhe përcaktuar zgjidhjet e duhura, të lidhura me përmirësimin e qeverisjes, zhvillimin e proceseve pjesëmarrëse që lidhen me interesat e banorëve/komuniteteve lokale si dhe për të adresuar tek organet shtetërore qendrore dhe lokale zgjidhjet e nevojshme, mbështetjen teknike, financiare dhe burimet njerëzore për të arritur suksesin e dëshiruar.

Konkluzionet dhe zgjidhjet e propozuara nga ORrMN, në kudër të projektit për promovimin dhe adresimin e një menaxhimi të qëndrueshëm të ZMM dhe të burimeve natyrore, kontribuan për të nxitur pjesëmarrjen dhe për të arritur konsensus me sektorëve kyç të përfshirë palët e interesit, përfshirë autoritetet lokale, duke përdorur një qasje të lehtësimit bashkëpunues, zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve, konflikteve, modelin e qeverisjes (me role dhe përgjegjësi sipas sektorëve e zonave të përdorimit) si dhe u mundëson grupeve të ndryshme që të sqarojnë atë që ata duan apo nuk duan të arrijnë në procesin e zhvillimit të ZMM dhe të përfitimeve të tyre.

Rezultatet e dialogut e të bashkëbisedimeve me palët e interesit dhe grupet kryesore të përdoruesve, gjithashtu, mundësuan që të përcaktojmë si RrMN hapat që duhen ndjekur në procesin e zbatimit të menaxhimit të ZMM dhe të përdorimit të burimeve natyrore, apo dhe konsolidimin e një modeli qeverisës, përmes funksionimit të një Forumi Lokal Mjedisor, strukturë që siguron mbështetje ligjore dhe të intersave të komunitetit, të përbërë nga përfaqësues të ndryshëm.

Qasja e lehtësimit bashkëpunues dhe zgjidhja alternative e konflikteve mund të realizohet nëpërmjet ORrMN, të cilat, me mbështetje teknike dhe logjistike, e përcjellin më mirë se kushdo shqetësimin dhe organizimin e reagimit, ndaj strukturave përgjegjëse. Takimet duhet të jenë korrekte, duke trajtuar një çështje konkrete që nxitë sedrën dhe angazhimin konkret të tyre.





Roli i ndërmjetës dhe lehtësuesi organizatave të RrMN duhet të jetë neutral dhe i pavarur, pasi është një rol teknik në organizimin e procesit social të identifikimit, organizimit, komunikimit, lobimit dhe reagimit ndaj dukurive negative apo proceseve që çënojnë jetesën e komuniteteve, por njëherazi edhe ekzistencën e vlerave dhe të burimeve natyrore brenda ZMM.

Në këtë sens është i dukshëm roli iORrMN, lidhur me paqëndrueshmërinë politike, për presionet në rritje mbi burimet natyrore (të cilat janëjetike për ekonominë lokale), praktikat e papërshtatshme bujqësore, shfrytëzimi dhe papërgjegjësia e palëve të interesuara, konteksti i paqartë dhe i papërshtatshëm institucional dhe ligjor; ndarje e përgjegjësive midis palëve të interesuara, etj, kërkojnë qeverisje të përbashkët të përdorimit të burimeve natyrore dhe menaxhim të përgjegjshëm të ZMM.

Mos harroni se organizatat e RrMN, sidomos apo lokale, janë një grup i kufizuar në numër që reagojnë për një çështje të rëndësishëm edhe për komunitetin. Që reagimi i tyre të bëhet edhe më i fortë ndaj organet shtetërore përgjegjëse, duhet të mobilizoni komunitetin dhe palët e interesuara, të cilët janë identifikuar paraprakisht dhe e ndjeni si nevojë mbështetjen e tyre për një zgjidhje konsensuale.



## 5. CILËT JANË GRUPET E INTERESIT QË DUHET TË NDIKONI?

Qeverisja efektive siguron pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve qeverisëse, OJF-ve, sektorit privat, shoqërisë civile dhe grupeve të komunitetit, qytetarëve të zakonshëm, individëve në përpjekjet bashkëpunuese drejt zhvillimit të qëndrueshëm të natyrës. Qeverisja efektive përbën një alternativë ndaj politikës nga lartë-poshtë, sepse përfshin qytetarët dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile në identifikimin, krijimin dhe monitorimin e politikave të mjedisit dhe të proceseve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Aktorët dhe grupet e ndryshëm të interesit, të cilët janë të prekur nga politikat dhe ndikimet e zhvillimit social, ekonomik, infrastruktura e paqëndrueshme, apo turizmi masiv, duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në hartimin dhe monitorimin e tyre.

Shoqëria civile luan një rol kyç në tejkalimin e hendekut të informacionit dhe shkëmbimit midis popullatës dhe politikës. Mund të mbështesë grumbullimin dhe shpërndarjen e informacionit, zhvillimin e politikave, zbatimin e politikave, avokimin, vlerësimin dhe monitorimin, duke siguruar që shqetësimet e atyre të prekur nga sfidat dhe politikat mjedisore të merren parasysh në qeverisjen mjedisore.

ORrMN dhe OJF-të partnere lokale, gjithashtu, promovojnë rrjetëzimin e aktorëve të ndryshëm për të trajtuar çështjet në mënyrë bashkëpunuese dhe për të ndihmuar në zhvillimin e aftësive dhe mendimit të nevojshëm për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, gjë e cila është realizuar në kuadër të funksionimit dhe angazhimit të ORrMN. Përveç rolit këshillues dhe mbështetëse, organizatat përbërëse mund të marrin dhe japin një rol më të drejtpërdrejt në menaxhimin dhe qeverisjen e biodiversitetit dhe të burimeve natyrore.

Shoqëria civile mbulon një gamë të gjerë të aktorëve, përfshirë individë, institucione akademike, pse jo edhe fetare apo grupe të fokusuara në çështje si organizatat jofitimprurëse.

Gjatë gjithë punës si RrMN dhe të zbatimit të projekteve për të ndikuar ndryshimet në nivel lokal a kombëtar, është praktikuar si erëndësishme për përfaqësuesit e organizatave, që krahas bashkëbisedimeve, duhet të komunikojnë rekomandime të qëndrueshme dhe të unifikuara. Veç kësaj, koalicionet e OMSHC-ve që demonstrojnë një grup të plotë të njohurive, shkathtësive dhe kapaciteteve dhe përfaqësojnë rajone të ndryshme kanë më



shumë gjasa të kenë një zë më të fortë dhe bindës në negociata dhe të marrin pjesë në mënyrë efektive në zhvillimin e politikave mjedisore.

Takimet sistematike dhe specifike për çështje ndërmjet ORrMN dhe palëve të tjera të interesit, dhe trajnimi për zhvillim organizativ për të përmbushur nevojat institucionale të tyre, kanë qenë thelbësore për të ndërtuar bazën e aftësive dhe kuptimin e përbashkët për mire funksionimin e tyre.

Kjo qasje e zbatuar nga INCA, gjatë fazës së parë të programit SENiOR-II, gjithashtu ka nxitur zgjerimin e rrjetëzimit dhe partneritetit të organizatave të RrMN me OJF-t mjedisore lokale apo dhe palëve të interesuara në ZMM të marra në studim, proces që ka lehtësuar shkëmbimin e njohurive, të përvojave dhe ka ofruar mundësi të reja në praktikë përmes iniciativave të përbashkëta.

Identifikimi i grupeve të përshtatshme të interesit për të marrë pjesë në komunikim, informimi, dhënie mendimesh, reagim etj, është komplekse. Sidoqoftë, transparenca dhe përfshirja e komunitetit në vendimmarrje, zelli në ndërtimin e marrëdhënieve, paraqitja e informacionit të qartë dhe të paanshëm, dhe këmbëngulja e thjeshtë, në mjaft raste, kanë ndryshuar qëndrimet e komunitetit dhe të palëve të interesuara, duke dhënë mbështetje të fortë për ruajtjen dhe mirëqeverisjen e burimeve dhe të peizazhit natyror. Njëherazi, përfshirja e tyre në procesin qeverisës, rrit transparençën e vendimmarrjes.

Ndikimi dhe angazhimi i komuniteteve lokale dhe i palëve të interesuara kërkon kohë, bashkëpunim dhe preokupim të stafit dhe burime financiare. Koha e stafit është e nevojshme për të mbështetur dhe për të shërbyer si nxitës, duke përfshirë logjistikën e takimeve, komunikimin e vazhdueshëm, sigurimin e informacionit mbi çështjet që preokupojnë palët e interesuara dhe arritjen e qëllimeve të synuara.

Qytetarët apo grupe të caktuara të interesit, tek të cilët do të ndikoni, duhet të përfshihen më shumë në këtë proces, kur çështja lidhet direkt me ta. Gjithashtu, pjesëmarrja e tyre ndodh kur të gjithë pjesëmarrësit bashkëpunojnë për të realizuar ndryshimet që synojnë apo për të siguruar një qeverisje dhe përdorim të përbashkët të burimeve natyrore. Edhe individët mund të përfshihen në procesin e vendimmarrjes, pasi kontributi i tyre mund të ndihmojë në gjetjen e zgjidhjeve të volitshme të problemeve.

Drejtimet e pjesëmarrjes së qytetarëve apo/dhe grupeve të caktuara të interesit në qeverisje janë:

- i) *pjesëmarrja pasive*, që kufizohet në informimin e thjeshtë të komunitetit;
- ii) *pjesëmarrja aktive*, që nënkupton përfshirjen sa më gjerë të tyre në vendimmarrje dhe në procesin e zbatimit.



Ndikimi dhe angazhimi duhet bërë edhe në drejtim të organeve përgjegjëse, tek të cilët duam të ndikojmë për të përmbushur objektivin që kemi përcaktuar, duke listuar specifikisht administratën shtetërore, subjektet social-ekonomike, të zgjedhurit vendor e parlamentar, detyra e të cilëve lidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e objektivit e përcaktuar për ruajtjen e natyrës dhe të përdorimit të burimeve natyrore.

Ndikimin e mbështetjes politike për vendimmarrje gjithë përfshirëse për çështje të shumta dhe perspektivat për të kuptuar nevojën e një procesi vendimmarrës për përparësitë dhe zhvillimin e planeve lokale, duke përfshirë palët e interesuara në bazë të komunitetit me njohuritë relevante lokale në lidhje me burimet natyrore.

Zbatimi i suksesshëm i çdo plani menaxhimi të ZMM kërkon kontributin e tyre dhe garanton mbështetjen e menaxhimit të qëndrueshëm. Burimet e kufizuara financiare, stafi dhe teknikët kërkojnë partneritete me komunitetin në njohjen dhe zbatimin e programeve të menaxhimit.

### ***5.1 GRUPET KRYESORE TË SYNUARA QË DUHET TËMARRIN PJESË NË INFORMIM DHE REAGIM***

Grupi apo audienca e synuar janë individët dhe grupet e njerëzve të cilëve ju u drejtoheni (përcillni mesazhin, ndikoni, kërkoni mbështetje). Grupet e interesit për komunikim, informim dhe marrjen e mendimeve për adresim të problematikës së ruajtjes dhe përdorimit të burimeve natyrore dhe të peizazhit, mund të përbëhen nga:

**1. Individët, çdo qytetar dhe grupe banorësh**, të cilët duhet të përfshihen në proces, që ndikojnë në vendimmarrje, kanë interes në politikat e zhvillimit dhe që duan të shprehin mendimin e tyre, qoftë në nivel kombëtar, lokal apo dhe rajonal (ndërkufitar) sepse, në një farë mënyre, vendimmarja lidhet me jetesën e tyre. Është e drejta dhe detyra e çdo kujt të marrë pjesë në informim, në procesin e zhvillimit dhe vendimmarrje.

**2. Komuniteti i biznesit dhe subjekte të ndryshëm social-ekonomikë**, që janë të përfshirë në proces dhe ndikojnë në vendimmarrje, kanë interesa në politikat e zhvillimit dhe që duan të shprehin mendimin e tyre për zhvillim dhe përdorim të burimeve dhe peizazhit natyror.

**3. OJF-t apo dhe organizata të ndryshme të shoqërisë civile**, që janë të përfshirë në proces, që ndikojnë në vendimmarrje, duhet të marrë pjesë sepse, në një farë mënyre, lidhen me ruajtjen, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe zhvillimin e territorit.

ZMM funksionojnë kur janë të financuara e mire menaxhuara, janë jashtëzakonisht efektive në ndalimin e kërcënimeve që shkaktojnë zhdukjen



e llojeve. Është koha që organizata të ndryshme të shoqërisë civile të ngrihen, të reagojnë dhe të vendosin strukturat qeverisëse, në nivel qendror e lokal, nën përgjegjësitë që të marrin seriozisht ruajtjen dhe mire përdorimin e burimeve dhe të peizazhit natyror.

**4. Koalicionet dhe rrjetet e bashkëpunimit**, janë grupe të mëdha njerëzish me struktura të lira ose të shtrënguara, të cilat ndihmojnë në advokimin për kauza të veçanta duke përhapur informacionin, duke ndihmuar në zbatimin e aktiviteteve ose duke mbështetur dhe bashkëpunuar për arsye se keni qëllime të ngjashme.

Koalicioni është një grup individësh, përfaqësuesish apo organizatash që punojnë bashkë për një kauzë të përbashkët, për të arritur një qëllim apo për të zgjidhur një problem të përbashkët.

Rrjetet, si në rastin e RrMN, përbëhen nga organizata që ndajnë informacione, ide dhe burime për të arritur qëllimet individuale apo të grupit. Krijimi i rrjetit të bashkëpunimit është procesi i përfitimit dhe fuqizimit të burimeve, duke krijuar dhe përdorur lidhje midis dy ose më shumë grupeve apo organizatave.

**5. Forumet lokale apo kombëtar këshillë dhënës**, që kanë funksion të këshillojnë dhe të japin rekomandime për strukturat shtetërore qendrore e vendore, administratat dhe menaxherët e ZMM, etj, mbi problematikat që shqetësojnë qytetarët dhe komunitetin, dhe duke shërbyer si ndërlidhës mes pjesëtarëve të tyre të komunitetit.

Forumi lokal mjedisor është i nevojshëm për të krijuar rrjetin e këshilltarëve rajonal për një qasje më të mirë të planifikimit dhe të buxhetimit të qeverisjes vendore për ruajtjen e natyrës.

FoLM duhet të kenë aftësinë për të krijuar grupe pune që fokusohen në fusha specifike edhe të larmishme, duke bashkëpunuar me ORrMN, të cilat janë më të afta për të përcjell dhe për të reaguar për problematikat dhe shqetësimet e tyre. Këto forume duhet të përfaqësojnë në mënyrë të drejtë pikëpamjet kolektive dhe individuale të anëtarëve, të cilët duhet të kuptojnë se qëllimi kryesor është mbrojtja e burimeve dhe e peizazhit natyror.

Njëherazi forumi mund të shërbejë për konsultime dhe diskutime midis anëtarëve të tij dhe si burim këshillimi e rekomandime për menaxherin e ZMM dhe stafin e bashkisë. Të tilla forume janë krijuar në secilën ZMM të marrë në studim, nga organizatat e RrMN.

**6. Institucionet shtetërore në nivel lokal**, që janë përgjegjësit kryesore të hartimit, zhvillimit, administrimit dhe menaxhimit ZMM dhe të burimeve natyrore.



**7. Institucionet kërkimore-studimore**, të cilët janë përgjegjës për të dhënat studimore, monitorimin dhe përcaktimin e treguesve të vlerësimit të ndikimeve negative në procesin e administrimit dhe të mirë qeverisjes së ZMM, burimeve dhe peizazhit natyror.

**8. Përfaqësuesit të parlamentit, qeverisë, ministritë, qarqet, prefektët, bashkitë**, si dhe me strukturat menaxhuese, monitoruese, ligjzbatuese etj, në nivel qendror dhe lokal.

Në këtë kontekst, këta përfaqësues, mbështetur në strategjitë, politikat, programet, dispozitat ligjore në fuqi dhe të synimeve globale, duhet të krijojnë zona të mbrojtura mjedisore, në mënyrë që biodiversiteti (bimët dhe kafshët) dhe natyra të mund të jetojnë pa presionin njerëzor, pasi në të kundërt do t'i çonte ata drejt zhdukjes.

Studimet dhe gjendja tregojnë se në vendi tonë ZMM janë nën presion të madh njerëzor dhe aktivitete njerëzore po i shkatërojnë ato. Këto autoritete pretendojnë se ZMM-ve po u kushtohet vëmendja e duhur dhe një mbështetje e madhe për ruajtjen dhe menaxhim, ndërsa në të njëjtën kohë, po ata, miratojnë zhvillime të mëdha brenda kufijve të tyre ose nuk arrijnë të parandalojnë dëmet ilegale dhe pse biodiversiteti vazhdon të ketë problem.

**9. Mediat kombëtare dhe lokale**, ndikojnë në dhënien dhe shkëmbimin e informacionit, në evidentimin dhe investigimin e problematikave, në pasqyrimin e reagimit publik dhe në përmirësimin e situatës. Fushatat për ndryshimin e dëshiruar janë hapa brenda një kornize të caktuar kohore, duke përfshirë median. Mund t'a përdorni këtë taktikë kur doni të tërhiqni vëmendjen dhe të fitoni mbështetje nga shoqëria ose të shkaktoni diskutim publik. Fushatat hapin debate publike dhe e drejtojnë publikun të ndërmarrja e veprimeve konkrete, rrisin besueshmërinë, paraqitjen dhe ekspertizën e OJF-ve.

Nëpërmjet advokimit mediatic organizatat RrMN tërheqin vëmendjen në një problem që ka nevojë të zgjidhet, ndaj një shkeljeje apo abuzimi/korupsioni, që politikëbërësit të vihen nën presion përmes mobilizimit të grupeve shoqërore dhe të përmirësimit të situatës.

Po kështu, nëpërmjet advokimit në media, organizatat promovojnë një çështje që kërkojnë ta adresojnë, të ndreqet, apo të tërheqin vëmendjen e publikut e të vendimmarrësve mbi një zgjidhje që ata ofrojnë, për problemin/et tashmë të njohur në lidhje me administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të ZMM dhe të burimeve dhe peizazhit natyror.

Advokimi mediatic duhet të mirëpërdoret në rastet/situatat kur OMSHC-të duhet të protestojnë ndaj zhvillimeve të ndryshme lokale e kombëtare, të kallëzojnë penalisht persona/zyrtarë apo/dhe të ngrejnë padi në gjykatat



civile për çështje të caktuara, si në rastin e HEC-ve në Lumin Vjosë dhe PK “Lugina e Valbonës”.

Denoncimete kryera përmes njoftimeve apo konferencave për shtyp janë raste tërheqëse për gazetarët, por edhe kryerja e kallëzimeve penale janë edhe më me interes për median.

Përdorimi i medias (TV, radiove lokale, etj) është domosdoshmëri për të arritur dhe përcuar mesazhin dhe shqetësimet në zonat rurale, në lidhje me problematikën e paracaktuar apo që ka preokupuar komunitetin, duke patur parasysh që disa çështje me rëndësi lokale nuk tërhiqin vëmendjen nga lajmet e nivelit kombëtar apo ndërkombëtar.

Qëllimi i advokimit me median është që çështjet, për të cilat OMSHC-të i kanë pjesë të misionit të tyre dhe luftojnë për t'i zgjidhur, të diskutohen në media me pjesëmarrje sa më të gjerë dhe të përfaqësuesve të komuniteteve që ata përfaqësojnë.

Duhet të theksojmë se në të shumtën e rasteve OMSHC-t nuk kanë zë të fuqishëm në të gjitha llojet e mediave. Edhe në rastet kur jepet mundësia për të shprehur apo debatuar në media për problemet që shqetësojnë OMSHC-të dhe komunitetet, marrin pjesë persona apo të ashtuquajtur ekspert të çfarëdollojshëm, jo të profilit dhe që nuk e njohim mirë temën/problematikën e diskutimit.

Ndërkohë është e këshillueshme që t'iu shmangeni ditëve me lajme të bujshme, siç janë vizitat e nivelit të lartë, ngjarjet politike apo zgjedhjet, etj, që do t'a linin tërësisht në hije ndonjë ndodhi apo çështje me kontekst më tepër lokal, për të cilat ju kini interes për t'i përcjellë në komunitet apo tek organet shtetërore kompetente.

Ndërlidhja e problematikës me ndonjë ngjarje lokale ose ditë ndërkombëtare të njohur do të mundësojë raportim më të madh në lajme. Për shëmbull, ndërmarrja aktiviteve të pastrimit të territorit nga mbeturinat (ndotjet) përbëjnë lajm, tërheq vëmendjen kur kryhet p.sh. në Ditën Ndërkombëtare të Tokës apo dhe në rastet e ngjarjeve të rëndësishme lokale, ku përfshihet një numër i madh njerëzish dhe drejtuesish, jo vetëm lokal, por edhe kombëtar, rajonal e ndërkombëtar.

OMSHC-të mund t'i përdorin këto ngjarje apo aktivitete me mjetet e ndryshme të informimit për të përcjellë mesazhe rreth aktiviteve dhe përpjekjeve të tyre advokuese. Někëto raste aktiviteti i ORrMN promovohet dhe mundohet të bëhet sa më i njohur në komunitet, para drejtuesve kryesor qëndror e lokal dhe në media. Është e dobishme të mbahet ndërmend se



vëmendja e mediave do të fitohet vetëm nëse ndodhitë janë tërheqëse dhe me peshë për një numër të madh të komunitetit apo/dhe tek pjesëmarrësit.

## ***5.2. ÇFARË MËNYRASH KOMUNIKIMI DHE ADVOKIMI DUHET TË PËRDORNI PËR TË NDIKUAR MBI VENDIMMARRËSIT?***

Rrugët mund të jenë nga më të ndryshmet në funksion të objektivit dhe organeve që shënjestroni (targetoni). Me qëllim që të komunikojnë në mënyrë efektive, duhet identifikuar qartë publiku kryesor apo grupet e synuara, duke përfshirë figura që kanë ndikim, ato jo qeveritare dhe mediat, të cilat kanë një interes në veprim ose janë të prekura.

### **a. Kur duhet të përfshihet pjesëmarrja publike?**

Pjesëmarrja e qytetarëve nuk duhet kërkuar në situata të veçanta, por duhet të jetë pjesë e jetës së përditëshme.

### **b. Si dhe Kur të Komunikoni?**

Komunikimi duhet të bëhet gjatë gjithë ciklit të veprimit të projektit, por edhe pas përfundimit të tij dhe të jetë në kohën e duhur. Është një process afatgjatë i cili përmban një sere aktivitete dhe elementesh, siç janë informacionet, mënyrat dhe kanalet përmes të cilave janë mbartur informacionet, shkaqet dhe qëllimet e informacionit, si dhe përcaktimi i një grupi specifik të synuar që do të jetë i prekur me problemin apo me zgjidhjen që përpunohet.

Përpjekjet e komunikimit duhet të përdoren për të njoftuar dhe treguar punën e bërë nga ORrMN për parandalimin e problemeve mjedisore dhe të ndikimeve negative në ZMM dhe veçanërisht të menaxhimit dhe përdorimit jo të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore.

Njëkohësisht, komunikimi i planifikuar asnjëherë nuk duhet të jetë qëllim vetëmë vete, por të paraqesë vetëm njerën nga mënyrat për realizimin e objektivave të organizatës. Pikërisht nga kjo buron nevoja për një qasje strategjike për t'iu drejtuar tërësisë së dëgjuesve të synuar, si dhe nevoja për grumbullimin sistematik të informatave nga publiku.

Ndërkohë dhe të adresimit të tyre në Komisionet përkatëse të Kuvendit, në Këshillat Bashkiak, në Ministitë përgjegjëse, tek Agjencitë ligj zbatuese, komuniteti shkencor, komunitetin e biznesit, media, OJF-t dhe palët e interesuara apo dhe individë.

### **c. Aktiviteti i komunikimit dhe advokimit mund të përfshijnë këta elementë:**

- Deklarata dhe Konferenca për shtyp.
- Debate, qëndrime publike për çështje të interesit publik.





- Organizim të paneleve, seminarëve, pjesëmarrje dhe komunikim nëpërmjet mediave.
- Organizimi i tryezave të përbashkëta të rrumbullakëta, i mbledhjeve të hapura, shkëmbimit të informacionit dhe të përvojave.
- Komunikim të drejtëpërdrejt me publikun, ligjvënësit, ligjzbatuesit dhe palët e interesuara.
- Intervistat me personat përgjegjës.
- Takime formale dhe informale me nivele të larta të menaxhimit.
- Marrja pjesë në takimet për të dhënë mendime.
- Kërkesë për informacion apo shpjegime për ankesa të qytetarëve.
- Paraqitja e rekomandimeve dhe sugjerimeve për përmirësimin e aspekteve tëndryshme të administrimit dhe menaxhimit të ZMM dhe të burimeve natyrore.
- Publikimi i raporteve vlerësuese, monitorues dhe investigues.
- Fletëpalosje, broshura, postera, buletine, artikuj promovuese, Ditarin e Natyrës, fotografitë, etiketa, logo.
- Faqet internet (web) dhe përdorimim i rrjeteve sociale.
- Tabela informuese, baner, materialet dhe pajisjet të tjera ndihmëse.
- Prodhime audiovizuale dhe video.
- Organizimi i fushatave informuese, koncerte, aktivitete sportive, shfaqje filma mjedisore, ngjarjet publike, vizita, ditët mjedisore, panairë dhe pllakata mirënjohjeje.

#### **d. Mënyra të tjera se si të informojmë, të marrin informacion, të llobojmë dhe të reagojmë.**

Gjatë punës apo/dhe aktiviteteve organizatat RrMN, për arritjen e objektivave, krahas rrugëve dhe mënyrate përcaktuara më sipër, mund të përdorin me sukses edhe:

##### ***1. Pyetësorët/sondazhet***

U krijojnë mundësinë organizatave të RrMN për të kuptuar qëndrimin (opinionin) e komunitetit në lidhje me një apo disa çështje lokale mjedisore, të identifikojnë shqetësimet e komunitetit, apo të masin nivelin e kënaqësisë apo/dhe pakënaqësisë me programet dhe punën që ofrojnë organet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, promovimin dhe përdorimin e burimeve natyrore.

Mbi bazën e të dhënave të grumbulluara nga pyetësorët/sondazhet mund të hartohet plani i informimit, komunikimit dhe reagimit nga këtyre problematikave drejtuar organeve përgjegjëse.



## ***2. Fokus grupet***

Është diskutim në një tryezë të përbashkët me përfaqësues të komunitetit dhe palët e interesuara (të përzgjedhur në përputhje me çështjet për të cilat synohen të mblidhen të dhëna) për të marrë ide dhe opinione mbi problematikat që shqetësojnë administrimin dhe menaxhimin e ZMM dhe të burimeve natyrore.

## ***3. Dëgjesa publike/bashkëbisedimi***

Konsitohet në takime dhe debate publike të ORrMN me drejtuesit, të zgjedhurit, komisionet parlamentare e vendore, me strukturat e organeve shtetërore dhe me komunitetin, për të shprehur e reaguar ndaj shqetësimit të identifikuar përpam dhe gjatë marrjessëvendimeve.

## ***4. Pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit Bashkiak***

Institucioni ku merren vendime të rëndësishme, që lidhen me administrimin, menaxhimin, të ruajtjes së natyrës dhe të përdorimit të burimeve natyrore dhe zhvillimin e jetës së komunitetit, etj, është e nevojshme, pasi qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile (kryesisht ato lokale) nuk duhet të qëndrojnë indiferent ndaj zhvillimeve, vendimeve dhe aktivitetit të këshillit.

Po kështu ndjekja e mbledhjeve të këshillit bashkiak ku, sipas ligjit janë të hapura për publikun me përjashtim të rasteve kur anëtarët e këshillit vendosin me votë për zhvillimin e mbyllur të mbledhjes, janë shumë të rëndësishme dhe duhen vlerësuar për problematikat që shqetësojnë komunitetin dhe organizatat.

## ***5. Të marrësh pjesë në Komisione Parlamentare***

Syno në praninë efektive të komunitetit në vendimmarrje kombëtare dhe lokale. Pjesëmarrja mund të organizohet me iniciativën e drejtuesve të komisioneve, të deputetit apo grup deputetësh, të strukturave të tjera parlamentare si dhe me iniciativën e shoqërisë civile, por mund të jenë edhe iniciativa që merretnga mbështetja e komunitetit në përputhje me problematikat e jetës së tyre.

## ***6. Të drejtosh letra***

Në të gjitha nivelet e Autoriteteve qeverisëse kombëtare e lokale, Parlamentit Evropian, Trupit diplomatik, OSBE-s, Agjencie ndërkombëtare për bashkëpunim dhe zhvillim, Organeve të Prokurorisë dhe Gjykatave, Avokatit të Popullit, Agjencie monitoruese dhe ligjzbatuese, Organizmave dhe forumeve ndërkombëtare jo qeveritare në lidhje me mjedisin dhenatyrën, Sekretariateve të Konventave, ku Shqipëria është palë nënshkruese, Bankave të vendit dhe ndërkombëtare, Medias, etj.



### ***7. Të bëhesh pjesë e iniciativave që synojnë të rrisin përgjegjshmërinë dhe efikasitetin e organeve shtetërore***

Këto iniciativa mund të vijnë nga komuniteti apo shoqëria civile, të zhvillohen nga format e thjeshta deri tek ndërmarrja e referendumeve për çështje me rëndësi jetike për komunitetin.

### ***8. Të protestosh, të hartohen peticione dhe mbajtja e referendumit***

Janë elementë shumë të domosdoshëm dhe të nevojshëm për pjesëmarrjen dhe reagimin qytetar për të mos pranuar politika dhe zhvillime negative në jetesën e komuniteti apo të cënimit të burimeve natyrore, por njëherazi sjellin edhe ndikimet pozitive për përmirësimin e situatës.

Përvojë e sukseshme është praktikimi i modeleve dhe i organizimit të:

- Aktivitete në përkujtim të ngjarjeve të rëndësishme lokale dhe kombëtare, të shoqëruar me protesta.
- Aktivitete sportive/argëtuese dhe protestë.
- Aktivitet muzikore/kulturore dhe protestë.
- Shfaqje filma/dokumentare mjedisore dhe protestë.
- Aktivitete në kuadër të ditëve mjedisore dhe protestë, etj.

Në këto iniciativa duhet bërë kujdes nga organizatorët, veçanërisht prej ORrMN, për të shmangur pranin dhe ndikimin e interesave të partive politike dhe të sindikatave, për të mos kompromentuar qëllimin dhe reagimin qytetar gjatë protestës apo peticionit.

### ***9. Përdorimi me efikasitet i rrjeteve sociale dhe portalet***

Janë një nga mjetet kyç të përdorura të komunikimit, përmes së cilave mund të krijosh dhe të ndash informacione në mënyrë të shpejtë dhe të drejtpërdrejt, për t'ua prezantuar mesazhin, problemet dhe aktivitetet e ORrMN e grupeve të interesit, politikëbërësve dhe ligjzbatuesve. Për këto duhet të përdorni internetin, Facebook-un, videot në YouTube, blogjet e shkruara dhe Twitter-in; postoni fotografi të ngjarjeve të organizuara në Instagram për të tërhequr vëmendje, etj.

Përfshirja e zyrtarëve për informim në konferencat për shtyp, për të siguruar mbulueshmëri më të madhe nga ana e tyre është më tërheqëse dhe përbën një lajm për median.

### ***10. Çfarë do t'ju nevojitet për t'u përgatitur për një konferencë të suksesshme për media?***

Konferenca për media është mjet efikas për të gjeneruar lajme dhe publicitet për një organizatë ose ngjarje. Për shëmbull, disa organizata të MShC-ve apo grupime të tyre, sipas problematikës, kanë organizuar konferenca për media në



rastet e ndërtimit të HEC-ve, me moton “Të mbrojmë lumenjtë”, “Zemra Blu e Evropës”, “Mos Ma Prek Valbonën” etj.; për keqtrajtimit dhe përndjekjen e llojeve të faunës së egër, me moton “Të shpëtojmë Arinjët Shqiptar”; në rastet e diskutimit të planeve vendore dhe të procesit të hartimit të VSM e VNM; përndërhyrjet dhe veprimet e pastudjuar e të kundër ligjshme në ZMM dhe zonat e ndjeshme mjedisore, ligatinore apo/dhe me status ndërkombëtar si në “Vjosë-Nartë”, Parkun Kombëtar “Divjakë-Karavasta”, PN “Korab-Korritnik”, PK “Shebenik-Jabllanicë” etj.

### ***11. Gjërat që duhen mbajtur mend kur përgatitesh për konferencë për media:***

- Përkufizo porosinë që dëshiron t’ a përçosh. Tri deri në pesë argumente të qarta.
- Cakto datën dhe kohën e konferencës për media. Mundohu që t’i shmangesh mbajtjes së konferencës për media në kohë të njëjtë me ngjarje të tjera.
- Përcakto një vend të përshtatshëm që ka lidhje me problematiken e organizatës.
- Bashkërendo me pjesëmarrësit. Mos harro, rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre.
- Kontakto mediat në kohë dhe parapërgatit njoftimin për to për mesazhin dhe informimin që do t’i përcillet publikut.
- Kontakto mediat dhe sigurohu se ato do marrin pjesë në konferencë, duke iu dërguar paraprakisht një material informativ, fotografi, komunikatë etj, për publikim.

### ***12. Çfarë duhet të përfshihet në komunikatën për media?***

Kur komunikoni me publikun, me anë të një deklaratë për shtyp, duhet që të përfshini elementet si mëposhtë:

- Emrin dhe logon e organizatës apo grupimit
- Një përshkrim të shkurtër të organizatës/grupimit (një deklaratë të shkurtë të misionit në fund të dokumentit)
- Datën
- Titullin që pasqyron mesazhin kryesor
- Informatat e kontaktit të ekspertëve për informacione shtesë
- Një paragraf kryesor që sqaron problemin dhe jep informacionet kryesore
- Një paragraf që sqaron sfondin dhe jep kontekstin e problemit
- Të paktën një citim nga ndonjë ekspert i fushës
- Zgjidhjen e sugjeruar dhe një thirrje për veprim



### *13. Vënien në dispozicion të numrave falas për të denoncuar.*

- Kur grupet e interesit paraqesin publikisht problematikat dhe ndikimet negative në procesin e mirëqeverisjes dhe të përdorimit të rrjetit të ZMM dhe të burimeve natyrore.
- Kur grupet e interesit denoncojnë me fakte shkeljen dhe mos zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e ruajtjes së natyrës dhe të biodiversitetit.
- Kur grupet e interesit paraqesin rekomandime për përmirësimin e situatës.

### **5.3 KUJT DUHET T'U DREJTOHET/ADRESOHET PROBLEMATIKAT PËR ZMM DHE BURIMET NATYRORE?**

- ➔ Kuvendit dhe Komisioneve përkatëse.
- ➔ Qeverisë dhe Ministrive.
- ➔ Avokatit të Popullit.
- ➔ Prokurorisë dhe Gjykatës.
- ➔ Institucionit të Prefektit.
- ➔ Kryetarit dhe Këshillit të Qarkut.
- ➔ Kryetarit dhe Këshillit Bashkiak.
- ➔ Agjencive monitoruese dhe ligjzbatuese.
- ➔ Parlamentit Evropian.
- ➔ Trupit Diplomatik, OSBE-s.
- ➔ Organizmave ndërkombëtare jo qeveritare.
- ➔ Forumeve ndërkombëtare në lidhje me mjedisin dhe natyrën.
- ➔ Sekretariateve të Konventave, ku Shqipëria është palë nënshkruese.
- ➔ Bankave të vendit dhe ndërkombëtare.
- ➔ Medias.

### **5.4 EFEKTI MBIMËNYRAT E PËRDORURA PËR INFORMIM, ADRESIM DHE REAGIM**

Vlerësimi e efektit mbi mënyrat e përdorura për informim, adresim dhe reagim është ndikimi i tij tek pjesëmarrësit dhe lidhet me gjurmimin e shkaqeve dhe rezultatete programitë komunikimit, informimit, advokimit dhe të pjesëmarrjes publike.

Vlerësimi i ndikimit mund të jetë i vlefshëm, nëse adreson çështjen që prekin drejtpërsëdrejti pjesëmarrësit, si në rastet endikimeve negative në ZMM apo dhe të përdorimit jotë qëndrueshëm e jo të suksesshëm të burimeve dhe të peizazhit natyror. Në këto raste lind nevoja për adresim dhe reagim publik.



## Për se nevoja për adresim dhe reagim?

Siç dihet, thuajse të gjithë programet apo projektet, mbështeten dhe nisen nga ajo që quhet “nevojë” për ndryshim, përmirësim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Duhet bërë kujdes në sensin kur ato nisin të komplikohen dhe kur duhet të thellohem në përcaktimin e disa elementeve që strukturojnë nevojat, si p.sh.kush është:

- *Individi, grupi i interesit dhe organizata që e shpreh nevojën?*
- *Grupi që e prezanton nevojën?*
- *Kundër kërkesës për plotësimin e nevojave?*
- *Raporti midis atyre që e raportojnë dhe atyre që nuk e raportojnë nevojën?*
- *Dimensionimi personal kundrejt atij kolektiv i nevojës?*
- *Ku gjendet ekuilibri midis këtyre dimensioneve?*
- *Koncepti i zhvillimit dhe mirëqenies që tentohet të arrihet?*

## Ç'farë duhet të përmbajë një strukturë vlerësimi?

- *Cila është natyra dhe qëllimi i problemit?*
- *Ku shtrihet, kush preket dhe si problemi atakon njerëzit?*
- *Cilat çështje/t që lidhen me problemin justifikojnë programet, zgjerimin apo modifikimin e programeve zhvillimore?*
- *Ç'farë ndërhyrjesh mendohet se do të krijojnë reduktimin e problemit?*
- *Cili është targeti i përshtatshëm në program?*
- *A ka ndonjë ndëryrje specifike që prek targetin?*
- *A është zbatuar drejt programi?*
- *A ka përputhje të rezultateve me objektivat?*
- *A janë dispozitat ligjore të zbatuara mirë?*
- *A janë krijuar struktura dhe shërbimet të mirëplanifikuara?*
- *A është ndërhyrja e duhur për të arritur qëllimet dhe përfitimet e pritshme?*
- *A është programi në një marrëdhënie racionale kosto përfitim?*



## 6. PRAKTIKAT MË TË MIRA TË KOMUNIKIMIT, ADVOKIMIT, LOBIMIT DHE PJESËMARRJES PUBLIKE – NË SHQIPËRI

### MËNYRAT E VEPRIMIT

Bazuar në përvojën e deritashme të INCA-s mbi grupet e synuara, të burimeve dhe mjeteve të cilat i disponon, qartësia për komunikim, informim, advokim dhe përshtatshmërinë e tyre drejt objektivave të përcaktuara; të tërësisë së dëgjuesve dhe mesazhin që duhet përcjellë, duke përdorur instrumentet për një komunikim të drejtpërdrejt apo/dhe të tërthortë, ndër të tjera, ka synuar dhe realizuar ngritjen e forumit lokal mjedisor, në të gjitha ZMM e marra në studim, si një praktikë e suksesshme.

#### 1. Përvoja përse duhet kryer identifikimi dhe vlerësimi i faktorëve kërcënues në ZMM. #Rasti ORrMN

Në strategjinë e hartuar për Rrjetin e Mbrojtjes së Natyrës synohet një përjasjen strategjike në adresimin afatgjatë të problematikës dhe të nevojave të rrjetit; ngritja dhe zhvillimi i një sistemi për identifikimin e problematikave kryesore me të cilat përballen 16 Zona të Mbrojtura Mjedisore (ZMM) të përzgjedhura.

Nëpërmjet projektit u synua aplikimi i një procesi vlerësimi për grumbullimin e informacionit faktik dhe real mbi të gjitha aktivitetet me impakt negativ brenda territorit në zonat e mbrojtura të përzgjedhura, duke përdorur metodologjinë e pyetësorëve individual, takimet dhe bashkëbisedimet me komunitetin, palët e tjera të interesuara për përdorimin e burimeve natyrore dhe mirëmenaxhimin e ZMM si dhe mjaft dokumente, programe, raporte, plane menaxhimi etj, në lidhje me këtë fushë.

Gjithashtu, nga INCA dhe organizatat e RrMN u mundësua vlerësimi i nevojave për një bashkëpunimi sa më efektiv, mes shoqërisë civile, strukturave ligjzbatues të fushës së natyrës, në nivel qendror, si Ministria e Turizimit dhe Mjedisit (MTM) dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), dhe në nivel lokal, Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdRZM) dhe pushteti vendor, duke nxitur partneritetin mes tyre në iniciativa dhe aktivitete të përbashkëta, që kanë për qëllim adresimin dhe minimizimin e problemeve negative.

Fokusi kryesor i këtij procesi ishte ngritja e kapaciteteve të përfaqësuesve të ORrMN, të Administratave të ZM dhe të OJF-ve lokale të pranishme në ZM-të e përzgjedhura dhe pjesëmarrëse në lidhje me njohjen dhe interpretimin e dispozitave e të akteve nënligjore në fuqi, për ruajtjen e natyrës; kryerjen e



procesit të vlerësimit të aktiviteve me impakt negativ brenda territorit në zonat e mbrojtura mjedisore dhe për njohjen, plotësimin dhe interpretimin e të dhënave të grumbulluara nga pyetësi individual, bazuar në metodikën përkatëse.

Në këtë kuadër INCA organizoi 3 seminare në Librazhd, Shkodër dhe Gjirokastrë, ku u tajnuan rreth 340 pjesëmarrës nga organizatat pjesë e RrMN dhe OJF-t mjedisore të përzgjedhura, stafi i AdZM dhe i bashkive. Me kontribut të INCA u prodhuan dhe u shpërndan broshurat: “Legjislacioni bazë dhe mbështetës mjedisore për menaxhimin e zonave të mbrojtura” dhe “Vlerësimi i gjendjes së problematikave mjedisore dhe të zonave të mbrojtura në Shqipëri” (materiale për përdorim të brendshëm të ORrMN).

Në fazën e parë të zbatimit të projektit u punua për krijimin e një ekspertize për të përmbushur qëllimin kryesor dhe objektivat specifike të projektit. Nëpërmjet bashkëbisedimeve me palët e interesuara dhe me aplikimin e një metodologjie (pyetësor-individual) efektive, u identifikuan dhe u trajtuan, në përgjithësi dhe veçanti, mangësitë kryesore të zonave të mbrojtura mjedisore të marra në studim.

Me këtë vlerësim, më pas dhe analizimin e problemeve të shkaktuara, krahas adresimit, u synua që të arrihej qëllimi për tërheqjen e vëmendjes publike drejt problematikave kryesore me të cilat përballen sot zonat e mbrojtura mjedisore, rritjen e reagimit ndaj tyre dhe caktimin e rekomandimeve përkatëse për minimizimin e impakteve negative.

Gjatë këtij procesi vlerësim-analizimi u punua për ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi për identifikimin e problematikave kryesore të zonave të mbrojtura në rajonet pilote të përzgjedhura: Tiranë (*Tiranë, Dibër*), Vlorë (*Vlorë*), Gjirokastrë (*Përmet, Dropull*), Korçë (*Korçë, Pustec*), Mat (*Ulëz*), Durrës (*Krujë*), Kukës (*Kukës, Tropojë*), Shkodër (*Shkodër, Malësia e Madhe*), Elbasan (*Librazhd*) dhe Fier (*Divjakë*), ka qënë ndër aktivitetet kryesore të RrMN.

INCA hartoj dhe drejtoj zbatimin e një metodologjie (pyetësor) efektive, për realizimin e identifikimit, vlerësimit, analizimit dhe të hartografimit të impakteve negative në ZMM e marra në studim, nëpërmjet anketimit individual si mjet efektiv për të arritur tek qytetarët dhe/apo banorët që jetojnë në afërsi të ZMM. Metodologjia bazohet kryesisht në proceset e dialogut, konsultimit dhe bashkëbisedimit me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit, nëpërmjet edhe plotësimittë pyetësorit-individual, për të identifikuar problematikën në vlerësimin dhe menaxhimin ZMM.

Metodologjia merr në konsideratë procesin e grumbullimit dhe analizimit të fakteve të mbledhura dhe tërheqjen e vëmendjes publike drejt problematikave





kryesore me të cilat përballen zonat e mbrojtura mjedisore. Metodologjia është një gërshetim procesesh dhe disiplinash që synuan identifikimin e gjendjes në ZMM. Ajo u zbatua mbi bazën e organizimit të takimeve e të shpërndarjes së informacionit me publikun në tërësi dhe me grupet e interesit në veçanti, të cilët kanë akses të drejtëpërdrejt në përmirësimin e statusit të menaxhimit dhe të përdorimit të burimeve natyrore të ZMM.

Zbatimi i metodologjise u shoqërua edhe me ngritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të ORrMN, të AdRZM dhe të OJF të pranishme në ZMM e përzgjedhura dhe pjesëmarrëse për njohjen dhe interpretimin e dispozitave dhe të akteve nënligjore në fuqi, për ruajtjen e natyrës si dhe kryerjen e procesit të vlerësimit. Për këtë qëllim INCA organizoj tre trajnime në Kukës, Vlorë dhe Prespë për “Metodologjinë e identifikimit të problematikave kryesore të administrimit të ZMM, perceptimi i rolit të ORrMN dhe bashkëbisedimi në publik si dhe plotësimin e pyetësorit individual”.

Në këto trajnime morrën pjesë 47 përfaqësues të ORrMN dhe të OJF-ve, të cilët do të kryenin plotësimin e pyetësorëve. Njëherazi, në secilën ZMM të përzgjedhur, ORrMN organizuan disa takime me grupet e interesit në lidhje me identifikimin e problematikave të administrimit të ZMM.

Vlerësimi i situatës aktuale ishte rezultat i takimeve dhe i investigimeve në terren të organizuara me përfaqësues komuniteteve, kryepleqtë, administratorët e njësive administrative, të bizneseve, shkollat, OJF-ve mjedisore, administratat vendore dhe të AdRZM, etj. Nëpërmjet këtyre takimeve u siguroi një pamje të përgjithshme të problemeve ekzistuese dhe potenciale në zonën e mbrojtur, të cilat kanë ndikim në biodiversitetin, ekosistemet, peizazhet, burimet natyrore dhe në zhvillimin vendor social-ekonomik.

Gjatë gjithë procesit të zbatimit të projektit morrën pjesë rreth 294 persona. Vetë INCA organizoj nga katër takime bashkëbisedimi në parkun kombëtar “Divjakë-Karavasta”, në zonat Karavasta-Remas, Kryekuq-Mizë, Sulzotaj-Divjakë dhe një takim përmbyllës në Divjakë. Në parkun kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”, të tilla takime u organizuan në zonat Fushë Stude, Dorrës, Rrajcë dhe një takim përmbyllës, ku u prezantuan rezultatet në Librazhd. Në këto takime morrën pjesë mbi 140 persona nga grupet e interesit, AdRZM, bashkive, etj.

Ndërsa identifikimi dhe vlerësimi i faktorëve dëmtes dhe të kërcënimeve për biodiversitetin dhe ruajtjen e 16 ZMM të marra në studim, u krye në bashkëpunim të ngushtë dhe me kontributin e INCA, të 7 OMSHC dhe të 25 OJF mjedisore lokale, përfshirë stafine AdRZM dhe bashkive, duke ndërmarrë një numër të gjerë takimesh konsultative, për grumbullimin, vlerësimin dhe



analizimin e materialeve të ndryshme, në lidhje me impakteve negative në ZMM e përzjedhura.

Proceset e dialogut dhe të konsultimit me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit, nëpërmjet bashkëbisedimeve dhe plotësimin e pyetësorit individual, ishte baza kryesore për të identifikuar problematikën, vlerësimin dhe menaxhimin ZMM; si dhe për të mbledhur të dhëna mbi nivelin aktual në bashkëpunim me komunitetet lokale, OJF-t mjedisore, palë e tjera të interesuara në zonave të mbrojtura të përzjedhura. Në formën më të thjeshtë, vlerësimi i mangësive është i nevojshëm pasi identifikon shkallën në të cilën sistemi i ZMM plotëson objektivat e caktuara të ruajtjes dhe të mirëqeverisjes së tyre.

Interpretimi i të dhënave të parashikuan tek pyetësi, kryesisht, u lidhen me fushat: Informacionin bazë rreth ZM dhe vlerat e saj; Planifikimi dhe menaxhimi i ZMM; Vendimmarrja dhe ndikimi në të; Komunikimet dhe vepritaritë ndërgjegjëse, edukuese dhe promovuese; Vepritaritë dhe zhvillimi ekonomik e social.

Për secilën ZMM të përzjedhur u përdoruan rreth 100 pyetësor (gjithsejt 1600 për 16 ZMM e studiuara) nga organizatat e RrMN dhe OJF-t e partnere. Plotësimi i pyetësorit u bë duke marrë në konsideratë palët e interesuara dhe grupet e tjera që kryejnë veprimtari në territorin e ZMM apo dhe në zonat në afërsi të saj dhe që kanë ndikime mbi ZMM.

Kështu që vlerësimi i situatës aktuale dhe rezultat e siguruaraishin si rrjedhojë e investigimeve në terren, sëbashku me përfaqësues komuniteteve, banorët, kryetarët e fshatrave, administratorët e njësive vendore, të bizneseve, gratë, të rinjtë dhe shkollat, OJF-ve mjedisore, blegtorët, peshkatarët, operatorët turistik të zonës, medias, administratat vendore dhe të AdRZM, etj. Nëpërmjet këtyre takimeve u siguroa një pamje e përgjithshme të problemeve ekzistuese dhe potenciale në ZMM, të cilat kanë ndikim në biodiversitet, ekosisteme, peizazhe, burimet natyrore dhe në zhvillimin vendor social-ekonomik, por ndërkohë shërbyen edhe si vetëndërgjegjësim për komunitetin.

Një analizë e mirë mangësish duhet të nënvizojë prioritetet që duhen adresuar dhe sugjerime për veprimet e nevojshme. Identifikimi i prioritetëve nënkupton ndërmarrjen e disa hapave të ndryshëm vlerësimi. INCA dhe secila organizatë e RrMN hartuan edhe listat e impakteve negative të ZMM të marra në studim. INCA me drejtuesit e ORrMN organizoj një seminar me ekspertin e GIS, për hartëzimin e impakteve negative, sipas listave të parapërgatitura, duke prodhuar harta dixhitale për 16 ZMM e përzjedhura në shkallë vendi.

Hartografimi i presioneve dhe kërcënimeve ndaj zonave të mbrojtura ekzistuese dhe ekosistemeve të pambrojtura, njëherazi shërben për të



identifikuar veprimet emergjente që duhen marrë për kërcënimet ndaj sistemit të zonave të mbrojtura të vendit.

Përpunimi i të dhënave të nxjerra nga pyetësorët tregoi se cilat janë sfidat dhe problemet me të cilat duhet të përballen në mënyrë që të kenë një zhvillim të denjë ekonomik, social dhe kulturor. Megjithëse problematikat dhe vështirësitë janë shumë shqetësuese për ZMM, vetë komunitetet duan të bëjnë përpjekje për t'u zhvilluar e ruajtur ZMM dhe për të siguruar të ardhura dhe rritur ekonomikisht.

Identifikimi i mangësive është një vlerësim i shkallës në të cilën një sistem i zonave të mbrojtura plotëson objektivat e ruajtjes të caktuara për të përfaqësuar diversitetin biologjik të tij. Përmirësimi i menaxhimit duhet të përfshijë të gjithë komponentët e zonave të mbrojtura, duke përfshirë grumbullimin e fondeve, aktivitetet ekonomike, planifikimin dhe menaxhimin e bizneseve, përfshirjen e aktorëve të interesuar.

Në këtë kuadër mjaft i rëndësishëm ishte sigurimi i njohurive dhe i aftësive të nevojshme për stafet e zonave të mbrojtura, përgatitja e programeve të trajnimit për këtë qëllim, nëpërmjet aktiviteteve të kryera me ta. Përfshirja më e madhe e aktorëve të tjerë, veçanërisht komuniteteve lokale dhe përmirësimi i kapaciteteve të tyre për të kontribuar në menaxhimin e zonave të mbrojtura është një tjetër drejtim i rëndësishëm i programit të punës për AKZM dhe AdRZM.

Krahas adresimit u synua që të arrihej qëllimi për reagimin ndaj tyre si dhe caktimin e rekomandimeve përkatëse për minimizimin e impakteve negative. Aplikimi i procesit të vlerësimi për grumbullimin e informacionit faktik dhe real mbi të gjitha aktivitetet me impakt negativ brenda territorit në zonat pilote të mbrojtura të përzgjedhura solli rezultate pozitive.

Analiza e impakteve negative në ZMM e përzgjedhura nënvizojë prioritetet që duhen adresuar dhe sugjerimet për veprimet e nevojshme nga ana e ORrMN, OJF-ve lokale, komuniteti dhe organet përgjegjëse shtetërore në nivel qendror dhe lokal. Të gjitha impaktet e identifikuara janë shqetësime të banorëve dhe të përdoruesve të burimeve natyrore, të administratave përkatëse, të cilët kanë marrë pjesë aktive në hartimin dhe miratimin e listës së impakteve negative në ZMM.

## 2. Përse u synua krijimi i forumit lokal mjedisor? #Rasti ORrMN

Forumit lokal mjedisor u synuar për të krijuar rrjetin e këshilltarëve lokal, për njëqasje më të mirë të ruajtjes së natyrës, përmirësimin e menaxhimit të ZMM dhe të mirëpërdorimit të burimeve natyrore; për identifikimin e mangësive dhe të ndikimeve negative, të informimit të publikut si dhe të rritjes së reagimit të



tyre ndaj strukturave shtetërore, qendrore e lokale, përgjegjëse për gjëndjen e krijuar.

FoLM do të shërbejë si një strukturë lokale profesionale e gatshme për të marrë pjesë në proceset advokuese dhe këshilluese pranë strukturave vendore përgjegjëse për ruajtjen e natyrës dhe menaxhimin e burimeve natyrore.

Secila prej organizatave të RrMN nxiti krijimin e forumeve mjedisore lokal, në nivel qarku, i cili do të vijojë procesin e advokimit për çështjet e ruajtjes së vlerave dhe burimeve natyrore dhe adresimin e problemeve dhe të impakteve negative që prekin ZMM.

Krijimi i forumeve lokale mundëson:

- Uljen në një tryezë të të gjithë palëve të interesuara dhe që kanë interes në ZMM.
- Për të diskutuar çështjet që lidhen me mjedisin dhe burimet natyrore për zonën.
- Adresimin e problematikave dhe të nevojave më mirë, të drejtpërdrejt dhe në mënyrë të rregullt formale.

Krijimi i këtyre formumeve u bazua tek “**Modeli dhe procedura e krijimit dhe të funksionimit të forumit lokal mjedisor**” i hartuar dhe i prezantuar nga INCA, në një seminar me drejtuesit dhe stafin e organizatave të RrMN dhe OJF-t lokale partnere.

### 2.1 Ç’farë arrihet me ngritjen e forumit lokal mjedisor?

- Të inkurajohen dhe të nxiten pjesëmarrësit e OJF-ve, grupimeve qytetare dhe të këshilltarëve local për procesin e advokim/reagimit, në lidhje me çështjet e ruajtjes së natyrës dhe përdorimin burimeve natyrore;
- forcimi i njohurive mbi zbatimin e metodologjisë për analizimin e situatës aktuale, të rolit pjesëmarrës dhe advokues/reagues përmes e sondazheve dhe intervistave;
- informimin dhe ndërgjegjësimin e anëtarëve të forumit mbi problematikat e vërejtura dhe formulimin e rekomandimeve për zgjidhjen e tyre, bazuar në legjislacionin e fuqi;
- forcimin dhe bashkëpunim me strukturat lokale të OJF-ve të tjera, duke punuar për fuqizimin e rolit të shoqërisë civile në advokim/reagim dhe rekomandimet mbi zgjidhjen e problematikave të identifikuara;
- rritjen e numrit të takimeve informuese dhe advokuese me aktorët lokal (AKZM, AdRZM, Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Bashkitë dhe Njësitë Administrative). Po ashtu edhe grupe të interesit, komunitetet lokale, përdorues të burimeve natyrore, bizneset, etj;



- forcim të rolit informues dhe mbështetës me ekspertizë teknike të pjesëmarrësve të forumit dhe anëtarëve të RrjMN, informimi i tyre mbi gjetjet, vlerësimet, advokim/reagimin dhe mbi rekomandimet për minimizimin e ndikimeve negative;
- realizimi i sondazheve dhe anketimeve me grupet kryesore të interesit, në nivel lokal, për të analizuar dhe vlerësuar situatën faktike, të pjesëmarrjes së tyre në vendimarrjen lokale, me fokus përdorimin e burimeve natyrore në ZMM të marra në konsideratë;
- takime konsultuese/debatuese me bordet e mjedisit dhe drejtoritë e mjedisit pranë bashkive për të ndarë me ta informacionet dhe rekomandimet përkatëse, në funksion të përmirësimit të procesit të vendimarrjes;
- monitorimine pjesëmarrjes publike dhe të përfshirjes së OJF-ve nëprocein e vendimarrjes apo në mbledhjet e këshillave bashkiak.

## 2.2 Struktura dhe funksionimi i forumit lokal mjedisor

*Cilët duhet të jenë bashkëpunëtorët kryesorë të forumeve lokale mjedisore?*

- *Qeverisja qendrore*, ministrinë që lidhen me shërbimet e ZMM, agjencitë kombëtare dhe inspektoratet, komitetet e menaxhimit të ZM;
- *Qeverisja vendore*, institucioni i prefektit, qarku, bashkitë;
- *Organizatrat dhe shoqatat joqeveritare*, strukturat shtetërore sipas përkatësisë në nivel lokal, dhe OJF-të për mbrojtjen e natyrës, grupime të ndryshme shoqërore, etj;
- *Përdoruesit lokalë*, pronarë të tokave, operatorë turistikë, biznese të vogla që përdorin burimet e ZM, etj.;
- *Komuniteti shkencor/akademik*, kryesisht universitetet apo/dhe punonjësit shkencor publik dhe privat;
- *Qytetarët*.

*Si duhet të funksionojë një forum lokal mjedisor?*

Forumi lokal mjedisor duhet të përbëhet nga anëtar vullnetar që janë shprehur për të qenë pjesë e tij, nga bordi prej 5 vetë (i zgjedhur nga anëtarët vullnetar) si dhe nga kryetari dhe sekretari (të cilët përcaktohen nga bordi).

Është e këshillueshme që kryetari i bordit të jetë një personalitet lokal i njohur dhe me reputacion në zonën ku do të funksionojë ky forum.

Pas krijimit të forumit bordi harton rregulloren e funksionimit dhe detyrat që duhet të ndjekë forumi. Rregullorjaduhet të miratohet në mbledhjen e përgjithshme të anëtarëve vullnetar të forumit.



Rregullorja duhet të përcaktojë drejtimet kryesore të funksionimit të kësaj strukture, bazuar mbi qëllimin dhe problematikat që do ndjek ky forum, sipas përmbatjes së më poshtme:

- Qëllimi dhe objektivat e forumit.
- Strukturat përgjegjëse të forumit.
- Detyrate bordit, kryetarit, sekretarit dhe të anëtarëve të tjerë të bordit.
- Mënyrën e organizimit, kohën dhe vendin e mbledhjeve të bordit e të krejt anëtarëve vullnetarë të forumit.
- Kryetari dhe sekretari përgatit dhe u shpërndan anëtarëve të forumit axhendën e mbledhjeve.
- Forumi nuk ndjek problematikat politike lokale dhe kombëtare.
- Forumi ka detyrë informimin dhe ndërgjegjësimin e anëtarëve mbi problematikat e vërejtura në menaxhimin e ZMM dhe formulimin e rekomandimeve për zgjidhjen e tyre.
- Forumi kryen monitorimin e pjesëmarrjes publike dhe të përfshirjes së OJF-ve në mbledhjet e këshillave bashkiak apo dhe të strukturave të tjera shtetërore në nivel lokal.
- Anëtarësimi në forum bëhet vullnetarisht dhe sipas procedurave të miratuar nga bordi i forumit.
- Anëtarët e forumit duhet të marrin pjesë në mbledhjet dhe konferencat e forumit.
- Anëtarësia në forum përfundon me dorëheqjen me shkrim nga anëtari.
- Kryetari, në emër të forumit, harton dhe u dërgon institucioneve publike e private apo dhe subjekteve të ndryshëm, kërkesa për informim, në lidhje me problematikën e ruajtjes, promovimit dhe adresimit të menaxhimit të qëndrueshëm të ZMM dhe mbi përdorimin e burimeve natyrore, bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tyre.
- Sekretari administron dhe bën publik vendimet e marra dhe procesvebalet përkatëse.
- Përgatitja e raporteve mujore e vjetor dhe kujt i adresohen.
- Planin vjetor të aktiviteteve të forumit lokal mjedisor.

### 3. Ndërmarja e veprimeve konkrete dhe të rritjes së përgjegjësisë për mbrojtjen e natyrës dhe të peizazhit. #Rasti i HEC-ve

Shoqëria civile dhe organizatat jo fitimprurëse prej kohësh kanë ngritur zërin për të mbrojtur dhe shfrytëzuar në mënyrë të qëndrueshme burimet ujore të vendit dhe kryesisht ato të lumenjve. Jemi dëshmitar të një sulmi të pa precedent që i është bërë rrjetit hidrik të vendit, ku janë dhënë mbi 500 leje shfrytëzimi për ndërtimin e hidrocentraleve me një përfitim tepër minimal energjistik në raport me demin mjedisor që ato shkatojnë.



Dokumentacioni dhe procedurat e ndjekura për “Vlerësimin e ndikimit në mjedis” në shumicën e rasteve nuk përkojnë me standartet ligjore dhe ato të Bashkimit Evropian, aq me tepër kjo në rastin e burimeve ujore me kontekst ndërkuftar. Efektet e para negative të vërejtura (mangesia e ujit, turbullira e shkaktuar, erozioni tokësor, dëmtimet e faunës, etj) dhe reagimet e komuniteteve lokale janë dëshmitë e para të pasojave të pritshme që do të kenë shpejt pasoja shumë herë më të rënda në mjedis dhe në mirëqënien e popullatave që jetojnë në këto basene.

Përprojekjet e organizatave MShC-ve janë përqëndruar në informimin e komuniteteve lokale dhe organeve vendore mbi vlerat dhe risqet potenciale të ndërtimit të hidrocentraleve, duke publikuar udhëzues për investitorët dhe institucionet shtetërore, duke kryer studime me karakter lokal e kombëtar, zbatuar miniprojekte për ndërgjegjësimin e komuniteteve lokale, por edhe duke kërkuar në forma dhe mënyra të ndryshme reagimin e organeve shtetërore.

OMShC-të u mbështeten në këtë përpjekje rajonale edhe nga Fondi Botëror për Jetën e Egër (WWF), por edhe nga organizatat e tjera të vendit, veçanërisht të grupimit #“Të Mbrojmë Lumenjtë” i përbërë nga: INCA, REC, PPNEA, EDEN, Ekolëvizja, EkoAlbania, Mileukontakt, Shoqata e Bujqësisë Organike, ILIRIA, Qendra për Rregullimin dhe Ruajtjen e Energjisë në Shqipëri, Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit, Instituti i Politikave Mjedisore, Lex Ferenda, Shoqata Toka (Valbonë), etj, etj.

## **Ç'farë është bërë në këtë drejtim?**

### **1. Konferenca për shtyp.**

Janë organizuar disa konferenca të tilla në lidhje me HEC. Në kuadër të nismës për ndalimin e dhënies së lejeve për koncesione për HEC-e në territorin e Shqipërisë, grupimi “Të mbrojmë lumenjtë”, më datë 16.07.2015, organizoj një konferencë për shtyp për të realizuar mbrojtjen dhe menaxhimin me kriteret pro mjedisore dhe zhvillimit të qëndrueshëm ndërmori nismën për t'i kërkuar moratorium, lidhur me ndalimin e ndërtimit të veprave energjetike në lumenjtë e Shqipërisë, për një periudhë 3 vjeçare.

Moratoriumi kërkohet para së gjithash për ndalimin e dhënies së licencave për koncesione për HEC-t në të gjithë territorin e vendit. Ky moratorium do të shërbejë për të analizuar situatën aktuale të koncesioneve dhe kushteve të zbatimit të tyre në përputhje me kërkesat ligjore të zhvillimit të territorit si dhe kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor.

Kjo nismë do të shërbejë në përmirësimin e kuadrit ligjor, zbatimit të praktikave të mira për koncesionet dhe ruajtjen e mjedisit, si dhe për integrimin e konventave dhe direktivave evropiane në dokumentet strategjike



kombëtare, sikurse janë Strategjia Kombëtare e Ujit, Strategjia Kombëtare e Energjisë, Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe Planet Kombëtare Sektoriale, zbatimi i ligjit për menaxhimin e integruar të burimeve ujore që është përafrim i direktivës kuadër të ujit të KE, etj., dokumente të cilat janë tashmë në fazat e zhvillimit të tyre.

Në mënyrë më specifike gjatë periudhës së moratoriumit do nevojitet të rishikohen, pezullohen dhe anulohen të gjitha licencat e dhëna deri më sot në zonat e mbrojtura dhe zonat sensitive lumore me potenciale të larta natyrore me prani të monumenteve natyrore në to. Rishikimi i veprave hidrike mbi lumenjtë Vjosë, Drin, Shkumbin, Devoll, Valbonë, Lumë, Mat, Osum, Cem, Rapun, Fan, etj, të cilët janë një prioritet i qeverisë, duhet bërë sa më parë dhe i mbështetur në studime të thelluara shkencore dhe social-ekonomike. Ka ende koncesione që janë dhënë dhe nuk janë vënë në zbatim dhe që ndikojnë në zonat e mbrojtura natyrore si në Valbonë, Theth, Lurë, Shebenik-Jabllanicë, Korab-Korritnik, Maline Tomorrit, Bredhi i Hotovës-Dangëlli, Mali me Gropa-Bizë-Martanesh, etj.

## 2. Takime në Parlament, me deputetë dhe në komisione.

Me kërkesë të grupimit janë bërë disa takime në parlament për problemet e HEC-ve. Kryetari i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin si dhe deputeti z.Baraj e kanë ngritur këtë problem dhe në një seancë parlamentare, duke theksuar dhe inkurajuar ministritë përgjegjëse të linjës, për ndërprerjen e ndërtimit të HEC-ve në zonat e mbrojtura, jashtëzakonisht të rëndësishme për nga vlera natyrore. Nuk duhet t'i lejojmë këto hidrocentrale, që janë në konflikt të hapur me ligjet, pa folur dhe për interesat e Shqiptarëve, pasi fatkeqësisht shpesh ato janë neglizhuar edhe për arsyet se nuk është pyetur komuniteti dhe pushteti lokal; nuk është marrë parasysh efekti kumulativ i tyre, gjë që rekomandohet qartë nga forumet ndërkombëtare për këtë sektor, por dhe nga ligji i sotëm shqiptar që e parasheh këtë element.

Ministritë përgjegjëse nuk sjellin argumente bindëse pse duhen bërë këto vepra, që më shumë sjellin dëm për vendin, se sa dobi për zhvillimin ekonomik në tërësi.

Ekspertët ndërkombëtarë vlerësojnë se është më mirë të ndërtohet një hidrocentral i madh, se të ndërtohen një shumicë hidrocentralesh të vegjël, pasi këta të fundit kanë efekt kumulativ, duke dëmtuar mjedisin më shumë se një i vetëm.

Takimi në Komision u krye (Maj 2016) me theks HEC-et. Në takim ishin pjesëmarrës përfaqësues nga UNDP, OSBE, REC, AKZM, si dhe të grupimit #“Të mbrojmë lumenjtë”. Qëllimi i takimit ishte të ftoheshin dhe të bisedonin





të gjithë bashkarisht për të koordinuar punën dhe mundësitë në programet aktuale.

- U ritheksua nevoja e hartimit të një studimi të pavarur që të tregojë sa është dëmi apo fitimi ekonomik në rast të ndërtimit të HEC-eve dhe nevoja për një ekspertizë të mirëfilltë, ndërkombëtare dhe të garantuar. Me secilin nga aktorët e ftuar në takim janë zhvilluar biseda paraprake për gjetjen e një mundësie financimi të studimit.

- Hartimi i një studimi/VNM alternative, argumentimi me fakte dhe studime konkrete lehtëson mënyrën e hapjes së debatit për ndryshime ligjore apo institucionale në shërbim të vlerësimit korrekt të situatave dhe marrjes së drejtë të vendimeve. Të fillohet me Valbonën jo vetëm se është një temë e nxehtë dhe dëshirë/prioritet nga grupi parlamentar, por për t'a kthyer në një model dhe në të njëjtën kohë si test për komisionin parlamentar.

- Grupi parlamentar synon të ndërtojë një partneritet serioz me të ftuarit e tryezës, që ndonëse në numër më të pakët se herët e tjera, nga ana cilësore diskutimi qëndron më lart. Kjo me arsyen që të rritet e të ketë argumentime cilësore dhe si një zë ekspertize që të ndryshojë rrjedhën e vendimeve në të ardhmen.

Nga përfaqësuesit e grupimit #“Të mbrojmë lumenjtë” u ritheksua kërkesa për moratorium dhe hartimin e një masterplani për zhvillimin energjetik në vend si hapa të parë e mjaft të rëndësishëm për krijuar një pamje të qartë të asaj çfarë do të ndodh në të ardhmen, ose të paktën të shkohet për një pezullim të ndërtimeve duke filluar në Valbonë, pasi ka fakte të thyerjes së ligjit dhe kështu të fitohet koha për hartimin e studimit pa dëmtuar më tej zonën.

Gjithashtu, u rekomandua që të ndërmerret një iniciativë nga Grupi Parlamentar, së bashku me Ministrinë e Energjetikës për HEC-et, për të:

- Zhvilluar një monitorim dhe skanim të HEC-ve, atyre që nuk kanë filluar nga puna (rreth 60% e tyre), që u kanë skaduar lejet apo VNM nuk janë të sakta, që të mund të pezullohen. Duhet vetëm vullnet politik që situata të përmirësohet.
- Marrja në konsideratë e komenteve të ekspertëve për amendim në disa nene të ligjit të koncensioneve (studim i dorëzuar pranë grupit parlamentar në takimin e parë).

...Reagime të forta ka patur edhe nga mjaft deputet të Parlamentit shqiptar, të cilët kane *denoncuar veprimet dhe vendime e marra haptazi (të shkrura dhe të tanishme) që janë tërësisht në dëm të interesit publik (duke i cituar dhe si babëzi të madhe)* ndaj planit për ndërtimin e 3 HEC-ve në Lumin Osum (ku preken kanionet), në Lumin e Bistricës (Librazhd), ku preket dhe zona e



Rrajcës (site i UNESCO), në Lumin e Valbonës, në Lumin e Lumës, dhe në mjaft raste të tjera.

### 3. Dërgim të letrave.

Grupimi i ka drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, në Drejtoria e Përgjithshme për Mjedisin, Komisioni Evropian; Drejtorit të Përgjithshëm, Komisioni Evropian, në Drejtorinë e Fqinjësisë dhe të Negociatave të Zgjerimit; Kryetarit të Delegacionit të Bashkimit Evropian, në Shqipëri; Ambasadësë Shteteve të Bashkuaratë Amerikës, në Shqipëri; Prezencësë OSBE, në Shqipëri; Koordinatorit të përhershëm të OKB-së në Shqipëri dhe përfaqësues i përhershëm i UNDP; Organizmave të tjerë joeveritare ndërkombëtare, etj, një letër duke sjell në vëmendjen e tyre ndikimet e rëndësishme që, praktikatat aktuale të zhvillimit hidroenergjetik në Republikën e Shqipërisë, kanë në mjedis dhe tek banoret e këtij vendi kandidat në Bashkimin Evropian.

Po ashtu u është shprehur shqetësimi serioz në lidhje me efikasitetin e shpenzimeve të Komisionit Evropian mbi natyrën në Shqipëri, si dhe për të paraqitur rekomandime specifike për të korrigjuar këtë situatë.

Njëherazi u është kërkuar nga grupimi që, në takimin e ardhshëm të Nënkomitetit për mjedisin, transportin, zhvillimin rajonal dhe energji, Komisioni Evropian duhet të dërgojë një sinjal të fortë për financimet në Shqipëri, duke kërkuar ndërmarrjen veprimeve përkatëse nga ana e Qeverisë Shqiptare.

Parlamenti Evropian me Rezolutën e 14 prill 2016, në Raportin për Shqipërinë, pika 23, bën thirrje qeverisë shqiptare për të kontrolluar zhvillimin e hidrocentraleve në zona të ndjeshme mjedisore të tilla si rreth lumit Vjosa dhe në zonat e mbrojtura, për të ruajtur integritetin e parqeve ekzistuese kombëtare (të rishikojë planet për ndërtimin e HEC-ve). Kështu rekomandon përmirësimin e cilësisë së vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili duhet të përfshijë dhe të marrë në konsideratë standardet e BE-së, të përcaktuara me Direktivën e KE për Zogjtë dhe Habitatet si dhe Direktivën Kornizë të Ujërave; dhe Inkurajon qeverinë shqiptare për të rritur transparencën përmes pjesëmarrjes publike dhe konsultimeve për projektin e planifikuar.

Por, siç dihet, qeveria bëri hapjen e tenderit për ndërtimin e një hidrocentrali të ri në Vjosë (Poçem), megjithatë kryeministri kishte sugjeruar gjithashtu mbrojtjen e këtij lumi kaq unik, ku për më tepër, nuk është bërë një studim i thelluar, sipas standardeve të njohura ndërkombëtrisht në lidhje me ndikimin që ky projekt do të kishte në natyrë.

E njëjta dukuri vihet re në zonat dhe lumenjtë e tjerë ku jo vetëm që nuk ka kufizime apo rivlerësime, por po jepen koncensione, pavarësisht se janë shkeur afatet ligjore dhe të mungesave të theksuara që shoqërojnë projektet e tyre.



#### 4. Kërkesa drejtuar Kryeministrit dhe ministrive të linjës.

**#Rasti Lumi Valbona:** Në kërkesën e dërguar (Tetor 2016) për informacion nga grupimi #“Të mbrojmë lumenjtë”, për vendimin e “Grupit të Punës për vlerësimin e Standarteve Mjedisore në të gjitha kontratat e dhëna për ndërtimin e HEC-ve, në Valbonë”, në përgjigjen e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, ndër të tjera, theksohet:

...Në lidhje me kontratat koncesionare për ndërtimin e HEC-ve mbi kaskadën e lumit "Valbonë", Ministria e Energjisë dhe Industrisë me përgjegjësinë institucionale të monitorimit të kontratave koncesionare të nënshkuara me shoqëritë koncesionare “T’Plan”shpk; “Gener 2”shpk dhe “Valbona Project Company”shpk, gjatë monitorimit të zbatimit të këtyre kontratave koncesionare ka *evidentuar një seri problemesh të karaktereve të ndryshëm, të cilat janë të domosdoshmetë trajtohen në mënyrë specifike dhe të rivlerësohen nga pikëpamja teknike, ekonomiko-financiare, të përshtatjes mjedisore (me natyrën) dhe me kornunitetin.*

...Gjithashtu, përsa është evidentuar edhe nga ana tuaj, në shkresën e lartpërmendur, gjykojmë që trajtimi i problemeve kërkon domosdoshmërisht koordinimin e disa strukturave shtetërore të angazhuara në proces. Në këtë kuadër e vlerësojmë bashkëpunimin tuaj me strukturat shtetërore që mbulojnë objektin e veprimtarisë tuaj.

...Ministria e Energjisë dhe Industrisë shprehet e gatëshme për bashkëpunim me ekspertët tuaj. Ju faleminderit për mirëkuptimin.

Pra, shiç theksohet në përgjigje, kjo Ministri nuk ka marrë në konsiderat problemet e evidentuara dhe rivlerësimin e këtyre projekteve, por në informacionet që ka grupimi janë parashikuar që në lumin e Valbonës, veç HEC Dragobia, të ndërtohen edhe 14 HEC të tjerë.

**Me këtë rast vëmë në dukje se Kryeministri, në takimin “Zhvillimi i burimeve natyrore në harmoni me mjedisin”,** theksoj: ...Dy momente me rëndësi themelore që janë adresuar në këtë periudhë kanë pasur të bëjnë me minierat dhe me HEC-et, për të krijuar një ekuilibër sa më të natyrshëm mes nevojës së pandalshme për zhvillimin dhe domosdoshmërisë që zhvillimi të mos çënojë të ardhmen e vendit dhe të mos ndodhë në kurriz të gjeneratave të tjera.

...Pa llogaritur faktin që në të shkuarën batërdia e korrupsionit dhe pa dyshim e këtij modeli zhvillimi pa asnjë qëndrueshmëri ka sjellë një numër të drejtash apo lejesh të dhëna për HEC-et, ndër të cilat 113 janë drejtpërdrejt në **zona të mbrojtura**. Pra, zona të përcaktuara **ligjërisht si zona të paprekshme nga rrugët e zhvillimit** dhe prej tyre 42 janë tanimë në prodhim, 23 janë ende në



proces ndërtimi, ndërsa 58 të tjera nuk kanë filluar dhe nuk kanë për të filluar punë, pasi në projektligjin që propozohet për të rishikuar lejet e dhëna do të ndalohet një herë e mirë ndërtimi i HEC-ve apo i çfarëdo lloj tjetër aktiviteti në zonat e mbrojtura.

**...Projektet për ndërtimin e hidrocentraleve në zonat e mbrojtura, ku nuk ka nisur ende puna, nuk do të lejohen nga qeveria, e cila do të paraqesë në Parlament një projektligj, që synon t'i japë fund abuzimit me HEC-et dhe minierat në zonat e mbrojtura.**

...Njëherazi, Kryeministri, duke iu përgjigjur shqetësimeve të komunitetit dhe shoqërisë civile, u ndal edhe te Lumi Vjosë, ku tha se nuk do të lejohet ndërtimi i HEC-ve, siç ishte parashikuar nga qeveria e mëparshme. “Ne kemi një plan tjetër për Vjosën, atë të parkut natyror”.

Realiteti është krejt ndryshe jo vetëm që nuk u ndaluan HEC-et, për të cilët nuk kishin filluar punimet apo ndërtimi, por u miratuan edhe ata që kishin shkëlur ligjin dhe lejet koncensionare.

## 5. Bshkëbisedime me pushtetin vendor dhe komunitetin.

#“Bashkëbisedim dhe Informimin në Një Shoqëri Demokratike” organizaur nga shoqata “TOKA” për t’i thënë mundësinë banorëve vendas që të kenë qasjen e një grupi ekspertësh nga një sërë fushash të ndryshme në lidhje me HEC-et që po ndërtohen. Ky takim i planifikuar që të ishte i hapur dhe i lirë, do t’i shërbente interesit publik dhe veçanërisht banorëve të Valbonës.

Në këtë bashkëbisedim morri pjesë ambasadori i SHBA, përfaqësuesi i Delegacionit të BE-s në Tiranë, etj, dhe u vu re mungesa nga drejtuesit kryesor të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisidhe ata të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Edhe Ambasada e Gjermanisë, ka mbështur publikisht banorët e zonës së Valbonës, për pezullimin e punimeve për ndërtimin e hidrocentraleve në parkun kombëtar të Valbonës. Reagime të tilla ka patur edhe nga ambasada të tjera të akredituara në Tiranë.

Prezenca e OSBE, në Shqipëri ka organizuar një takim pune “Sesion dëgjese për zhvillimin e hidroenergjisë në Shqipëri”. Në këtë takim u diskutuan rastet: Parkut Kombëtar i Valbonës, Parkut Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”, rasti i Lumit Vjosë etj.

Për t’u vënë në dukje është fakti që Parlamenti Evropian i ka kërkuar qeverisë shqiptare të rishikojë projektet hidroenergjetike përgjatë lumit Vjosa dhe degëve të këtij lumi dhe të hartojë Planet e Ndikimit në Mjedis, përpara se projektet të vihen në zbatim.



## 6. Organizime të fushatave dhe protestave.

Prej muajit Janar 2016 e në vijim, një lëvizje e fuqishme lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, është zhvilluar dhe po zhvillohet kundër ndërtimit të hidrocentraleve, në mbarë vendin. Shtyllat kryesore të protestave janë: shkatërrimi i zhvillimit lokal përmes eko-turizimit; shkelja e ligjeve mjedisore; mungesa e transparencës dhe mospërfshirjes së publikut në informin dhe provesin e vendimmarrjes.

Për hidrocentralet në Lumin Vjosa, për të luftuar këtë valë shkatërrimi, EuroNatur, RiverWatch dhe grupimi #“Të shpëtojmë lumenjtë” filluan fushatën #“**Të Shpëtojmë zemrën blu të Evropës**”. Kundër këtyre HEC-ve janë ngritur dhe disa drejtues të pushtetit vendor, të cilët thonë se projektet energjetike nuk janë konsultuar me komunitetin dhe prekin rëndë interesat e tyre. Protesta të fuqishme janë bërë për Vjosën, Langaricën, Bençën, Poçemin, Valbonën, Shebenikun, Lumën, Korabin, kanionet e Osumit, etj.

Kundërshti ndaj HEC-ve kanë edhe banorët, të cilët thonë se projektet nuk janë konsultuar me komunitetin dhe rrezikojnë të ardhurat e tyre të bazuara tek turizmi malor. Në këto protesta janë bashkuar edhe aktivistë mjedisorë, personalitete të të gjitha fushave, shqiptarë që kanë emigruar dhe turistë e agjenci turistike nga mbarë bota, që e kanë futur udhëtimin në ZMM si një prej destinacioneve të tyre kryesore.

Protesta e zhvilluar në Tropojë me moton #“**MosMaPrekValbonën**” ishin nga më të mëdhat. Të tilla protesta janë zhvilluar edhe në Tiranë përpara ministrisë së Energjitikës dhe Kryeministrisë, ku është kërkuar anulimin e lejeve të HEC-ve në parkun kombëtar të Valbonës.

Në protestat e zhvilluara është kërkuar që qeveria dhe organet ligj zbatuese të mos mbyllin sytë para abuzimeve të bëra me lejet koncesionare të HEC-ve, pasi pasojat që ato shkaktojnë për jetën e komunitetit janë me përmasa të frikshme.

Kohë pas kohe, nga shoqëria civile, është sugjeruar rishikimi i lejeve koncesionare të HEC-ve pasi shpesh nga verifikimet e bëra nga ekspertët kompetentë me këmbënguljen e përfaqësuesve dinjitozë të komunitetit dhe të zgjedhurve lokalë ka rezultuar se nga ana e koncesionarëve po shkatërrohet natyra.

Vendimi i qeverisë për ndalimin e HEC-ve në zonat e mbrojtura është mbështetur edhe nga shoqëria civile, përfaqësues të së cilës kanë kërkuar që shteti të ndikojë me autoritetin e ligjit të investitorët në mënyrë që ata të respektojnë të gjitha detyrimet ligjore dhe të ruajnë regjimin e duhur të



rrjedhës ekologjike të lumenjve që janë e duhen ruajtur si një pasuri natyrore e jashtëzakonshme. Por ende nuk ka një veprim të tillë.

Komuniteti i zonave ku po ndërtohen dhe ku janë parashikuar të ndërtohen HEC-et ndjehet i keqardhur që shteti i tyre është bërë palë me koncesionarët e këtyre veprave hidroenergjitike.

Aktivitete/Proteste të sukseshme kundër ndërtimit të HEC-ve kanë qënë edhe koncertet të zhvilluar pranë zonave të ndërtimit dhe në qënder të Tiranës.

Po kështu shfaqja e filmave #**“Elementi i pestë”**, #**“Zemra Blu”**, por edhe të tjerë, paraqesin historitë e mbrojtjes së lumenjve të Shqipërisë. Shfaqjet e filmave janë shoqëruar me diskutime të hapura për domosdoshmërinë e mbrojtjes së burimeve ujore dhe të pasurive të tjera natyrore, për rrugët e zgjidhjes së shqetësimeve dhe të problemetikës së ndërtimit pa kufi dhe në çdo lumë e degë të tyre të një numri jashtëzakonisht të madh të hidrocentraleve. HEC-t e vegjël janë tërësisht jo efektiv në zhvillimin e vendit, social-ekonomik dhe ekoturistik. Këta filma janë shfaqur në mbarë vendin, por dhe në Kosovë, për sensibilizuar opinionin dhe të diskutojnë mbi hidrocentralet në lumenjtë e Kosovës, për të mos përsëritur gabimet e Shqipërisë.

## 7. Kryerja e studimeve shkencore.

Studimet shkencore kanë vlerësuar teknikisht numrin e projekteve të hidrocentraleve që janë planifikuar Brenda zonave të mbrojtura. Nga ku ka rezultuar se projektet hidroenergjitike në Shqipëri, janë ndërtuar pa mbikëqyrje, kanë dëmtuar biodiversitetin dhe kanë nevojë urgjente për marrjen e masave të monitorimit dhe restaurimit.

Specialitet shprehen se dëmtimet në mjedis janë të shumta dhe vijnë kryesisht si pasojë e mungesës së mbikëqyrjes profesionale gjatë ndërtimit, shkatërrimi mjedisor ka sjellë efekte sociale, duke qënë se lumenjtë përdoren edhe për ujitje. HEC-et kanë sjellë konflikte të komunitetit me të drejtat mbi ujin, të cilat janë pasojë e mungesës së ujit dhe të shkeljes së standardeve të prurjeve ekologjike.

Në shumicën e rasteve janë të dukshme shkeljet flagrante të ligjeve kombëtare dhe standardeve të institucioneve financiare ndërkombëtare. Disa nga këto shkelje kanë shkaktuar dëmtime të rënda në florën e faunën e zonave. Shpyllëzimi ka ardhur si rezultat i punës gërmuese për të krijuar hapësirë për tubacionin. Gjithashtu gërmimet për bazat e tubacionit, rrugët e hyrjes dhe linjat e energjisë elektrike, kanë hequr mbulesën e pemëve dhe vegjetacionit. Vijon shkatërrimi i burimeve ujore të cilat po shkaktojnë një dëm ekologjik me pasoja të parikuperueshme për të ardhmen.



## 8. Media.

Për çështjen e HEC-ve dhe mbi impaktet që ata shkaktojnë në mjedis, janë prononcuar dhe diskutuar nga një larmi e madhe të mediave televizive dhe në radio (kombëtare e lokale), vendase dhe të huaja, për të cilat ka patur një shikueshmëri të lartë.

Po kështu janë shkruar mjaft artikuj të ndryshëm apo dhe reportazhe nga gazetarë vendas dhe të huaj.

Janë organizuar emision në TV kombëtar mbi temën e HEC-ve, duke zgjedhur 1 ose 2 përfaqësues nga grupimi për të ngritur zërin dhe prezantuar të gjithë punën që organizatat mjedisore kanë bërë për të kundërshtuar ndërtimin e pakontrolluar dhe mungesën e një strategjie kombëtare për zhvillimin e hidroenergjisë në Shqipëri.

Emisione janë organizuar edhe në formë debati mes institucioneve përgjegjëse dhe organizatave mjedisore, etj.

Thuajse të gjitha mediat kanë pasqyruar të plotë dhe çdo herë reagimet apo dhe protestat e bëra nga komuniteti vendor dhe organizatat e shoqërisë civile për këto tematika.

## 9. Ankimi në Gjykatë.

Në Shqipëri kohët e fundit ka më shumë ndjeshmëri dhe mbështetje nga shoqëria civile e qytetarët për të kundërshtuar projekte ndërtimore në zonat e mbrojtura mjedisore.

Përfaqësues të komunitetit dhe aktivistë të mbrojtjes së mjedisit janë përfshirë në një betejë ligjore në Tiranë. Gjithshka nisi kur në Lumin e Vjosës dhe në Luginën e Valbonës, filluan ndërtimi i hidrocentraleve. Kundërshtia e banorëve dhe e aktivistëve mjedisorë vendas, por edhe të huaj, për këto leje zhvillimore të akorduara nga institucionet dhe agjencitë qeveritare është nga vlerësimi që ata bëjnë se projektet janë armiqësore me ekosistemin, me bukuritë e rralla, duke minimizuar apo eliminuar monumentet natyrore, duke dekurajuar fluksin e turistëve që janë disafishuar në vitet e fundit.

Por, anëtarët e komunitetit dhe mjedisorët pasi kanë ndjekur një kalendar aktiviteteve sensibilizuese për opinionin, brenda dhe jashtë vendit, pasi kanë protestuar në vendin e ndërtimit të HEC-ve, pasi kanë afruar dhe disa figura të njohura të artit dhe kulturës, janë zhvendosur në Tiranë, në ndjekje të procesit ligjor, për të detyruar shtetin dhe kompaninë ndërtuese që të heqin dorë nga zbatimi i projekteve.

**#Rasti i HEC-it të Poçemit**, fitorja në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë është një nga rezultatet më pozitive që mund të pritesh nga komuniteti,



OJF-të dhe publiku i gjerë. Megjithatë përpjekja për ruajtjen e Vjosës si një ekosistem i tërë mbetet një sfidë. Përpjekjet për mbrojtjen e lumenjëve dhe angazhimin e komuniteteve të prekura nga HEC-et do të vazhdojnë, duke shfrytëzuar fuqinë që i jep ligji banorëve dhe organizatave të shoqërisë.

**#Rasti i HEC-ve të Valbonës**, ku janë zhvilluar disa seanca gjyqësore dhe të paktën nga ndjekja e procedurave dhe afateve kohore “dosja Valbona” nuk i ngjan çështjeve të tjera që zvarriten duke zgjatur pambarim afatet kohore, deri në degradim të procesit. Në padinë e depozituar u kërkua ndërprerja e menjëhershme e punimeve për ndërtimin e hidrocentraleve.

Por, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, në Tiranë pas shqyrtimit të kërkesës të 27 banorëve nga Rrogami, Valbona, Dragobia dhe Çeremi, shoqatës “Toka”, lidhjes “Të shpëtojmë Alpet Shqiptare”, të cilët kanë paditur: Këshillin Kombëtar të Territorit, Tiranë; Shoqërinë “Dragobia Energy” shpk.; Shoqërinë “Gener2” shpk.; Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, Tiranë, me vendimin nr.1410(31155-00553-80-2018) akti, date 31.01.2018 ka vendosur: **“Rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës për sigurimin e objektit të padisë”**.

Ky vendim i Gjykatës është kundërshtuar fuqishëm. Shoqata TOKA, banorët dhe mjaft OMSHC, janë shprehur se çështja do të vazhdojë përmes ankimimit, pasi “Burimet e ujit dhe biodiversiteti janë shumë me rëndësi që të mos përfillen kur merren vendime për zhvillim të hidrocentraleve, dhe duhet të merren parasysh mendimet e komunitetit lokal për atë që ndodh në vendin e tyre”.

Ata shprehen se ndërtimi i hidrocentraleve do të dëmtojë mjedisin dhe potencialin turistik të zonës së Alpeve Shqiptare. Banorët gjithashtu kanë denoncuar vazhdimisht dhënien e lejeve pa konsultim publik që parashikohet në Konventën e Aarhusit, që detyron përfshirjen e komunitetit në vendimmarrjen e çështjeve mjedisore.

Qeveria shqiptare ka miratuar ndërtimin e 14 hidrocentraleve mbi lumin e Valbonës dhe në degëzimet e tij, ndërsa në dekadën e fundit qeveria ka lëshuar leje ndërtimi për 526 hidrocentrale në të gjithë Shqipërinë.

Kjo mënyrë e prodhimit të energjisë është kritikuar vazhdimisht nga organizata mjedisore ndërkombëtare, të cilat i kanë bërë thirrje Shqipërisë të drejtohet në forma më të reja dhe më miqësore me natyrën për nxjerrjen e energjisë.

Ndaj këtij vendimi ka reaguar edhe Fondi Botëror për Natyrën (WWF), organizata për mbrojtjen e jetës së egër dhe specieve në zhdukje në botë. Përmes një deklaratë për shtyp ka shprehur keqardhje për vendimin e gjykatës





për lejimin e ndërtimit të hidrocentraleve në Parkun Kombëtar të Luginës së Valbonës.

WWF Adria, paralajmëroi gjithashtu se ky vendim i gjykatës do të hapë rrugën për dëmtim në mënyrë të konsiderueshme e pa kthim të biodiversitetit dhe ekosistemit të kësaj zone të mbrojtur. “Meqenëse vendimi për zhvillimin është bazuar në vlerësim të dobët të ndikimit në mjedis dhe në një proces me pjesëmarrje jo adekuat të publikut, kemi frikë se do të vendoset një precedent i rrezikshëm që mund të dërgoj në shkatërrimin e lumenjve dhe burimeve të ujërave të ëmbla në gjithë vendin”.

Kundër këtij vendimi, më datën 05.02.2018, është depozituar ankimi i veçantë nga pala paditëse në Gjykatën Administrative të Apelit, me të cilin ka kërkuar: "Ndryshimin e Vendimit të Ndërmjetëm të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, datë 31.1.2018 dhe pranimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë, pezullimin e zbatimit të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.12, datë 10.11.2017 deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes me vendim të formës së prerë".

Gjykata Administrative e Apelit, vendosi: 1. Ndryshimin e Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe 2. Pranimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duke urdhëruar pezullimin e punimeve në zbatim të aktit administrativ, vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 12 datë 10.11.2017 “Për miratimin e shtyrjes së afatit të lejes së ndërtimit për objektin: “Ndërtim i Hidrocentralit “Dragobia”, Komuna Margegaj, Qarku Kukës”, deri në përfundimin e gjykimit të çështjes.

#### **4. Ndërmarrja e veprimeve konkrete për mbrojtjen e natyrës dhe të burimeve natyrore. #Rasti i PK “Divjakë-Karavasta”**

##### **REAGIMET E PARA:**

##### **1. PROTECTION AND PRESERVATION OF NATURAL ENVIRONMENT IN ALBANIA - PPNEA**

“Kur do të ndërgjegjësohemi që disa gjëra nuk janë për t’u përdorur sipas interesave të momentit?”

Gjatë vizitës së radhës në lagunën e Karavastasë për monitorimin e Pelikanit kaçurrel u ndeshëm me një pamje aspak të zakonshme për Parkun Kombëtar “Divjakë-Karavasta”. Në zonën pranë kanalit të Vaut kryhen gërmime dhe konkretisht brenda në lagunën e Karavastasë.

Zona më e rëndësishme ligatinore në Shqipëri, i vetmi vend folezimi për pelikanin kaçurrel po kërcënohet drejtpërdrejt nga ndërhyrje akoma të paqarta dhe të pa bëra publike me projekte konkrete. Siç shihet në foto, makineri



gërmuese janë instaluar prej ditësh brenda në lagunë dhe po gërmojnë për të hapur një kanal përgjatë gjithë gjatësisë së lagunës.

Sipas burimeve lokale këto ndërhyrje po bëhen për t'a kthyer kanalën të lundrueshëm për varka.

Zona ku po kryhen punimet është rreptësisht e ndaluar të ketë ndërhyrje të tilla pasi thyen të gjitha ligjet mjedisore si për zonat e mbrojtura, që në këtë rast ka statusin e Parkut Kombëtar apo dhe konventën ndërkombëtare Ramsar ku laguna e Karavastasë si zonë qendrore e parkut mbrohet që prej vitit 1995 si një ligatinë me rëndësi botërore.

Për më tepër laguna e Karavastasë është identifikuar si një Zonë Parësore e Biodiversitetit (Key Biodiversity Area), zonë Emerald dhe një biotop CORINE, klasifikime që theksojnë rëndësinë ndërkombëtare të kësaj zone për ruajtjen e diversitetit biologjik.

Kërkojmë reagimin e autoriteteve përgjegjëse që të ndalojnë menjëherë këtë ndërhyrje me pasojë katastrofike në një zonë me rëndësi të madhe biologjike, jo vetëm në shkallë kombëtare por dhe më gjerë.

## 2. INSTITUTI PËR RUAJTJEN E NATYRËS NË SHQIPËRI - INCA

Siç shihet, në foto, ka filluar shkatërrimi edhe i PK "Divjakë-Karavasta", i vetmi park i Shqipërisë që nuk ka pësuar ende ndërhyrje të rënda.

Nuk ka informacion dhe nuk dihet pse kryhen këto ndërhyrje dhe cili është qëllimi i tyre!

Vendi ku po ndërhyhet është pjesë e Zonës Qendrore të Parkut, ku nuk lejohet, sipas ligjit "Për zonat e mbrojtura" (neni 6) dhe e VKM nr. 687, dt 19.10.2007 për shpalljen e këtij territori Park Kombëtar, ku kërkohet që të jetë një territor i pasqyrtësuar. Po kështu kjo zonë ka dhe statusin e Zonës RAMSAR.

Ç'farë bëhet me Zonat e Mbrojtura dhe Parqet Kombëtare të Shqipërisë? Pse këto veprime në vijimësi dhe tepër shkatëruese vazhdojnë dhe nuk po ndërpritin? Boll me HEC-et, por edhe PK "Divjakë-Karavasta" do ta pësojë këtë fat! Cilët janë këta që kryejnë këto veprime?

### ARGUMENTIMI:

#### STATUSI I ZONËS:

1966 – Park Kombëtar Pyjor

1977 – Pylli dhe zonat e lagëta të Kularit, Rezervat Gjuetie.

1994 – Zonë RAMSAR, Laguna e Karavastasë dhe parku i Divjakës shpallen si ekosistem natyror veçanërisht i mbrojtur për t'u përfshirë në listën e konventës së RAMSARIT.

1996 – Laguna e Karavastasë, Zonë Strikt Natyrore dhe Pylli i Pishës-Kular, Rezervat Natyror i Menaxhuar.



Biotop CORINE - klasifikim që theksonë rëndësinë ndërkombëtare të kësaj zone për ruajtjen e diversitetit biologjik.

2001 – Zonë veçanërisht e Mbrojtur, Rrjeti EMERALD, pjesë e listës kombëtare të ASCI (Kodi AL 0000002)

2007 – Park Kombëtar me sipërfaqe të zgjeruar.

2013 – Zonë e Listës së sipërfaqeve ligatinore bregdetre, që shërbejnë si habitate për shpendët migratore, Konventa e Bonit- *Important Bird Areas* (IBA).

## LIGJ “PËR ZONAT E MBROJTURA” (viti 2002)

### Neni 6 - Park Kombëtar

2. Në parkun kombëtar zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, **ku janë të ndaluara:** a) shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive, **me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve** ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës;

i) veprimtari masive sportive, turistike, jashtë pikave të caktuara;

3. Në këtë zonë mund të ushtrohen, por vetëm pasi të pajisen me leje mjedisi, veprimtaritë që synojnë:

a) ndryshimin e gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;

dh) veprimtari të tjera që nuk ndalohen shprehimisht nga pika 2 e këtij neni.

### Neni 12 - Pyjet, ujërat dhe pasuri të tjera natyrore brenda zonave të mbrojtura

1. Pyjet në zonat e mbrojtura përjashtohen nga klasifikimi si pyje për shfrytëzim.

2. Menaxhimi i pyllit dhe i pasurive pyjore, i ujërave e pasurive ujore, si dhe i pasurive të tjera pronë shtetërore, që ndodhen brenda një zone të mbrojtur, bëhen nga administrata e ruajtjes së zonës. Administrata këto veprimtari i ushtron drejtpërdrejt ose nëpërmjet një subjekti të autorizuar prej saj.

### Neni 19 - Përdoruesit e zonave të mbrojtura

2. Veprimtaritë dhe ndërtimet në zonat e mbrojtura bëhen vetëm sipas kërkesave të këtij ligji, në përputhje **me planin e menaxhimit dhe pasi të jetë marrë leja e mjedisit.** Për ndërtimet që janë bërë ose bëhen në kundërshtim me këtë ligj, zbatohet ligji nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar.

3. Veprimtaritë ekonomike e shoqërore, projektet që synojnë të zbatohen në një zonë të mbrojtur, **pajisen me leje mjedisi, pasi të paraqesin studimin përkatës dhe raportin e plotë të vlerësimit të ndikimit në mjedis.**

4. Të gjitha ndërtimet publike, private e turistike në territorin e zonave të mbrojtura, bëhen në **bazë të studimeve dhe planeve rregulluese të**



**përgjithshme, të cilat miratohen nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.**

**VENDIM KM Nr.687, datë 19.10.2007 “PËR SHPALLJEN, ME SIPËRFAQE TË ZGJERUAR, TË EKOSISTEMIT NATYROR DIVJAKË-KARAVASTA "PARK KOMBËTAR"**

4. "Parku kombëtar i Divjakë-Karavastasë ndahet në nënzona ruajtjeje e administrimi, si më poshtë vijon:

a) Zona qendrore, me sipërfaqe 4189.70 ha (e shënuar në hartë me "ZQ"), përfshin habitatet e Kularit, Pishës së Divjakës, godullën e Dajlanit dhe ishujt e folenizimit të pelikanit kaçurrel në lagunën e Karavastasë. Ajo **përcaktohet si zonë me vlera të larta, për natyrën dhe biodiversitetin, dhe në të zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar.**

**PLANI I MENAXHIMIT** miratuar me urdhër të ministrit të Mjedisit nr.782, datë 30.12.2015...**Nuk parashikon të tilla ndërhyrje.**

**VENDIM KM Nr. 238, datë 23.4.2014 “PËR SHPALLJEN E LAGUNËS SË KARAVASTASË SI ZONË BASHKËMENAXHUESE E PESHKIMIT”**

1. Shpalljen e lagunës së Karavastasë si zonë bashkëmenaxhuese e peshkimit, duke pasur parasysh statusin mbrojtës të lagunës, si pjesë e Parkut Kombëtar Divjakë - Karavasta e zonë natyrore, veçanërisht e mbrojtur, dhe si habitate të shpendëve ujorë, të përfshirë në listën e Konventës Ramsar.

2. Veprimtaritë dhe investimet që do të kryhen në lagunën e Karavastasë të jenë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, dhe me objektivat e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta”.

**LIGJ Nr. 107/2014 “PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT”**

**Neni 1 – Qëllimi**

a) të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;

b) të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikëe privatë, duke bashkërenduar punën për:

i) mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet;

c) të nxitë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë



biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit;

#### **Neni 4 - Parimet**

gj) harmonizimi me qasjen e Bashkimit Europian në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, si edhe lidhur me kriteret mjedisore, ruajtjes së biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura;

#### **Neni 16 - Plani i Përgjithshëm Kombëtar**

ç) krijimi i kushteve për ruajtjen e ekosistemeve, biodiversiteteve, burimeve natyrore mbi e nën tokë dhe të pasurisë natyrore e kulturore, balancimi i efekteve të sistemeve të banimit e veprimtarive ekonomike dhe mbrojtja e zhvillimi i sipërfaqeve të gjelbra e sipërfaqeve të tjera të kultivueshme;

#### **Neni 17 - Planet kombëtare sektoriale**

Planet kombëtare sektoriale hartohen nga ministritë, me qëllim zhvillimin strategjik të një ose më shumë sektorëve të ndryshëm, sipas fushave të kompetencës si siguria kombëtare, energjia, industria, transporti, infrastruktura, turizmi, zonat ekonomike, arsimi, sporti, trashëgimia kulturore dhe natyrore, shëndetësia, bujqësia dhe ujërat.

#### **Neni 19 - Planet sektoriale në nivel qarku**

d) përcaktimin strategjik për rregullimin e përdorimeve të tokës sipas sistemeve natyrore, bujqësore dhe urbane të territorit;

dh) planifikimin e programeve dhe masave për të garantuar mbrojtjen emjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme, peizazheve dhe hapësirave të gjelbra;

ë) rregullimin e ruajtjes, përdorimit dhe, sipas rastit, mbarështimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe historike, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 20 - Plani i Përgjithshëm Vendor**

ç) rregullimii përdorimeve të tokës, intensitetit e shtrirjes së ndërtimit në sistemet natyrore, bujqësore dhe urbane të territorit;

d) planifikimi i programeve dhe masave për të garantuar rigjenerimin urban, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme, peizazheve dhe hapësirave të gjelbra;

#### **Neni 31 - Transferimi i së drejtës për zhvillim**

1. Transferimi i së drejtës për zhvillim midis njësive strukturore realizohet, sipas rastit, nga autoriteti vendor i planifikimit, me qëllim ruajtjen e monumenteve të kulturës dhe zonave historike, tokës bujqësore dhe asaj natyrore.

### **LIGJ Nr. 111/2012 “PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE”**

#### **Neni 2 - Fusha e veprimit**

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për:



a) ujërat brendshme detare, ujërat territoriale, vijën bregdetare, zonën ekonomike ekskluzive, shelfin kontinental, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku meshtresat ujëmbajtëse dhe rreshjet atmosferike, ujërat ndërkufitare, burimet natyrore dhe ujërat e lagunave e zonat e mbrojtura;

#### **Neni 5 - Pronësia e burimeve ujore**

1. Janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore:  
b) të gjithë shtretërit dhe brigjet e lumenjve, përrrenjve dhe rrjedhave të tjera natyrore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, ujërat kurative, minerale, termomineraledhe gjeotermale, kanalet, liqenet, pellgjet, lagunat dhe ujëmbledhësit natyrorë apo artificialë, ishujt dhe grumbullimet e rërës, gurëve dhe dherave në shtretërit e lumenjve, liqeneve dhe ujëmbledhësve, si dhe formacionet gjeologjike të ujërave nëntokësore;

#### **Neni 7- Organet kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore**

1. Organet qendrore për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore janë:  
a) Këshilli i Ministrave;  
b) Këshillit Kombëtar i Ujit;  
c) Ministria;  
d) Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit.  
2. Organet vendore për menaxhimin e integruar të burimeve ujore janë:  
a) këshillat e baseneve ujore;  
b) agjencitë e baseneve ujore.

#### **Neni 34 - ZONAT E MBROJTURA**

1. Zonat e mbrojtura, në bazë të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, përcaktohen me qëllim mbrojtjen e ujërave dhe ekosistemeve ujore dhe përfshijnë masa të veçanta mbrojtëse.  
2. Në zonat e mbrojtura përfshihen:  
a) zonat higjieno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm;  
b) zonat e mbrojtura, të përcaktuara sipas ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar;  
c) zonat për peshkim dhe rritjen e butakëve, sipas legjislacionit për peshkimin;  
d) zonat për banjat termale, për trajtimin kurativ dhe rekreacion;  
e) zonat e prirura ndaj eutrofikimit dhe zonat në rrezik nga nitratat e nitritet;  
f) zonat e synuara për mbrojtjen e bimëve apo kafshëve, si dhe të habitateve, kurruajtja apo përmirësimi i statusit të ujit është një element i rëndësishëm i mbrojtjes së tyre.

#### **Neni 67 - Veprimtari të ndaluara në brigje dhe plazhe**

1. Në brigje, plazhe dhe në zonat e vërshimit ndalohen:  
a) ndryshimi ose zhvendosja e mbulesës bimore natyrore apo artificiale;



- b) marrja e materialeve inerte, rërë, zhavorr, gurë ose plisa;
- c) ndërtimi i vendeve të parkimit për mjete ujore dhe automjete tokësore;
- d) krijimi i vendeve të thata për rrjetat;
- e) gjermimi, shpimi ose shpëlarjet;
- f) hedhja apo depozitimi i materialeve inerte që dalin nga prishja e objekteve ndërtimore, gjermimeve të ndryshme, si dhe veprimtarive të tjera që gjenerojnë mbetje;
- g) shkarkimi i ujërave të ndotura urbane e industriale të patrajuara.

2. Organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me organet përgjegjëse të rregullimit e planifikimit të territorit, me qëllim sigurimin dhe mirëmbajtjen e bregut, kanë të drejtë të kufizojnë ose të ndalojnë shfrytëzimin e plazhit, të fundit të detit, të dunave, të brigjeve të pjerrëta dhe të çdo sipërfaqeje tjetër që është përcaktuar për mbrojtjen e bregut dhe mirëmbajtjen e tij.

### **Neni 71 – Ndërtimi**

1. Ndërtimi i veprave dhe objekteve për shfrytëzimin e burimeve ujore dhe parandalimin e veprimeve të dëmshme të ujit, që bëhen për shërbime publike, është objekt i autorizimeve, lejeve ose koncesioneve, sipas legjislacionit në fuqi.

## **3. ALBANIAN ORNITHOLOGICAL SOCIETY- AOS**

### **ALARM! NDËRHYRJE E PATOLERUESHME NË PK “DIVJAKË-KARAVASTA”!**

Bashkia e Divjakës, pa asnjë Leje Mjedisore, pa kurrfarë Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis dhe në kundërshtim me të gjitha Ligjet Mjedisore dhe Konventat Ndërkombëtare ku Shqipëria bën pjesë, ka instaluar në zemër të Parkut makineritë për hapjen e një kanali lundrues për qark lagunës së Divjakës.

Ndërhyrja është planifikuar të kryhet në zonën më të brishtë të Parkut, në dunat ranore shumëshekullore, dhe vijat e ujit që e bëjnë Divjakën jo vetëm një perlë të natyrës shqiptare, por edhe asaj botërore.

Vendi ku dimërojnë me dhjetëra mijëra shpend, vendi ku folezojnë lloje të rralla e të mbrojtura botërisht sot kërcënohet nga papërgjegjshmeria e një institucioni që nuk pyet për ligjin.

Ndërsa inkurajojmë përpjeket e qeverisë shqiptare për përmirësimin e gjendjes natyrore të këtij Parku Kombëtar, AOS i bën thirrje gjithë institucioneve përgjegjëse, përkatësisht Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, Policisë së Shtetit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Ministrisë së Mjedisit dhe çdo institucioni me përgjegjësi ligjore të ndërhyjnë urgjentisht për të ndaluar këtë masakër mjedisore të parathënë.



Komuniteti i OJF-ve mjedisore kombëtare dhe ndërkombëtare, e gjithë shoqëria civile dhe çdo qytetar shqiptar do t'iu jenë mirënjohës dhe do t'u vijjnë në mbështetje !!!

#### **4. PROTECTION AND PRESERVATION OF NATURAL ENVIRONMENT - PPNEA Vlorë**

Fatkeqësisht, në hartimin dhe zbatimin e këtij projekti, si një mendësi e infektuar nga shumë vendimmarrës në gjithë vendin tonë, nuk kanë marrë parasysh mbrojtjen e mjedisit; në mënyrë të veçantë cënueshmërinë e mjedisit deri në cënimin e ekuilibrit biologjik, mosvlerësim të vlerave të peizazhit natyror nëpërmjet tjetërsimeve masive të Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta”.

Për arsye të interesave të çastit dhe arogancës, të kuptuarit dhe njohjen paraprake të impaktit negativ të këtij projekti si ndërhyrje mjedisore nuk duan ta vlerësojnë si ndryshim, tjetërsim të ekosistemit natyror e si pasojë të biodiversitetit përkatës.

Për mjedisoret është shumë i qartë parimi se projektet si ndërhyrje në mjedis, duhet të justifikohen jo vetëm mbi bazën e arogancës dhe përfitimeve të çastit e me pasoja të rënda (ndoshta edhe më katastrofa mjedisore ) në të ardhmen.

Ndërkohë, megjithëse edhe me ligj të veçantë, pjesëmarrja në vendimmarrjen mjedisore është detyrim kushtetues dhe ligjor, megjithëse niveli i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje për çështjet e mjedisit është indikator për të vlerësuar nivelin e demokracisë dhe respektimin e ligjislacionit mjedisor, fatkeqësisht edhe në këtë rast, konstatohet se për arsye të interesave të dyshimta, përfshirë dhe arogancën e vendimmarësve, kanë përjashtuar pjesëmarrjen e publikut, pjesëmarrjen e palëve të interesit siç janë shoqëria civile që ka menaxhuar projekte në mbrojtje të mjedisit natyror dhe biodiversitetit përkatës.

Të revoltuar shprehemi se i gjithë ky ekosistem natyror me topografinë dhe biodiversitetin e vetë faunistik e floristik si pasuri kombëtare, të përshtatur e në ekuilibër me faktorët ekologjik ekzistues, nëpërmjet dëmtimit dhe tjetërsimit të pejsazhit natyror që po i shkaktohen, vendimmarrësit me injoranecën, dhe arogancën e tyre i janë kundërvënë realisht politikës së zhvillimit të qëndrueshëm jo vetëm në nivel lokal, por edhe në atë kombëtar.

Rjedhimisht, e për fat të keq, konkludohet se vendimmarrësit nuk po funksionojnë si autoritete publike të administrimit të integruar të mjedisit e që do të thotë: Vendimmarrësit në këtë rast nuk po respektojnë e aplikojnë legjislacionin ekzistues e në veçanti atë mjedisor në mënyrë flagrante.





## KRIJIMI I GRUPIMIT TË OMSHC-ve DHE REAGIMI PËR NDËRHYRJET NË PARKU KOMBËTAR

### NJOFTIM PËR SHTYP

Divjakë 30 korrik 2016

Një grup organizatash jofitimprurëse mjedisore kanë bërë publik shqetësimin e tyre mbi ndërhyrjen jashtë çdo kriteri mjedisor në Parkun Kombëtar të Divjakë-Karavastasë të ndodhur kohët e fundit.

Për vlerat unike që disponon ekosistemi natyror i ligatinave ka dhe statusin: Park Kombëtar (1966); Laguna e Karavastasë dhe parku i Divjakës janë shpallur ekosistem natyror veçanërisht i mbrojtur dhe janë përfshirë në listën e konventës së RAMSARIT (nr. Site 781, datë 29.11.1995); Biotop CORINE-klasifikim që theksonë rëndësinë ndërkombëtare të kësaj zone për ruajtjen e diversitetit biologjik; Zonë veçanërisht e mbrojtur, pjesë e listës kombëtare të Rrjeti EMERALD, me kodin AL 0000002 (2001) dhe si zonë e listës së sipërfaqeve ligatinore bregdetare, që shërbejnë si habitate për shpendët migratore, Konventa e Bonit- Important Bird Areas (2013).

Përpara disa muajsh pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është kërkuar nga ana e Bashkisë Divjakë leje mjedisore për zhvillimin e një projekti në brendësi të PK Divjakë-Karavasta.

Ky projekt është për të ndërtuar një urë për këmbësorët (pedonale) prej druri në anë të rrugës dhe thellimin e një struge nga kanali i Vaut deri në afërsi të rrugës.

Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura ka paraqitur argumentet e saj për të kundërshtuar këtë projekt me qëllimin e zbatimit të ligjit në fuqi për zonat e mbrojtura si dhe për të mbrojtur këtë park në veçanti.

Ky argumentim vjen si pasojë e vlerësimit e zonës ku do të zhvillohet projekti, pasi zona është në brendësi të nënzonës qendrore të parkut ku sipas ligjit të zonave të mbrojtura (**neni 6**) nuk lejohen ansjë lloj ndërhyrjeje në zonat qendrore të cilat duhet të jenë territore të pashqetësuara. Zona e përmendur në projekt është gjithashtu shumë afër ishullit të pelikanit ku tashmë kjo specie ka mjedisin e favorshëm për folenizim si dhe ku dimërojnë me dhjetëra mijëra shpend, ku folezojnë lloje të rralla e të mbrojtura botërisht, që po kërcënohen drejtpërdrejt nga ndërhyrje akoma të paqarta dhe të pa bëra publike, nga papërgjegjshmëria e një institucioni që nuk pyet për ligjin.

Po kështu, sipas **nenit 19**, “Veprimtaritë ekonomike e shoqërore, projektet që synojnë të zbatohen në një zonë të mbrojtur, pajisen me leje mjedisi, pasi të paraqesin studimin përkatës dhe raportin e plotë të vlerësimit të ndikimit në mjedis, në bazë të studimeve dhe planeve rregulluese të përgjithshme, të cilat



miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit”. Nuk dihet nëse bashkia e Divjakës e ka kryer këtë kërkesë ligjore.

Bashkia nuk ka respektuar si duhet dhe dispozitat e ligjit nr. 107, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe të ligjit nr.111, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”. Projekti para zbatimit duhet te diskutohet dhe miratohet nga organet kompetente te planifikimit te territorit dhe organet kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore.

Ky projekt nuk ka kaluar përmes procesit të transparencës ku duhej të diskutohej me komunitetin dhe me grupet e interesit që veprojnë në zonën ku shtrihet Parku Kombëtar.

Deri më sot asnjë njoftim për zhvillimin e diskutimit me publikun është bërë nga ana e Bashkisë Divjakë. Në këtë mënyrë nuk është zbatuar nga ana e institucionit të qeverisjes lokale e drejta për informimin e publikut kur zhvillohen projekte në interes të komunitetit.

Për këtë ngjarje të padëshirueshme të ndodhur në Parkun Kombëtar të Divjakë-Karavastasë, kërkojmë që të sensibilizojmë edhe mediat në mbrojtje të kësaj pasurie jo vetëm kombëtare, por edhe botërore.

#### **LETËR DREJTUAR:**

Ministër i Mjedisit

Ministër i Zhvillimi Urban

Ministër i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Agjencia e Planifikimit të Territorit

Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve

Inspektoriati i Ujërave

Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit

Policisë së Shtetit - Prefektura Fier

Për dijeni: **Zëvendëskryeministrit**

**Lënda: Ndërhyrje e paligjshme në parkun kombëtar të Divjakë-Karavastasë.**

I nderuar z. Zëvendëskryeministër, Ministra dhe Ju drejtues të agjencive administruese dhe ligjzbatuese, na lejoni, që me anë të kësaj letre t’Ju informojmë në lidhje me një ndërhyrje të papranueshme për parkun kombëtar “Divjakë-Karavasta”, si më poshtë:

Bazuar në njoftimet dhe verifikimet në vend rezulton se Bashkia e Divjakës, në kundërshtim me dispozitat ligjore për fushën e mjedisit dhe të ruajtjes së natyrës dhe Konventat Ndërkombëtare, ka filluar instalimin e disa makinerive



për hapjen e një kanali lundrues në territorin e lagunës, sipas një projekti aspak i zakonit për Parkun Kombëtar të Divjakë-Karavastasë, kur dihet që bashkia nuk është pronare e këtij territori.

Ekosistemi natyror-lagunor i Karavastasë është i një rëndësie kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, një trashgimi natyror jo vetëm e Shqipërisë. Për këto vlera unike ekosistemi natyror i ligatinave ka dhe statusin: Park Kombëtar (1966); shpallur ekosistem natyror veçanërisht i mbrojtur dhe përfshirë në listën e konventës së RAMSARIT (nr. Site 781, datë 29.11.1995); Biotop CORINE-klasifikim që theksonë rëndësinë ndërkombëtare të kësaj zone për ruajtjen e diversitetit biologjik; Zonë veçanërisht e mbrojtur, pjesë e listës kombëtare të Rrjeti EMERALD dhe si zonë e listës së sipërfaqeve ligatinore bregdetare, që shërbejnë si habitate për shpendët migratore, Konventa e Bonit- Important Bird Areas (2013).

Parku është i rëndësishëm për ekoturizmin, shëtitjet në natyrë, vëzhgimin e zogjëve, plazh, peshkim dhe i vetmi vend folezimi për pelikanin kaçurrel. Dimërojnë me dhjetëra e mijëra shpend, folezojnë lloje të rralla e të kërcënuar botërisht, të cilat po rrezikohen drejtpërdrejt nga ndërhyrje akoma të paqarta dhe të pa bëra publike, nga papërgjegjshmëria e një institucioni që nuk pyet për ligjin.

Ndërhyrja është planifikuar të kryhet në zonën më të brishtë të parkut, në zonën pranë kanalit të Vaut, brenda në lagunën e Karavastasë. Zona ku po kryhen punimet është rreptësisht e ndaluar të ketë ndërhyrje të tilla, sipas ligjit “Për zonat e mbrojtura”. Menaxhimi i pyllit dhe i pasurive pyjore, i ujërave e pasurive ujore, si dhe i pasurive të tjera pronë shtetërore, që ndodhen brenda një zone të mbrojtur, bëhen nga administrata e ruajtjes së zonës, me të cilën Bashkia e Divjakës nuk ka bashkëpunuar dhe nuk ka marrë në konsideratë kërkesat ligjore, duke mos pyetur administratën e parkut.

Ligji thekson se: “Veprimtaritë ekonomike e shoqërore, projektet që synojnë të zbatohen në një zonë të mbrojtur, pajisen me leje mjedisi, pasi të paraqesin studimin përkatës dhe raportin e plotë të vlerësimit të ndikimit në mjedis, në bazë të studimeve dhe planeve rregulluese të përgjithshme, të cilat miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit”. Nuk dihet nëse bashkia e Divjakës e ka kryer këtë kërkesë ligjore.

Vendimi i KM nr. 687, datë 19.10.2007, që shpall këtë ekosistem natyror-ligatinor “Park Kombëtar” përcakton se: “Zona qendrore, me sipërfaqe 4,189.70ha (e shënuar në hartë me "ZQ"), përfshin habitatet e Kularit, Pishës së Divjakës, godullën e Dajlanit dhe ishujt e folenizimit të pelikanit kaçurrel në lagunën e Karavastasë. Ajo përcaktohet si zonë me vlera të larta, për natyrën dhe biodiversitetin, dhe në të zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar”. Pra kjo kërkesë e vendimit nuk respektohet dhe ndërhyrja është në konflikt me ligjshmërinë në fuqi.



Ndërhyrje të tilla nuk parashikohen edhe në Planin e Menaxhimit për parkun kombëtar të Divjakë-Karavastasë, të hartur me mbështetjen e JICA, dhe të miratuar me urdhër të ministrit të Mjedisit nr.782, datë 30.12.2015.

Bazuar në dispozitat e ligjit për zonat e mbrojtura (**neni 19**) citojmë: ...Administrata e zonave të mbrojtura, Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, ndalojnë zbatimin e projekteve e të veprimtarive me ndikim në mjedis dhe që bien ndesh me planin e menaxhimit të zonës.

VKM nr. 238, datë 23.4.2014 për shpalljen e lagunës së Karavastasë si zonë bashkëmenaxhuese e peshkimit, duke pasur parasysh statusin mbrojtës të lagunës, si pjesë e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta e zonë natyrore, veçanërisht e mbrojtur, dhe si habitate të shpendëve ujorë, të përfshirë në listën e Konventës Ramsar, parashikon që: “Veprimtaritë dhe investimet që do të kryhen në lagunën e Karavastasë të jenë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, dhe me objektivat e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta”, gjë e cila nuk është marrë në konsideratë nga bashkia.

Njëherazi vrejme se bashkia nuk ka respektuar si duhet dhe dispozitat e ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ku ndër të tjera theksohet se duhet:..“të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore; mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet; të nxitë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit; harmonizimi me qasjen e Bashkimit Europian në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, si edhe lidhur me kriteret mjedisore, ruajtjes së biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura; etj.

Ndërhyrjet që po kryehen nuk janë në përputhje edhe me dispozitat e ligjit nr.111, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”. Për të gjitha ndërhyrjet dhe projektet që prekin trupat ujore duhet të diskutohen dhe miratohen nga organet kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore. Sipas dispozitave të këtij ligji ndërhyrjet në zona e mbrojtuar duhet të jenë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar; në zonat për peshkim dhe rritjen e butakëve, sipas legjislacionit për peshkimin; me zonat e synuara për mbrojtjen e bimëve apo kafshëve, si dhe të habitateve, ku ruajtja apo përmirësimi i statusit të ujit është një element i rëndësishëm i mbrojtjes së tyre.



Fatkeqësisht, Bashkia Divjakë, me mendësi dhe veprime të papranueshme nuk ka marrë parasysh mbrojtjen e mjedisit natyror-ligatinor të parkut, në mënyrë të veçantë cënueshmërinë e tij deri në prishjen e ekuilibrit biologjik, mosvlerësim të vlerave të biodiversitetit, peizazhit natyror, të sistemit të brishtë dhe shumë delikat ujor të lagunës dhe të lumenjëve, duke synuar tjetërsimin e tyre natyror në emër të zhvillimit të turizmit.

## **DISKUTIMI NË MBLEDHJEN E HAPUR TË KOMITETIT TË MENAXHIMIT TË PARKUT**

Më datën 8 Gusht 2016, Ministria e Mjedisit organizoi në Divjakë, mbledhjen e hapur të Komitetit të Menaxhimit të parkut, që u drejtua nga zv/ministri i ministrisë së Mjedisit, për të diskutuar rreth projektit të Bashkisë Divjakë, lidhur me ndërhyrjet në territorin e parkut dhe veçanërisht në zonat e ndjeshme të tij.

Siç pritej, nga ana e bashkisë ishin ftuar të merrnin pjesë punonjësit e saj dhe njerëz të zgjedhur që ishin pro projektit.

Grupi i OMSHC-ve në këtë mbledhje u shpreh dhe deklaroi qëndrimin e tij ndaj projektit, veprimit të bashkisë, të mungesës së transparencës dhe të konsultimeve, nevojën e një vlerësimi të thelluar si dhe për vendimin që duhet të marrë Ministria e Mjedisit.

Ekosistemi natyror-lagunor i Karavastasë është i një rëndësie kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, një trashëgimi natyrore jo vetëm e Shqipërisë. Për këto vlera unike ekosistemi natyror i ligatinave ka dhe statusin: Park Kombëtar (1966); shpallur ekosistem natyror veçanërisht i mbrojtur dhe përfshirë në listën e konventës së RAMSARIT (nr. Site 781, datë 29.11.1995); Biotop CORINE-klasifikim që theksonë rëndësinë ndërkombëtare të kësaj zone për ruajtjen e diversitetit biologjik; Zonë veçanërisht e mbrojtur, pjesë e listës kombëtare të Rrjeti EMERALD dhe si zonë e listës së sipërfaqeve ligatinore bregdetare, që shërbejnë si habitate për shpendët migratore, Konventa e Bonit- *Important Bird Areas* (2003).

Parku është i rëndësishëm edhe për ekoturizmin, shëtitjet në natyrë, vëzhgimin e zogjëve, plazh, peshkim dhe i vetmi vend folezimi për pelikanin kaçurrel, ku dimërojnë me dhjetëra e mijëra shpend, folezojnë lloje të rralla e të kërcënuar botërisht, të cilat po rrezikohen drejtpërdrejt nga ndërhyrje akoma të paqarta dhe të pa bëra publike, pra nuk përjashtojmë edhe zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik, brenda standarteve mjedisore evropiane.

Ndërhyrja është planifikuar të kryhet në zonën më të brishtë të parkut, siç pranohet edhe nga stafi i projektit të bashkisë. Zona ku parashohet të kryhen punimet është rreptësisht e ndaluar, sipas ligjit “Për zonat e mbrojtura” dhe të akteve të tjera nënligjore në fuqi. Përcaktohet si zonë me vlera të larta,



për natyrën dhe biodiversitetin, dhe në të zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar”.

Në Planin e Menaxhimit për parkun kombëtar të Divjakë-Karavastasë, të hartur me mbështetjen e JICA, dhe të miratuar me urdhër të ministrit të Mjedisit nr.782, datë 30.12.2015, nuk parashikohen ndërhyrje të tilla në zonën qendrore të parkut. Pra në këtë nënzonë nuk duhet të lejohet zhvillimi turistik masiv me barka, por një zhvillim ekoturistik, shëtitje në natyrë dhe në vëndet e caktuara nga administrata e parkut, sipas parametrave të një parku kombëtar.

Ligji thekson se: “Veprimtaritë ekonomike e shoqërore, projektet që synojnë të zbatohen në një zonë të mbrojtur, pajisen me leje mjedisi, pasi të paraqesin studimin përkatës dhe raportin e plotë të vlerësimit të ndikimit në mjedis, në bazë të studimeve dhe planeve rregulluese të përgjithshme, të cilat miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit”. Megjithëse është zonë qendrore mungon një Studim i thelluar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

#### **Nga prezantimi i projektit u kostatua si më poshtë:**

- U pranua se ndërhyrjet do të kryhen në zonën qendrore të parkut, e cila, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbetet e pashqetësuar.
- U pranua qartësisht seqëllimi i vërtetë nuk është thellimi i kanaleve të komunikimit lagunë-det apo pastrimi në brendësi të lagunës, por thellimi i vijave ujore paralel me pyllin, duke nisur nga pompat apo Hidrovori i Divjakës, duke e kthyer në kanal lundrimi dhe në një pikë të turizmit masiv, me plot varka dhe turistëqë ndjekin Strugën dhe futen në lagunë për të vizituar Pelikanin.
- Problematikë mbetet çështja e pa sqaruar se si do të menaxhohet depozitimi i materialeve të nxjerra nga pastrimi i thellimit të kanaleve dhe cilat janë procedurat e zbatimit final të projektit, të mbështetur në planin e përgjithshëm të zhvillimit të territorit dhe të miratuar në KKT.
- Ideja për materialin që del nga thellimi të përdoret tek ishulli i Pelikanit nuk është shumë bindëse dhe e provuar. Nuk dihet se si do të reagojnë pelikanët në këtë drejtim. Një platformë druri që është ndërtuar pranë ishullit të pelikave ende nuk është e pranuar dhe e frekuentuar prej tyre. Duhet bërë shumë kujdes dhe këtë duhet ta thonë ekspertët.
- Nuk informon dhe sqaron për ndryshimet e mundshme hidrologjike e limnologjike dhe të pritshme në lagunë dhe tek Struga e Zezë, tëkësaj vije uji shumëshekullore, produkt i shumë e shumë proceseve ekologjike dhe njëherazi kaq të brishta përballë ndërhyrjeve.
- Për ndryshimin e kripësisë dhe ndikimin e saj në tërësinë e ekosistemit lagunor, në faunën ujore dhe tek bimësia, në veçanti tek pylli i pishave.
- Për shtimin e ngarkesës organike në ujërat e lagunës.
- Nuk jepet asnjë shifër për turistët e mundshëm që do të lundrojnë me varka në këtë nënzonë, që sot ka akses të kufizuar për shkak të pranisë së



- kolonisë së vetme të Pelikanit kacurrel në Shqipëri, prandaj janë ndërtuar kullat e shikimit të zogjëve, ku është i ndaluar afrimi tek ishulli.
- Për nivelin dhe pasojat e zhurmave, të shqetësimit të faunës dhe largimin e saj gjatë ndërtimit dhe operimit të varkave lundruese, pas përfundimit të punimeve, etj.
  - Nuk jepen asnjë argumentim teknik dhe shkencor që të justifikoj këtë ndërhyrje, për të cilën duhet një ekspertizë të thelluar shkencore dhe teknike dhe këtë mund ta japin vetëm shkencëtarët dhe ekspertët e fushës së ekosistemeve detare-lagunore.
  - Nuk jepen të dhëna që ndryshimi i gjendjes natyrore të strugave, si hambari i rasatit të peshkut, a do të ketë dëmtime, bashkë me to a do të tjetërsohej dhe dëmtohej vendi i qëndrimit, ushqimit dhe folenizimit të mijëra shpendëve, sidomos i Pelikanëve.

#### #Grupimi i OMSHC-ve mbështetin që:

- Ndërhyrjet në këtë territor duhet të jenësa më miqësore me natyrën e lagunës, me pyllin e vetëm natyror mesdhetar të vendit, statusin ligjor të tyre, me qëllimin dhe objektivat e caktuara në planin e menaxhimit.
- Në bashkëveprim me AdZM projektuesit duhet të rishikojnë dhe planifikojnë vetëm krijimin e shtigjeve të rinj për vizitorët, ndërtimin e urave të thjeshta prej drurit si dhe shtim të kullave të vrojtimit, dhe asnjë ndërhyrje tjetër që kompromenton nivelin e konservimit të zonës qëndrore.
- Të planifikohet dhe të kryhen ndëryrjet e domosdoshme për thellimin dhe mbajtjen në eficientë të ujëkëmbimit në Kanalin e Vahut, por mendojmë se kjo ndërhyrje nuk duhet të jetë pjesë e projektit të bashkisë, pasi është detyrë e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, e cila përgjigjet për peshkimin.

**#Fatkeqësisht ky projekt u implementua, duke ndërtuar së fundmi edhe një kullë rreth 30m të lartë, si një çiban në këtë mrekulli dhe trashëgimi të natyrës shqiptare. Janë bërë edhe vijojnë të bëhet reagime për këto ndërhyrje si dhe për problematikat e evidencuara për parkun kombëtar “Divjakë-Karavasta” në kuadër të projektit “Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të vlerave dhe burimeve natyrore në zonat e mbrojtura”.**

Pas #Grupimit të OMSHC-ve “Ndal ndërhyrjeve në parkun kombëtar” një grupim organizatash, po nga shoqëria civile, krijuan #Koalicionin “Stop Urbanizimit të Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta”, në Mars 2017, për të kërkuar ndalimin e një projekti masiv urbanizimi në territorin e Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta”. Projekti binte në kundërshti me ligjet dhe Konventat për mbrojtjen e natyrës. Në vazhdimësi ngulmojmë që kjo kundërshti të mos të ndërpritet, derisa të sigurohet transparenca, demokracia



në vendimmarrje dhe vendimmarrja e duhur në respekt të legjislacionit vendas dhe atij të BE-së, për të marrë përsëri të ardhmen që ne meritojmë – për njerëzit, mjedisin dhe harmoninë mbi përfitimin.

Koalicioni #“**Stop Urbanizimit të Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta”**” i kërkon Qeverisë rishikim, rivlerësim dhe pezullim të procesit të miratimit të projektit “Divjaka Resort Albania”.

Të vetëdijshëm për ndikimet e parikuperueshme të këtij Plani në mjedis dhe se mbrojtja e përmirësimi i mjedisit njerëzor është një çështje e rëndësishme kombëtare, që ndikon jo vetëm në mirëqënien e një rajoni, por edhe në mirëqënien dhe zhvillimin ekonomik të e mbarëvëndit, kërkojmë nga vendimmarrja politike të ndërmarrë një analizë të plotë e të mirëfilltë mjedisore-sociale-ekonomike në terma afatgjatë mbi kostot dhe përfitimet në të gjitha nivelet.

Në vijimësinë e këtij procesi, koalicioni ka nisur një serë aktivitete me ekspertë vendas dhe të huaj për të vlerësuar dhe ndarë me ju opinione, analiza dhe fakte lidhur me ndikimet negative në mjedis, për ti paraprirë vendimarrjes politike që jo vetëm legjislacioni të zbatohet rreptësisht por të respektohen Konventat, Statusi dhe Rëndësia e vencantë që gëzon Parku Kombëtar i Divjakë Karavastasë. Për këtë qëllim janë organizuar edhe disa forume me tema të ndryshme që lidhen me këtë projekt.

Reagim, kolalicioni (grupimi) i OMSHC-ve dhe mjaft organizata të tjera, kanë bërë edhe në lidhje me “Vlerësimi strategjik i planit të zhvillimit të projektit “Resort Divjakë Albania”. Këto plane konsistojnë në tjetërsimin e sipërfaqeve të mëdha natyrore brenda këtyre zonave për ndërtimin e resorteve të turizmit masiv në të disa prej zonave më të mira, simbol të natyrës shqiptare. Parku Kombëtar “Divjakë-Karavasta” është kompleksi ligatinor më i rëndësishëm në Shqipëri, sikurse edhe në Adriatikun Lindor, që po “kryqëzohet” nga vendimmarrja e autoriteteve shqiptare dhe subjekti investues e urbanizues Mabetex Group.

Super resorti turistik, një model aspak ideal për një ligatinë të tillë përfaqësuese në nivel kombëtar e ndërkombëtar për nga vlerat e biodiversitetit dhe shërbimet ekologjike që ofron, po vë në rrezik këtë trashëgimi natyrore.

Çfarë po rezervon kjo “heshtje” e gjatë nga palët e përfshira në këtë proces? Nuk dihet ende asgjë për të ardhmen e kësaj iniciative ekstremisht negative dhe e papranueshme për Parkun Kombëtar “Divjakë-Karavasta”.

Koalicioni i Shoqërisë Civile në Mbrojtje të Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta”, Prill 2017, shprehu shqetësimin e lartë në lidhje me propozimin për ndërtimin e një kompleksi urban në zemër të Parkut Kombëtar dhe në shkatërrim të vlerave të tij, të Zonës Ramsar të Lagunës së Karavastasë, Zonës





Emerald, Zonës së Rëndësishme për Shpendët, epiqendrës së Larmisë Biologjike dhe Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë.

Për këtë i ka dërguar ministrit të Mjedisit, më 24.03.2017, një letër pozicionimi ku jep “Opinion Paraprak mbi Procesin dhe Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Master Planit “Resort Divjakë Albania” si më poshtë:

*Pikë së pari*, duam t’iu bëjmë me dije mosrespektimin nga ana e Ministrisë së Mjedisit të afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për datën e njoftimit të këshillimit publik në lidhje me Vlerësimin Strategjik Mjedisor të një plani të caktuar.

Informojmë se publiku i interesuar është njoftuar për këtë takim vetëm dy ditë përpara mbajtjes së dëgjësës. Ky afat është i pamjaftueshëm për tu njohur sic duhet me brendinë e dokumentit dhe koha në dispozicion të publikut nuk përputhet më afatet e vendosura në ligjin Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 219, datë 11.3.2015 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjësën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”.

#### **Mbështetur në sa më sipër, theksojmë:**

Dëshirojmë të theksojmë që në fillim të këtij materiali kundërshtinë tonë të fortë për formën e tanishme të Master Planit. Ky plan nuk merr parasysh dhe shkatërron një pjesë të mirë të vlerave natyrore dhe larmisë biologjike të zonës ku zhvillohet. Gjithashtu ky plan nuk respekton kuadrin ligjor vendas dhe ndërkombëtar mbi mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe larmisë biologjike në Shqipëri. Mbështetur në sa më sipër ne i kërkojmë Ministrisë së Mjedisit dhe propozuesit të hartojë një plan tjetër zhvillimor që nuk cënon habitatet, speciet dhe vlerat natyrore të ekosistemit.

#### **Arsyet e kundërshtisë janë:**

**1. Plani “Resort Divjakë Albania” prek plotësisht territorin dhe vlerat natyrore të Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta”, kategoria e II e Zonave të Mbrojtura.**

Sipas **ligjit 8906, datë 06.06.2002** “Për Zonat e Mbrojtura”, ndryshuar me ligjin Nr.9868, date 04.02.2008, **Neni 6**, - Park kombëtar, në pikën 2 thuhet se në Parkun Kombëtar **ndalohet**:

- **Pika a - shfrytëzimi i tokës** me teknologji intensive, **me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës**;

Ndërtimi i një super kompleksi të tillë, me rrugë të betonuara, me sipërfaqe rezidenciale, infrastrukture mbështetëse (parkingje, qendra rekreative etj), bën pikërisht atë që e ndalon ligji.



Ky projekt sjell "...ndryshime rrënjësore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës".

- **Pika d, - ndërtimi i rrugëve**, autostradave, hekurudhave, **zonave urbane, linjave të tensionit të lartë** dhe sistemeve të naftës dhe gazit me shtrirje të gjatë;

Edhe në këtë rast, një kompleks turistik me kapacitet 18,000 persona/ditë, është më shumë se sa një qendër urbane, për të cilën do të duhet të ndërtohen; rrugë dhe linja të tensionit të lartë, që sërish janë të ndaluara me ligj.

Në park janë planifikuar ndër të tjera që të ndërtohet edhe Heliport dhe Port (në afërsi të bregut), duke ndikuar direkt në shqetësimet ndaj faunës dhe ekosistemeve të zonës.

**2. Plani "Resort Divjakë Albania"** nuk merr në konsideratë rekomandimet e **Planit të Menaxhimit të Parkut**, hartuar me mbështetjen e JICA dhe miratur në vitin 2015 nga Ministri i Mjedisit.

**3. Lejimi i ndërtimit të një kompleksi** të tillë, do ti hapë rrugën shkatërrimit të Parqeve të tjera Kombëtare në vend, pasi për cdo investitor në fushën e turizmit, vendet më të kërkuara prej tyre janë pikërisht zonat e mbrojtura.

4. Territori i parkut përfshin të gjitha nënzonat e tij dhe si ti tillë, ndërtimet e këtij karakteriduhet të ndalohen në secilën prej atyre nënzoneve.

5. Në dokumentin e shpërndarë paraprakisht, thuhet se janë kryer vëzhgime fushore për florën në datën 28 Dhjetor 2016. Çfarë flore studiohet në atë periudhë, kur dihet mirë që periudha e studimit dhe vlerësimit floristik nuk bëhet në periudhën e dimrit?

**6. Plani i propozuar është në shkelje të plotë të disa Konventave Ndërkombëtare** dhe nëshkelje të parimeve të mbrojtjes së natyrës së Bashkimit Europian:

a. Konventës së Bernës për Rrjetin Emerald. Divjakë-Karavastaja është shpallur Zonë Emerald që prej vitit 2008.

b. Konventës Ramsar për Ligatinat e Rëmdësisë Ndërkombëtare. Divjaka është zona e parë Ramsar e shpallur (1994) në Shqipëri.

c. Rrjetit Natyra 2000 për Zonat Veçanërisht të Mbrojtura. Si zonë Emerald, hapësira Divjakë-Karavasta është candidate për rrjetin Natyra 2000. Si e tillë, të gjitha specie e Aneksit 1 dhe 2 të Direktivës së Shpendëve duhet të ruhen nga çdo dëmtim. I njëjti qëndrim vlen dhe për habitatet jetike të tyre.

d. Divjakë-Karavastaja është Zonë e Rëndësishme për Shpendët (IBA) dhe paraqet interes për mbrojtje kombëtare dhe ndërkombëtare.

7. Dokumenti i shpërndarë është i palexueshëm dhe i paqartë. Hartat janë të palexueshme dhe nuk të lejojnë të njohësh plotësisht zonat dhe ndikimet e pritshme të planit.



8. Impaktet e pritshme në park janë shumë më tepër se çka parashikon studimi i VSM-së aktuale. Ndër të tjera, ai do të zhdukë ose do të reduktojë ndjeshëm numrin e shpendëve folezues apo dimërues në këtë ekosistem.

**Dokumentit nuk flet aspak për ndikimet e pritshme në disa grupe të faunës dhe florës,** sikurse parashikojmë paraprakisht më poshtë:

- Plani i propozuar prek plot 250 specie te ndryshme shpendësh prej të cilave 83 specie janë pjesë e Aneksit 1 të Direktivës së Shpendëve dhe si të tilla duhet të jenë subject i masave të vecanta mbrojtëse të habitateve të tyre për të siguruar mbi jëtësën dhe riprodhimin e tyre në zonat e shpërndarjes.
- Plani dëmton të paktën 35 lloje gjitarësh, 24 Zvarranikësh dhe 8 peshqish. Një pjesë e mirë e tyre janë të mbrojtur nga legjislacioni ynë dhe ai ndërkombëtar.
- Plani cënon habitate me rëndësi për Shqipërinë dhe Bashkimin Europian si duna ranore, livadhe mesdhetare halo-psamofile, pyje aluvionale etj.
- Plani i propozuar do të reduktojë ndjeshëm numrin e shpendëve dimërues në zonen nga mesatarisht 45 000 shpend që dimërojnë aty.
- Plani i propozuar do të reduktojë veçanërisht numrin e shpendëve folezues të përbërë nga 5800-12300 cifte folezuese.
- Plani prek 100% të popullatës shqiptare folezuese të disa llojeve të shpendëve si Pelikani kacurrel (*Pelecanus crispus*), Karabullakut të vogël (*Microcarbo pygmeus*), Çafkës së vogël të bardhë (*Egretta garzetta*), Çafkës së natës (*Nyctycorax nyctycorax*) dhe Çafkës së verdhë (*Ardeola ralloides*).
- Propozimi prek 15 specie shpendësh Globalisht të Rrezikuar dhe 39 Specie të Rrezikuara në shkallë kombëtare.

Mbështetur në sa më sipër iu kërkua ministrit refuzimi i këtij këtij plani dhe hartimin e një plani tjetër për zhvillimin e turizmit në Divjakë. Plani i ri nuk duhet të cënojë kurrësi vlerat natyrore të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, të Zonës Emerald, të Zonës Natyra 2000 të Zonës Ramsar dhe Zonës së Rëndësishme për Shpendët.

## PROCESI I KONSULTIMIT TË VLERËSIMIT NË MJEDIS

### PËR MBROJTJEN E PARKUT KOMBËTAR DIVJAKË-KARAVASTA, NGA URBANIZIMI

Më 6 Prill 2017, u krye një këshillim publik për Planin Mabetex të Urbanizimit të Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta”, nga Ministria e Mjedisit, bazuar në kërkesën e koalicionit për një takim me OJF-të Kombëtare, ku u kërkua me forcë zbatimi i ligjshmërisë për zonat e mbrojtura dhe i proceduave të vlerësimit të ndikimit në mjedis, duke ndarë dhe theksuar Vlerësimin Strategjik Mjedisior dhe Vlerësimi i Thelluar i Ndikimit në Mjedis.



Në Divjakë, 28 Prill 2017, është organizuar një takim nga Mabetex Group për projektin “Divjakë Resort Albania”. Në këtë takim përfaqësuesit e koalicionit u përballën me fshehjen e informacionit, prerjen e fjalës dhe të pyetjeve, mos përgjigjen, abuzivizmin me pushtetin e mikrofonit, përbaltjen nga njerëz të porositur dhe dhunën verbale të turmës.

Ishte një seancë jo e denjë për Divjakën dhe Shqipërinë që aspiron integrimin në Bashkimin Europian. Ai takim nuk duhet të listohet si këshillim publik për sa kohë publikut mjedisor iu pre fjala. Ministria e Mjedisit, si garante e procesit të këshillimit publik për vendimmarrjen mjedisore, duhet ti thotë jo farsës dhe të distancohet nga paligjshmëria.

## **NË KËTË KONTEKST Ç'FARË THOTË LIGJI (i ri) Nr. 81/2017 “PËR ZONAT E MBROJTURA?”**

**CILËN NGA KËTO PIKA TË NENIT 16 MABETEX GROUP MERR NË KONSIDERATË?**

1. “Park Kombëtar” sipas Ligjit Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, Neni 16, shpall territoret e gjëra jo më të vogla se 1000 ha, unike për vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, që ruhen dhe menaxhohen për mbrojtjen e ekosistemeve, llojeve, për edukim dhe rekreacion, që rregullojnë përdorimin e qëndrueshëm nga ana e njeriut të burimeve natyrore.

2. Në “Parkun Kombëtar” zbatohet shkalla e mbrojtjes mjedisore të zonës që ka si objektiv të mbajë territorin në gjendje natyrore, ku të ruhen komunitetet biotike, të resurseve gjenetike dhe llojeve për të siguruar stabilitetin ekologjik dhe diversitetin dhe ku:

- a) përjashtohet njeriu nga shfrytëzimi ose zënia me aktivitete intensive;
- b) nuk lejohet shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive, me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës;
- c) janë të ndaluara ndërtimi i zonave urbane, i autostradave, hekurudhave, linjave të prodhimit të energjisë, si hidrocentrale, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës e të gazit me shtrirje të gjatë;
- ç) nuk lejohet ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;
- d) çdo aktivitet që bie ndesh me objektivat e mbrojtjes së zonës dhe që përcaktohen në planin e menaxhimit.

3. Në këtë zonë mund të ushtrohen veprimtari që sigurojnë krijimin e mundësive shpirtërore, shkencore, edukative, çlodhëse të vizitorëve, në përputhje me kërkesat mjedisore, kulturore dhe të planit të menaxhimit, por vetëm pasi të pajisen me miratimin e institucioneve shtetërore, që synojnë:



- a) ruajtjen e zonës në një gjendje natyrore ose sa më afër natyrës;
- b) respektimin e vlerave ekologjike, geomorfologjike, objekteve të shenjta ose estetike, për të cilat zona merret në mbrojtje;
- c) marrjen në konsideratë që banorët lokalë kanë të drejta, të tilla si, peshkimin, kullotjen dhe drutë e zjarrit, deri në atë masë sa ato të mos dëmtojnë objektivat e tjerë të menaxhimit.

## **Ç'FARË MËSUAM NGA KËSHILLIMI PUBLIK MBI MASTER PLANIN E DIVJAKËS?**

1. Resorti formon një zonë urbane të turizmit masiv në qendër të Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta”. Ndërsa qyteti i Divjakës ka rreth 10 mijë banorë, resorti do të presë çdo ditë 18 mijë vizitorë. Ky është rast tipik i turizmit masiv, shkatërrues i natyrës.

2. Resorti shkatërron ekologjikisht gjithë sistemin ligatinor. Dallgë thyesi i parashikuar në Tokën e Vdekur (Zonë Qëndrore e Parkut) do të shkaktojë fillimisht mbushjen me sedimente të lagunës së jashtme (Godullës) të Karavastasë dhe më pas mbushjen edhe të lagunës së brendshme (Godullës së brendshme). Pra laguna do të vdesë së bashku me sektorin e peshkimit. Mbjajtja e sedimenteve do të shkaktojë në vijim erozionin e Spiaxhos, Zonë Qëndrore e Parkut dhe habitatin më i rëndësishëm për shpendët. Dallgë thyesi është ndërhyrja më shkatërruese në Park.

3. 2400 apartamentet e parashikuara do të shiten dhe do të kemi banesa të reja të përhershme në qendër të Parkut Kombëtar. Ligji e ndalon kategorikisht ndërtimin e banesave në park.

4. Resorti prek zonën qendrore të Parkut pavarësisht së ligji e ndalon këtë.

Për të gjitha arësyet e mësipërme, shoqëria civile i bën thirrje Ministrisë së Mjedisit të mos e aprovojë këtë projekt të turizmit masiv. Ky do të ishte fillimi i fundit për Parkun Kombëtar “Divjakë-Karavasta”, Zonat e Mbrojtura dhe natyrën në Shqipëri.

## **REAGIMI NDËRKOMBËTAR**

Nisma e shoqërisë civile për mbrojtjen e Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta” nga urbanizimi masiv morri mbështetje edhe nga organizata të mirënjohura ndërkombëtare dhe partnerët po mbështesin këtë përpjekje të drejtë të koalicionit. Njëherazi dhe donatorët e qeverisë shqiptare, në fushën e mjedisit, po koordinojnë veprimet për të folur njëzëri.

Në mjediset e Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta”, u mbajt konferenca për shtyp me përfaqësues nga organizata mjedisore ndërkombëtare dhe kombëtare, të cilët shprehën shqetësimin mbi projektin dhe garantuan vendosmërinë për t’u mbrojtur me çdo mjet Parkun Kombëtar, pasi ky model zhvillimi e



urbanizimi cënon vlerat, integritetin dhe qëndrueshmërinë e Zonës së Mbrojtur në terma afatgjatë.

### **REAGIMI I RRJETIT “ALEANCA E LIGATINAVE MESDHEWARE”**

Aleanca Mesdhetare e Ligatinave është një konsorcium i organizatave kërkimore, OJF ndërkombëtare dhe kombëtare, me qëllim të rrisë kolektivisht profilin e ligatinave në shoqërinë mesdhetare në përgjithësi dhe në veçanti në politikën kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare përmes promovimit të inovacionit dhe përdorimi i praktikave më të mira të bazuara në dëshmi si katalizator për ndryshim. Deri më sot, anëtarët e Aleancës së Ligatinave e Mesdhetare janë 20 organizata nga 12 vende.

Rrjeti “Aleanca e Ligatinave Mesdhetare” i ka dërguar një letër Kryeministri dhe Ministri i Mjedisit dhe për dijeni: European Delegation in Albania, EU Commissioner on Environment, Secretariat of the Ramsar Convention, Secretariat of the Bern Convention, Secretariat of the Bonn Convention dhe Mabetex Group, në të cilën theksojnë: ...kohët e fundit janë njoftuar për Master Planin “Resort Divjakë Albania” dhe dëshirojnë të shprehin shqetësimet e tyre të thella në lidhje me këto zhvillime dhe ndikimet e tyre të mundshme negative në Parkun Kombëtar të Karavastasë dhe në trashëgiminë e tij natyrore.

Disa nga anëtarët e Aleancës së Ligatinave të Mesdheut e dinë mjaft mirë këtë vend dhe mund të dëshmojnë vlerën e trashëgimisë së jashtëzakonshme të kësaj zone, është një nga dy ligatinat më të rëndësishme të Adriatikut. Kjo veçori do të konsiderohet në dritën e faktit se më shumë se 70% e ligatinave shqiptare janë shkatërruar gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 20-të. Divjaka-Karavasta, e cila është një nga dy ligatinat më të rëndësishme në pellgun e Adriatikut, paraqet një vend kyç për kafshët e egra, të vizituara çdo vit nga miliona ujëvarë në rrugën e tyre të migrimit, por është gjithashtu një aset kyç për ekonominë lokale.

Në dhjetëvjeçarët e fundit, qeveria shqiptare ndërmori hapa të rëndësishëm për një ruajtje më të mirë të trashëgimisë natyrore të Shqipërisë, veçanërisht nëpërmjet kontributit të Administratës për Zonat e Mbrojtura, në ruajtjen dhe rritjen e vlerave të Parkut Kombëtar të Divjakë - Karavasta. Ndër rezultatet pozitive mund të nxjerrim në pah rritjen e numrit të pelikanëve dalmat, një specie simbolike e Parkut dhe Shqipërisë në përgjithësi, por edhe zhvillimin e turizmit natyror në park si një kontribut pozitiv në ekonominë lokale dhe një vektor të fuqishëm arsimor.

Duke nxjerrë mësim nga tërë pellgu i Mesdheut, por edhe në të gjithë botën, duket qartë se një ligatinë e tillë përfaqëson një forcë të vërtetë për Shqipërinë në kuptimin e vlerës së biodiversitetit, të shërbimeve të shumta ekologjike që ofrohen për popullin shqiptar, të imazhit të Shqipërisë. Ajo nuk duhet të



konsiderohet si një pengesë për zhvillimin, por si përparësi kryesore për të ardhmen e Kombit dhe të Njerëzve të saj.

Në këtë kontekst, Aleanca e Ligatave të Mesdheut në mënyrë të qartë konsideron se iniciativat për zhvillimin e “Resort Divjakë Albania” do të ishin jashtëzakonisht negative dhe të papranueshme. Do të ishte në kundërshtim të plotë me angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë në kuadrin e Konventës Ramsar, Konventën e Bernës, Konventën e Bonit dhe Rrjetin Emerald.

Andaj, Aleanca i kërkon Qeverisë Shqiptare të ndalojë këtë projekt dhe të vlerësojë në mënyrën më të mirë trashëgiminë natyrore të Shqipërisë dhe veçanërisht të Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta” dhe shpreh gatishmerinë të kontribuojë në një dialog për të ardhmen e Parkut Kombëtar të Divjakë-Karavastës dhe territorin e saj fqinjë.

Në këtë kontekst reagimi është i thellë, OJF-të po veprojnë, Sekretariatet e Konventave Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Natyrës po reagojnë me letra drejtuar qeverisë!

Një film dokumentar është realizuar nga regjizori, publicisti dhe gazetari Artan Rama, në kuadër të ciklit të dokumentarëve investigativë për natyrën dhe modelin se si po zhvillohet Shqipëria përmes shfrytëzimit të burimeve të saj natyrore. Po kështu është shfaqur edhe filmi “Elementi i pestë” si dhe spoti i realizuar në kuadër të fushatës “Stop Urbanizimit të Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta”.

Thuajse të gjitha mediat televizive dhe portale, lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare (publike e private) kanë dhënë lajme, kronika dhe kanë pasqyruar reagimet e komunitetit dhe të OMSHC-ve.

Disa artikuj të ndryshëm janë realizuar nga gazetarë vendas dhe të huaj, të cilët hedhin dritë mbi Resortin e Mabetex Group, që parashikohet të ndërtohet në Parkun Kombëtar “Divjakë-Karavasta”.



## BIBLIOGRAFIA

- Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, “Manual shpjegues dhe trajnues mbi hartimin e planit të komunikimit, informimit dhe angazhimit mbi procedurat transparente dhe efektive të grantdhënies”.
- BE, “Udhëzime mbi mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile në vendet e zgjerimit 2014-2020”.
- BIRN-ALBANBI, 2018, “Advokimi nëpërmjet medias dhe rrjeteve sociale” – Udhëzues për aktivistët dhe OJF-të.
- ÇIP (Qendra për Çështje të Informimit Publik), “Shumëllojshmëria e formave të komunikimit”.
- FRIDOM, “Rishikimi funksional i sistemeve të komunikimit institucional”.
- GIZ, 2009, “Seminari Katër - Komunikimi, marrëdhëniet dhe menaxhimi”.
- INCA, 2017, “Raport për platformën e investigimit dhe zbatimit në praktikë të legjislacionit për ruajtjen e natyrës në Shqipëri”.
- INCA, 2018, “Raport për vlerësimin, analizimin dhe hartëzimin e ndikimeve negative në zonat e mbrojtura mjedisore”.
- Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, UNDP, 2012, “Manual për Menaxhimin e Organizatave të Shoqërisë Civile”.
- Kuvendi i Shqipërisë, 2014, “Manual i pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit të Shqipërisë”.
- Kuvendi i Shqipërisë, 2015, “Raport mbi pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes”.
- L.Oshafi&Co, 2011, “Mjetet e Informim - Kominikimit”.
- Ligj nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
- Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Menaxhim Konflikti, 2013, “Pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe qytetare në vendimmarrje”.
- PDCS, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2016, “Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Përfshirja e OSHC-ve në Proceset me Pjesëmarrje”.
- Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QShKE), 2006, “Menaxhimi i problemeve mjedisore në nivel vendor”.





- REC, 2013, “Manual për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.
- REC, 2014, “Manual për zhvillimin e aftësive të OJF-ve”.
- REC, 2015, “Perceptimi i publikut për mjedisin në Shqipëri”.
- REC, 2017, “Praktika të mira për informimin mjedisor dhe përfshirjen gjinore”.
- S. Musta, 2017, “Komunikimi mes Parlamentit dhe OJF-ve, kontradiktat e një raporti mes informimit publik dhe marketingut politik”.
- S.Ymeri, “Manual për menaxhimin e organizatave të shoqërisë civile”.
- TACSO&SPIU&BE, 2013”, “Manual për marrëdhëniet me publikun për organizatat e shoqërisë civile”.
- TACSO, 2011, “Menaxhimi i OSHC-ve - Instrumente praktike për analizën e zhvillimit organizativ”.
- Universiteti i Prishtinës, “Njohuri të përgjithshme, rëndësia e aftësive komunikuese, si të komunikojmë”.
- USAID&ASET, 2009, “Manual për marrëdhëniet e njësisë vendore me publikun”.

